


DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE


NUMËR 378 • VITI 35 • MAJ 2022 • SHEVAL 1443 • ÇMIMI 1 €



**TË PËRGJIGJEMI O ALLAH,
TË PËRGJIGJEMI!**


**DHE THIRR NDËR NJERËZ PËR
HAXH, SE TË VIJNË TY
KËMBËSORË E EDHE KALORËS
ME DEVE TË RRASKAPITURA,
QË VIJNË NGA RRUGË TË
LARGËTA!**

(KURAN, 22:27)



Në këtë numër:

Të përgjigjemi o Allah, të përgjigjemi!	4
Sabri Bajgora	
Komentimi i sures “Muhamed” – (3)	5
Dr. Ajni Sinani	
Kurani zbulon edhe të ardhmen, e jo vetëm të shkuarën	8
Resul Rexhepi	
Pendimi duhet të jetë i singertë	10
Isa Tërshani	
Vlera e dhjetë ditëve të para të dhul-hixhes	12
Prof. ass. dr. Musa Vila	
Haxhiu është delegat i madhërisë hyjnore	13
Muhamed B. Sytari	
Pejgamberët në lutjet e tyre	17
Dr. Bahri Hoxha	
Kontakti i hyjnore me johyjnore dhe efektet akaidologjike	20
Eduart Thartori	
Bujaria e Allahut xh.sh.	25
Argjent Xheladini	
E drejta e gruas për trashëgimi sipas shariatit islam	27
Mr. Driton Arifi	
Multikulturalizmi dhe të drejtat e grupeve minoritare në konceptin islam	30
Prof.ass.dr. Rexhep Suma	
Polemizimi në formën më të bukur, shenjë e thirrjes islame	33
Prof. dr. sc. Edin Tule	
Vrimat e zeza në organizimin islam	37
Blerim Musliu	
Ezani, pranverë e shpirtit dhe zemrës	39
Erëza Sahiti	
Qëllimi i jetës në kornizat islame	41
PhD (C) Melihate Zeqiri	
Shumëgjuhësia institucionale (2)	43
Aktivitetet	46

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Të përgjigjemi o Allah, të përgjigjemi!



“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë, e edhe kalorës me deve të rraskapitura, që vijnë prej rrugëve të largëta...”

(El-Haxh, 27)

Jeta e besimtarit është testim dhe sendërtim praktik i së vërtetës dhe i devotshmërisë. Ana vulgare materialiste e saj ngurthon shpirtin. Prandaj besimtari ka nevojë për një atmosferë të ngrohtë besimi që e ngrit drejt horizonteve të përsëritjes. Një realitet të çiltër dhe të pastër, të parfumosur me aromë imani e përunjësia. Prandaj, ja ku është mundësia.

Ditët kaluan shpejt dhe arritëm në prag të një sezoni të madh, ditëve të Haxhit. Në ditët e para të muajit Dhul-Hixhe çdo vit, zemrat e muslimanëve anekënd botës rrabin dhe sytë e tyre drejtohen nga Shtëpia e Shenjtë e Zotit, të mbushur me mall dhe shpresë për atë që është te Zoti i Madhëruar, duke iu përgjigjur lutjes të babait të tyre, Ibrahimit alejhi selam, kur Zoti e urdhëroi që ti thërrasë njerëzit ta vizitojnë Qabenë e të shkojnë në haxh: “Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë, e edhe kalorës me deve të rraskapitura, që vijnë prej rrugëve të largëta...” (El-Haxh, 27).

Zëri i Ibrahimit a.s. kumboi dhe u përhap anekënd rruzullit tokësor dhe ai zë vazhdon të jehojë për mijëra vite deri në ditët tona. Kështu do të vazhdojë edhe në të ardhmen sa të ketë jetë. Shpirtat e besimtarëve dhe të besimtareve në vijimësi nga të gjitha skajet e Tokës i përgjigjen thirrjes duke thënë: Lebbejke Allahumme lebbejk” – Të përgjigjemi o Allah, të përgjigjemi!

Haxhi është një nga adhurimet më me peshë të fesë islame, shtylla e pestë e Islamit dhe një prej adhurimeve madhështore. Ai është një ibadet karakteristik. Është bërë obligim në vitin e nëntë hixhri. Realizohet me pasuri e trup. Zoti i Madhëruar thotë: “... Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit tek ajo, e kush mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që bëjnë) njerëzit.” (Ali Imran, 97)

Muhamedi a.s. thotë: “Islami është ndërtuar mbi pesë: dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Zotit dhe se Muhamedi është i Dërguari i Zotit, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit, dhe vizita e shtëpisë për atë që ka mundësi udhëtimit tek ajo.”

Për ata që i plotësojnë kushtet e Haxhit, kryerja e tij është obligim një herë në jetë, kjo vlen për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, i cili është mentalisht, financiarisht dhe fizikisht i aftë. Haxhi është adhurim fetar që Zoti ia kishte urdhëruar edhe umeteve të mëparshme.

Shpirti i besimtarit nga dashuria e madhe është i lidhur me Zotin dhe shtëpinë e Tij. Prandaj, Qabeja është një mundësi që edhe duke shkuar fizikisht atje ta shprehin dashurinë dhe bindjen tonë ndaj Zotit.

Dijetarët kanë përmendur shumë dobi e urtësi të tij. Haxhi është tubimi më i madh shpirtëror vjetor ku muslimanët takohen e njihen mes tyre. Haxhi manifeston universalitetin e fesë islame dhe shpërfaq vëllazërinë dhe barazinë e muslimanëve, specifike e fesë që nuk favorizon një klasë, kastë apo racë. Haxhi u përkujton njerëzve se ajo që peshon te Zoti është devotshmëria. Feja dhe fetarizmi janë karta më e fortë identitare që i bashkon të gjithë muslimanët në një umet të vetëm.

Koha e haxhit është kthim intensiv te Zoti pas një pakujdesie e shpërfillje, me tërë qenien tonë, pastrim e pendim. Ky është një nga qëllimet kulmore të Haxhit. Pejgamberi a.s. thotë: “Kush kryen haxhin për Allahun xh.sh. dhe ruhet nga fjalët dhe veprat e shëmtuara, kthehet (i pamëkat) sikur ka lindur nga nëna e tij.” (Buhari dhe Muslimi).

Ky hadith jep shtet për haxhiun se ai do të kthehet me mirësinë dhe mëshirën e Zotit me libër me faqe të bardha dhe dosje të fshira të gjynaheve. Prandaj ai s’duhet t’u kthehet përsëri mbushjes së këtyre dosjeve me mëkate.

Pasqyrimi i qëllimeve të haxhit në realitetin e jetës sonë duhet të jetë konstant dhe i vazhdueshëm. Ndërkaq, ka haxhinjë që i thonë lamtumirë gjithçkaje që përjetuan dhe bënë gjatë ditëve të haxhit me heqjen e petkut të ihramit.

Këta sikur neglizhojnë faktin se ajo që bënë gjatë Haxhit duhet të shërbejë si një stërvitje për të vazhduar në atmosferën e Haxhit. Ato përjetime që kanë lulëzuar zemrën nuk duhet të vryshken por t’i mbajnë të freskëta sa të jenë gjallë.

Muslimani, që të jetë i denjë gjatë haxhit dhe pas tij, duhet të pajiset me devotshmëri shumë kohë para se të niset. Zoti thotë: “... Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, e ju të zotët e mendjes kini dronë Time.” (El-Bekareh, 197).

Padyshim haxhi është një përvojë dhe përjetim shpirtëror i papërsëritshëm. Aty realizohet pastrimi i shpirtit dhe fsnikrimi i tij. Haxhi na përkujton Ditën e Madhe të Ringjalljes. Vëshjet e bardha të haxhinjëve janë si qefina që mbështjellin trupin e tyre. Ato simbolizojnë edhe bardhësinë e shpirtit.

Shumë njerëz pas kryerjes së haxhit kanë ndryshuar rrënjësisht në mënyrë pozitive në kryerjen e dispozitave fetare. Haxhi e kalit besimtarin me durim dhe e aftëson që t’i bëjë ballë vështirësive dhe peripecive të jetës.

Dr. Ajni Sinani

Sabri Bajgora

Komentimi i sures “Muhamed” – (3)

Dispozitat sheriatike rreth luftës, robërve të luftës dhe të vrarëve në rrugën e Allahut

فَإِذَا لَقِيتُمُ الَّذِينَ كَفَرُوا فَضَرْبَ الرِّقَابِ حَتَّىٰ إِذَا أَتَّخْتُمُوهُمْ فَشُدُّوا الْوَتَأَقَٰ فِيمَا مَنَّا بَعْدُ وَإِمَّا فِدَاءً حَتَّىٰ تَصْعَ الْحَرْبُ أَوْزَارَهَا ۚ ذَٰلِكَ وَلَوْ يَشَاءُ اللَّهُ لَانتَصَرْنَا مِنْهُمْ وَلَكِن لِّيَبْلُوَ بَعْضَكُمْ بِبَعْضٍ ۗ وَالَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَلَن يُضِلَّ أَعْمَالَهُمْ ﴿٤﴾ سَيَسْئَلُهُمْ فِيهَا رُبَّمَا ۖ وَيُضَلِّحُ بِاللَّهِمْ ﴿٥﴾ وَيُدْخِلُهُمُ الْجَنَّةَ عَرَفَهَا اللَّهُ ﴿٦﴾

“Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditni në qafë derisa t'i mposhtni (rraskapitni)! Më pas, lidhni mirë, e pastaj, ose lironi falas ose kërkoni dëmshpërblim për ta, derisa të përfundojë lufta. Sikur të donte Allahu, do t'i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë juve me njëri-tjetrin. Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në rrugën e Allahut. Ai do t'i udhëzojë ata, do t'ua përmirësojë gjendjen, dhe do t'i shpjerë në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.” (Muhamed, 4-6)

Shkaku i zbritjes së ajeteve (4-6)

Transmetohet nga Ibn Ebi Hatimi e ky nga Katadeja që në lidhje me fjalët e Allahut: “Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në rrugën e Allahut. Ai do t'i udhëzojë ata, do t'ua përmirësojë gjendjen dhe do t'i shpjerë në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë”, të ketë thënë: “Na është përmendur neve se këto ajete kanë zbritur në

ditën e betejës së Uhudit, kur i Dërguari a.s. ishte në një kodrinë, e përreth tij kishte të plagosur e të vrarë. Atë ditë idhujtarët kishin thirrur me zë të lartë: “Madhëroni “Hubelin”¹, kurse myslimanët ua kthyen: “Allahu është më i Madhi dhe më madhështori”. Idhujtarët bërtitën me zë të lartë: “Ne kemi Uzzanë e ju nuk keni Uzza”, ndërsa i Dërguari a.s. u tha: “Thoni atyre: “Allahu është Zoti-Kujdestari ynë, e ju nuk keni Zot- kujdestar”²

Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Në ajetet paraprake pamë se janë dy grupe njerëzish: jobesimtarët në njërin anë, të cilët e pasojnë të shtrembëtën duke ndjekur intrigat e shejtanit, dhe besimtarët në anën tjetër, që ndjekin të vërtetën dhe udhëzimin e Allahut. Ndërsa tash në këto ajete, shohim se si Allahu ua sqaron dispozitat e luftës ndaj idhujtarëve-jobesimtarëve, gjatë betejës dhe pas përfundimit të saj, si dhe dispozitat që kanë të bëjnë me robërit e luftës.

Koment

4. Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditni në qafë derisa t'i mposhtni (rraskapitni)! Më pas, lidhni mirë, e pastaj, ose lironi falas ose kërkoni dëmshpërblim për ta, derisa të përfundojë lufta. Sikur të donte Allahu, do t'i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë juve me njëri-tjetrin.

Me këtë ajet, fillojnë së përmenduri dispozitat dhe rregullat e luftës sipas legjislacionit islam. Ndonëse lufta



Salahudini u soll mirë me robërit e tyre, duke i liruar ata pa kurrfarë kushtesh. Ai, me këtë gjest human, i tregoi botës së atëhershme të krishterë, se Islami nuk është fe e dhunës dhe nuk dëshiron hakmarrje.

kurrë nuk është opsioni i parë në lartësimin e Fjalës së Allahut, ajo gjithnjë vazhdon të mbetet opsioni i tretë, kur ballafaqimi me armikun është i detyrueshëm, atëherë kur besimtarët porositen që të jenë të qëndrueshëm në mbrojtjen e vlerave dhe të së vërtetës.

Pjesa e parë e këtij ajeti: “Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditni në qafë derisa t’i mposhtni (rraskapitni)!”, ua bën me dije besimtarëve që kur të konfrontohen me armikun në betejë, të mos ligështohen, por të jenë të qëndrueshëm e të mbështeten te Zoti, duke synuar vetëm ngadhënjimin. Rraskapitja e armikut në këtë rast nënkupton dërrmimin dhe mundjen e tyre në betejë, duke përdorur të gjitha strategjitë e mundshme ushtarake, e pastaj nëse myslimanët kanë zënë robër lufte (pengje) nga tabori i armikut, atëherë kryekomandanti mysliman ka para vetes dy mundësi të veprimit me ta:

1. Lirimin e tyre pa kurrfarë kushtesh (pa dëmshpërblim) ose

2. Lirimin e tyre me kushte (me dëmshpërblim), etj.

Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. në këtë ajet (4), të kësaj sureje, thotë: “... e pastaj, ose lironi falas ose kërkoni dëmshpërblim (për ta), derisa të përfundojë lufta”.

Shembull praktik të një veprimi të tillë përgjatë historisë kemi rastin e luftës së Salahudin Ejubit me të krishterët, të cilët ani pse ia kishin masakruar më se 70 mijë luftëtarë, Salahudini u soll mirë me robërit e tyre, duke i liruar ata pa kurrfarë kushtesh. Ai, me këtë gjest human, i tregoi botës së atëhershme të krishterë, se Islami nuk është fe e dhunës dhe nuk dëshiron hakmarrje.

Lirimi i tyre me dëmshpërblim, është mundësia e dytë, dhe kjo përdoret edhe sot e kësaj dite nga shumë ushtri të botës, ku shpeshherë ndodh që të bëhet edhe shkëmbimi i robërve të luftës, bazuar në Konventat ndër-kombëtare që janë në fuqi.

Sipas Islamit, lufta në të cilën lejohet zënia e robërve është lufta e ligjshme në rrugën e Allahut, e cila për të qenë e tillë duhet t’i plotësojë këto katër kushte:

1. Lufta për ta larguar rrezikun e armikut ndaj myslimanëve;

2. Lufta që të thyhet fuqia luftënxitëse, e cila fut përçarje në mes njerëzve;

3. Lufta për mënjanimin e pengesave, çfarëdo qofshin ato, gjatë misionit të përhapjes së fjalës së Allahut te njerëzit (popujt); dhe

4. Lufta me rastin e thyerjes (prishjes) së marrëveshjes për armëpushim.

Sa i përket pjesës së tretë të ajetit: “Sikur të donte Allahu, do t’i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t’ju sprovtojë juve me njëri-tjetrin.”, kjo na vë në dijeni, se Allahu i Madhërishtëm, ka mundësi dhe fuqi që po të dojë, mund t’i shkatërrojë jobesimtarët edhe pa luftë, duke i fundosur, në det, duke i shkatërruar me gurë nga qielli ose me ndonjë ndëshkim tjetër, por nuk e bën këtë, sepse Ai dëshiron që t’i vë besimtarët në sprovën e Imanit dhe të qëndrueshmërisë. Pikërisht, gjatë luftërave për lartësimin e Fesë së Allahut, vjen në shprehje besimi i paluhatshëm në Allahun, dhe gatishmëria për të ngadhënjyer në luftë ose për të rënë shehid. Myslmanët e parë, duke iu përmbajtur këtyre dy rregullave,

kanë arritur që për një kohë të shkurtër të sundojnë me drejtësi gati gjysmën e botës së atëhershme, sepse ata nuk kishin frikë nga vdekja, madje garonin se cili do të kishte nderin të binte dëshmor në rrugën e Zotit.

Ndërsa pjesa e fundit përmblylëse e ajetit të katërt të kësaj sureje: “Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në rrugën e Allahut”, e vërteton konstatimin e thënë më parë, se Allahu nuk ua humb mundin e as veprat atyre që ranë dëshmor në rrugën e Allahut, përkundrazi, ata do të jenë në kopshtet e Xhenetit, duke shijuar kënaqësitë e Krijuesit të tyre. Përveç kësaj, shehidët, kanë edhe një privilegj shtesë ndaj të tjerëve, ata e kanë të garantuar Xhenetin, dhe për ta nuk do të ketë llogari në Ditën e Gjykimit. Madje, ata pas rënies dëshmorë, nuk konsiderohen si të vdekur, por të gjallë tek Allahu dhe të furnizuar me begatitë e Xhenetit: “E për ata që u mbytën në rrugën e Allahut mos thoni: “Janë të vdekur”, Jo, ata gjallë janë (nuk kanë vdekur), por ju nuk e kuptoni (gjallërinë e tyre).” - (El-Bekare, 154).

Transmetojnë Imam Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Mikdam el Madikerib el-Kindi të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut: “Shehidi-dëshmori i ka gjashtë epite-te tek Allahu: Atij i falen të gjitha

Këta njerëz për hir të veprave që i bënë në këtë botë, duke flijuar edhe jetën e tyre në lartësimin e Fjalës së Allahut, do të banojnë nëpër shtëpi e pallate të zbukuruara me gurë të çmueshëm e margaritarë.



gjynahet, qysh me rënien në tokë të pikës së parë të gjakut dhe e sheh vendin e vet në Xhenet; stoliset me petkat e Imanit; është i mbrojtur nga ndëshkimi në varr; është i siguruar nga trishtimi i Ditës së Kiametit; mbi kokë i vendoset kurora e nderit, e stolitur dhe e zbukuruar me margaritarë e smeraldë, martohet me hyritë e Xhenetit dhe do t'i jepet mundësia të ndërmjetësojë për 70 persona nga të afërmit e tij.”³

4. Ai do t'i udhëzojë ata, do t'ua përmirësojë gjendjen,

5. dhe do t'i shpjerë në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.

Këto dy ajete flasin për gjendjen e besimtarëve, në veçanti të atyre që bien dëshmorë në rrugën e Allahut. Këta, Allahu do t'i udhëzojë, do t'ua përmirësojë gjendjen e tyre dhe do të jetë i kënaqur ndaj tyre. Shpërblimi i tyre do të jetë Xheneti, të cilin i Madhërishmi ua ka bërë të njohur më parë, si përshkrim dhe si përjetim. Këta njerëz për hir të veprave që i bënë në këtë botë, duke flijuar edhe jetën e tyre në lartësimin e Fjalës së Allahut, do të banojnë nëpër shtëpi e pallate të zbukuruara me gurë të çmueshëm e margaritarë. Ata do t'i

njohin shtëpitë që u janë caktuar atyre sikur të kishin jetuar në to përjetësisht. Në lidhje me këtë i Dërguari a.s. ka thënë: “Pasha Atë që shpirti im është në Dorën e Tij, çdonjëri prej tyre do ta dijë shtëpinë e tij në Xhenet, më mirë se sa e ka ditur shtëpinë e tij në këtë dynja.”⁴

Edhe Muxhahidi, teksa e komenton këtë ajet thotë: “Njerëzit do të drejtohen kah shtëpitë dhe vendbanimet e tyre në Xhenet, të cilat ua ka caktuar Allahu Fuqplotë, dhe nuk do ta gabojnë rrugën drejt tyre, sikur të kishin banuar në to qysh prej kur janë krijuar, duke mos pasur nevojë ta pyesin askënd.”⁵

Porosia e ajeteve (4-6)

- Ndonëse lufta në Islam, nuk është kurrë e preferuar si opsion i parë, megjithatë, ajo lejohet për vetëmbrojtje dhe për lartësimin e Fjalës dhe fesë së Allahut. Gjatë luftës, besimtari nuk guxon të shfaqë dobësi a ligështim, por duhet të kërkojë ndihmën e Allahut dhe të jetë i qëndrueshëm deri në realizmin e dy objektivave finale, ose ngadhë-

njimin me lejen e Allahut, ose rënien dëshmorë në rrugën e Allahut.

Nëse myslimanët ngadhënjëjnë në luftë, dhe si pasojë kanë zënë robër nga radhët e armikut, ata kanë mundësi t'i lirojnë ata pa dëmshpërblim, ose me dëmshpërblim, ose t'i shkëmbejnë robërit me palën armike apo ndërluftuese.

- Lufta është një sprovë për besimtarët, për të parë se sa janë të vendosur në ngadhënjimin e së vërtetës. Por sigurisht, në cilëndo rrethanë a gjendje, besimtarët janë në fitim, ose si ngadhënjyes në luftë, ose rënia dëshmor-shehid, dhe fitimi i Xhenetit përjetësisht.

- Allahu askujt nuk ua humb veprat e mira që i kanë bërë, sidomos atyre që merituan epitelin e shehidit, të cilët do t'i shpjerë në Xhenetet e Tij, për t'i shijuar kënaqësitë që janë dedikuar enkas për ta. - vijon -

1. *Idhulli më i madh i idhujtarëve kurejshë*. 2. *Imam Sujuti, Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli*, f. 234. 3. *Imam Ahmedi (17182); Et-Tirmidhij, (1663); Ibn Maxhe (2799); hadith sahih*. 4. *Transmeton Buhariu (2440)*. 5. *Tefsiri i Muxhahid bin Xheberit, Kajro, 1989, f. 604-605*.

Dr. Ajni Sinani

Kurani zbulon edhe të ardhmen, e jo vetëm të shkuarën

Kurani nuk mund t'i atribuohet kujt tjetër veç Allahut. I gjithë informacioni në Kuran ka origjinë hyjnore. Informacioni në Kuranin fisnik është një problem për jomyslimanët. Ai kërkon që ata ta studiojnë atë. Natyrisht që jomyslimanët do të kërkonin të gjenin prova kundër tij, por ata nuk mund të gjejnë

Kurani nuk mund t'i atribuohet kujt tjetër veç Allahut. I gjithë informacioni në Kuran ka origjinë hyjnore. Informacioni në Kuranin fisnik është një problem për jomyslimanët. Ai kërkon që ata ta studiojnë atë. Natyrisht që jomyslimanët do të kërkonin të gjenin prova kundër tij, por ata nuk mund të gjejnë.¹

Kurani kur flet nuk zbulon vetëm të kaluarën, por edhe të ardhmen. Një shembull befasues i asaj që zbulon Kurani i shenjtë për të ardhmen gjendet në vargjet e para të Sures Err-Rrum:

“1. Elif, Lam, Mîm. 2. Bizantinët (rumët) u mundën, 3. në tokën më afër (tokës së arabëve), por pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë, 4. brenda pak viteve (bid'i sinin). Çështja, është vendimi i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). Dhe, atë ditë, (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen, 5. për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirues. 6. (Ky është) Premtimi i Allahut, Allahu nuk e thyen premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Err-Rrum, 1-6)

Këto ajete u shpallën rreth vitit 620 e.s., pas humbjes së Perandorisë Bizantine nga persianët paganë. Ajetet tregojnë se bizantinët do të

triumfonin mbi rivalin e tyre në një betejë tjetër të afërt me persët.²

Në vitin e tetë të dërgesës profetike, në afërsi të tokës arabe, iranianët i mundën bizantinët. Ua shembën qytetet, përparuan gjer në Konsantinopojë (Stamboll) dhe e detyruan perandorin bizantin t'u paguante dëmshpërblim të rëndë.³

Persianët ishin adhures të zjarrit, kurse bizantinët edhe pse me devijime ishin monotesit. Idhujtarët arabë u mbanin krahun persianëve ngase ata nuk besonin në Një Zot e i urrenin si myslimanët ashtu edhe

bizantinët e krishterë të asaj kohe. Ndërkaq, myslimanët i përkrahnin bizantinët si monoteistë.⁴

Idhujtarët mekas u gëzuan për disfatën e bizantinëve dhe rënien e Jerusalemit nën sundimin e iranianëve e konsideruan si një shenjë e mirë në luftën e tyre kundër myslimanëve, duke parashikuar fitore dhe triumf të tyre kundër myslimanëve. Ky ngadhënjim i iranianëve idhujtarë ishte i hidhët për myslimanët dhe i brengosi ata në lidhje me rrjedhën e ardhshme të ngjarjeve. Humbja e bizantinëve e mërziiti edhe Pejgamberin a.s..

Lidhur me këtë çështje, Allahu i Lartë zbriti ajetet në suren Err-Rrum. Kurani solli lajmin e gëzuar se bizantinët së shpejti do të korrnin fitore së cilës do t'i gazoheshin myslimanët. Pas kësaj i Dërguari i Allahut tha: “Pa dyshim, persët do të munden!”⁵

Ebu Bekri r.a., i cili e mësoi këtë lajm, vuri bast me idhujtarin Ubej bin Halefi me dhjetë deve, se, brenda tri vjetëve, bizantinët do t'i mundnin persët. Kjo ngjarje kishte ndodhur para se basti të ndalohej. Kur hz. Ebu Bekri r.a. e njoftoi Pejgamberin a.s. për këtë bast, ai i tha: “Fjala ‘bid’i’ në ajet shpreh numrat mes treshit dhe nëntës. Prandaj shko dhe shtojë numrin e deveve dhe zgjate afatin!” Hz. Ebu Bekri r.a. shkoi dhe e zgjati



Muhamedi a.s. kishte parathënë një fitore definitive ushtarake, si ka mundur të dijë se do të ndodhë një gjë e tillë? A do të ishte e drejtë ta vendosnim në kuadër të parashikimeve që bëhen nga ana e strategëve dhe analistëve politikë?



afatin në nëntë vjet, kurse numrin e deveve e shtoi në njëqind. Premtimi u realizua. Bizantinët u shkakjuan iranianeve një disfatë të rëndë.⁶

Ajeti kuranor paralajmëronte diçka që ishte shumë vështirë të realizohej. Në fakt, duke parë disfatën e rëndë të bizantinëve, dukej gati e pamundur që shteti bizantin do të mbijetonte, jo më të fitonte. Jo vetëm persët, por edhe avarët, sllavët e lombardianët përbënin një kërcënim serioz për Perandorinë Bizantine. Avarët kishin arritur deri në muret e Kostandinopojës. Perandori bizantin, Herakliu, urdhëroi që ari dhe argjendi që gjendej në kisha të shkrihej dhe me to të bëheshin para për të përballuar shpenzimet e ushtrisë. Kur këto nuk mjaftuan, edhe statujat e bronzit u shkrinë për t'u kthyer në para.⁷ Sikur të gjithë pritnin nga çasti në çast shkatërrimin e Perandorisë Bizantine. Pikërisht në ato momente u shpallën ajetet e para të sures Err-Rrum, të cilat thoshin se bizantinët do të triumfonin pas pak vitesh.

Shtatë vjet pas shpalljes së ajeteve të para të sures Er-Rum, në dhjetor të vitit 627 e.s., një betejë e përgjakshme u zhvillua ndërmjet ushtrisë bizantine

dhe asaj perse në Niniveh. Ndodhi ajo që s'pritej; ushtria bizantine triumfoi mbi ushtrinë perse. Më në fund, "fitorja e bizantinëve" e shpallur në Kuran u bë realitet. Me ta marrë këtë lajm, Ebu Bekri r.a. mori nga Ubej bin Halefi njëqind devetë dhe ia çoi Pejgamberit a.s.. I Dërguari i Allahut i tha: "Këto ndajua të varfërve!" Dhe ai ua ndau të varfërve. Shumë nga politeistët mekas që e panë këtë mrekulli të Kuranit, u bënë myslimanë.⁸

Prandaj, kush i tha Muhamedit a.s. për betejën e Bizantit!? Ku e mori Muhamedi a.s. këtë guxim, prej nga ky vetëbesim!? A mund të jetë guxim i një njeriu të paditur, apo i një njeriu që zotëronte burim hyjnor?!

Sikur ky lajmërim i Kuranit të tregohej jo i saktë, pa kurrfarë dyshimi do të ishte lëkundur besimi në Kuranin dhe në Muhamedin a.s. dhe shumë do të kishin hequr dorë dhe do të humbnin besimin në fenë islame. Pse të rrezikonte Muhamedi a.s. gjithë mesazhin e tij me një lajm të tillë?! Nëse lajmi do të dilte jo i vërtetë, Pejgamberi a.s. do të humbte më shumë sesa që do të fitonte nëse lajmi tregohej i vërtetë.⁹

Si mund të shpjegojmë parashikimin kategorik dhe të besuar të fitores së popullit që kishte pësuar disfatë nga një popull fitues? Gjendja reale e thoshte të kundërtën. Muhamedi a.s. kishte parathënë një fitore definitive

ushtarake, si ka mundur të dijë se do të ndodhë një gjë e tillë? A do të ishte e drejtë ta vendosnim në kuadër të parashikimeve që bëhen nga ana e strategëve dhe analistëve politikë? Shumë faktorë luajnë rol në fitoren ushtarake dhe edhe gabimi më i vogël në taktikë apo në llogaritje, mund të ndryshoj tërë kursin e betejës.

Prandaj nuk është reale që këtë parashikim ta analizojmë sipas pikë-pamjeve materialiste apo të rastësisë. Filozofi En-Nadham mendon se mbinatyralliteti i Kuranit qëndron në të zbuluarit e të panjohurës nga ana e tij, p.sh. sikurse është rasti edhe me luftën e Bizantit.¹⁰

Kjo ishte një mrekulli tjetër e Kuranit dhe dëshmi e shpalljes dhe provë se Muhamedi a.s. është vërtet i Dërguari i Zotit.

1. Gary Miller, Kurani i Mrekullueshëm (1), Dituria Islame, nr. 367, viti 34, Prishtinë, qershor 2021, Dhul Kaide 1442, f. 42. 2. Muxhizatul El Kuranil Kerim El Ihbar anil mustekbel intisar Er Rum El Bizantinijine ael Furs. <https://article-2011.blogspot.com/2011/04/14523.html> 3. Ahmed, I, 276, sipas Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 328. 4. Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, shih komentin në f. 464 nga Sherif ef. Ahmeti. 5. Ahmed, I, 276, sipas Osman Nuri Topbash, op. cit. f. 328. 6. Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 328. 7. <https://kohaislame.com/fitorja-e-bizantit-ja-cfare-thote-kurani/> (nuk ka autor). 8. Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 328. 9. (Pa autor) Fitorja e romakëve, shih: <http://www.quranmiracles.com/2011/03/fitorja-e-romakeve/> 10. Malik ibën Nebih, Fenomeni kuranor, Prishtinë, 1419/1990, f. 6.

Resul Rexhepi

Pendimi duhet të jetë i singertë

Besimtari kur vendos t'i drejtohet Allahut për falje, ai në kërkesën e tij duhet të jetë maksimalisht i vendosur, i singertë. Pendimin e singertë assesi nuk duhet kuptuar vetëm si veprim mekanik, veprim që mund të bëhet vetëm sa për sy e faqe.

Atë nuk duhet bërë me maje të gjuhës kinse po pendohesh. Ai duhet të bëhet si rezultat i ndjesisë shpirtërore, kur shpirtërisht ke nevojë t'i lutësh Zotit, Krijues për falje dhe moskthim në atë mëkat. Këtu rol të rëndësishëm ka ndërgjegjja e njeriut, e cila e ndjen nevojën për pendesë. Ndjenja e fajësisë, ndjenja e mangësisë dhe e pafuqisë, të shtyjnë që t'i drejtohesh të Gjithëmëshirshmit për falje sepse je penduar sinqerisht. Pastaj, pendimi i singertë duhet të shoqërohet me vepra të mira sa më shumë që është e mundur: “Dhe vërtet që Unë jam Falës i Madh për atë që pendohet, beson (bindshëm në Allahun) dhe bënë vepra të mira e pastaj iu qëndron këtyre (deri në vdekje).”¹

Veprat e mira të përmendura në këtë ajet të Kuranit, shkojnë përtej obligimeve themelore si namazi, agjërimi, zeqati, etj.. Ndër to hyjnë edhe: largimi nga të ndaluarat, përmendja e shpeshtë e Zotit, sjelljet e moralshme, durimi në vështirësi, kërkimfalja e shpeshtë, ndihma ndaj atyre që kanë nevojë, mirësjellja me atë që e njeh dhe atë që nuk e njeh, respektimi i më të vjetërve dhe mëshirimi ndaj fëmijëve e të ngjashme. Pas një gabimi të bërë, duhet nxituar për të bërë më shumë vepra të mira sepse veprat e mira i shlyejnë të këqijat. Në Kuran, është thënë: “Me të vërtetë që veprat e mira i largojnë veprat e këqija. Kjo është këshillë par ata që këshillë marrin. Dhe bënë durim se Allahu kurrë nuk e humb shpërblimin për mirëbërësit.”²

Lidhur me sa u tha më sipër, transmetojnë Ebu Dherr Xhundub

Mbështetur në parimet fundamentale të fesë islame mund të konstatojmë se nuk ka ndonjë mëkat që Allahu nuk e falë, e as mëkatar që Allahu t'ia mbyllë derën e pendimit për shkak të madhësisë së mëkatit të tij

bin Xhunadete dhe Ebu Abdu-rrahman Muadh bin Xhebeli r.a. se Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Ke frikë Allahun kudo që të jesh, të keqën pasojë me të mirë se e fshinë atë, ndërkaq ndaj njerëzve sillu me edukatë.”³ Prandaj, Pejgamberi a.s. me një rast ka konstatuar: “Besimi- imani më i mirë është kur ta di se Allahu është me ty kah do që të shkon.”⁴

Kërkim falja dhe pendimi duhet t'i drejtohen Zotit të Gjithëmëshirshëm kur atë e ndjen shpirtërisht. Kjo ka mundësi të bëhet në çdo kohë dhe jo se ka ndonjë rregull të posaçëm ose procedurë të veçantë. Megjithatë, edhe me këtë rast, si në çdo rast tjetër, e kemi obligim të përfillim udhëzimet

e Pejgamberit a.s., i cili edhe për “teubei-istigfar” na udhëzon:

Tregon Esmac bin Hakemi el-Fezarij⁵ se ka thënë: kam dëgjuar Aliun se kishte thënë: kam qenë goxha burrë kur, nëse dëgjoja nga Pejgamberi a.s. ndonjë hadith, Allahu më bënte dobi aq sa më bënte, e nëse ndonjë hadith ma tregonte ndokush nga shokët e Pejgamberit a.s., i kërkoja të më betohej, e nëse betohej i besoja, një herë Ebu Bekri - i cili gjithmonë flet të drejtën, më dëftoi një hadith se e kishte dëgjuar Pejgamberin duke thënë: “Nëse dikush bënë ndonjë mëkat dhe pastaj merr abdes bukur, ngritët dhe i fal dy rekate namaz dhe kërkon falje nga Allahu, Allahu me siguri do ta falë atë”, - pastaj lexoi këtë ajet të Kuranit: ajetin e 135 të sures Ali-Imran.⁶

Pra, një nga shenjat e imanit-besimit është edhe kërkim falja, pendimi, pishmanllëku, braktisja e mëkatit dhe vendosmëria për mos me e përsërit atë gabim. Aliu r.a. tregon se nga Ebu Bekri r.a. kishte dëgjuar, e nga Ebu Bekri nuk ka kërkuar të betohet për saktësinë e hadithit sepse ai ka qenë i besueshëm, megjithëse kërkesën për betim e ka pas me qëllim bindjeje akoma më të madhe në saktësinë e hadithit e jo për t'i përgënjeshtuar as'habët e Pejgamberit, se Pejgamberi kishte thënë se nëse ndokush bënë një mëkat, të madh ose të vogël, ai duhet të merr mirë abdes, të çohet e t'i falë dy reqate namaz me nijet të pendimit nga mëkati i bërë, pastaj i kërkon falje Allahut për atë gabim, dhe është shpresë e madhe tek Allahu se pendesa e tij do të pranohet sepse



“kush mund t’i falë grynahet përveç Allahut?” Kur njeriu pendohet duke i kërkuar falje Allahut dhe më nuk e përsërit atë gabim, kjo mbase është sinjal i pranimit të pendimit.

Mbështetur në parimet fundamentale të fesë islame mund të konstatojmë se nuk ka ndonjë mëkat që Allahu nuk e falë, e as mëkatar që Allahu t’ia mbyllë derën e pendimit për shkak të madhësisë së mëkatisit të tij, sepse falja dhe amnistia e Allahut është shumë e gjerë dhe e madhe. Porta e pendimit është e hapur edhe për ata të cilët kanë bërë ndonjë mëkat që shkatërron nderin dhe dinjitetin njerëzor, të gjitha deri te pirja e alkoolit që konsiderohet nëna e të gjitha të këqijave. Portën e pendimit nuk mund ta mbyllë askush. Megjithatë, këtu e shoh të arsyeshme të bëjmë një dallim. Ata të cilët dhunojnë të drejtën e të tjerëve, ose edhe iu shkaktojnë dëm material të tjerëve, nëse do të pendohen nga ky mëkat, së pari duhet t’ua kthejnë të drejtën atyre që u takon dhe pastaj të kërkojnë falje. Kjo për faktin se këtu kemi të bëjmë me të drejtën e njeriut dhe kompetencën për faljen e saj Allahu ia ka dhënë vetë Zotit të së drejtës. Pendimet do të pranohen, sepse Allahu sikur i çliron mëkatarët nga pesimizmi dhe humbja e shpresës kur thotë: “Kur ata të cilët besojnë në argumentet tona vinë te ti, thuaju: “Paqja qoftë mbi ju!. Zoti juaj ia ka

obliguar vetës Mëshirën. Nëse ndokush nga ju bënë ndonjë vepër të keqe pa e ditur e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë Allahun Falës të Madh dhe Mëshirëplotë!”⁷

Prandaj, për gabimet karshi Krijuesit të Gjithëmëshirshëm, duhet drejtuar Atij për falje, gjithmonë duke shpresuar në pranimin nga ana e Krijuesit. Ndërkaq, për gabimet ndaj njerëzve, për shkaktimin e dëmeve ndaj njerëzve, për zullumin e shkaktoar ndaj tyre, ai duhet së pari t’ua mundësojë të njëjtëve që ta marrin hakun e tyre, e pastaj të kërkojë hallallëk nga ta. Kërkim falja, me këtë rast, duhet të jetë e çartë dhe konkrete, duke e theksuar qartë se përse bëhet fjalë dhe përse kërkon falje - hallallëk.

Si përfundim

Në përmbyllje të sa u tha më sipër, do ta përmendim faktin se pendimi jo se është i kushtëzuar me ndonjë kohë, vend apo ndonjë kusht tjetër. Po, Allahu i lavdëron ata që pendohen në kohën e agimit (Ali Imran, 17). Pejgamberi a.s. na ka njoftuar edhe me këtë: “Allahu xh.sh. çdo natë, pasi të kalojë një e treta e parë e natës, zbrit në qiellin e dynjasë (pra e sheh me syrin e mëshirës) dhe thërret: ‘A ka ndonjë që më lutet e t’ia pranojë lutjen? A ka ndonjë që kërkon prej Meje e t’i përgjigjem kërkesës së tij? A ka ndonjë që më kërkon falje e Unë ta falë?’⁸ Prandaj, mirë është që të shfrytëzohet çdo moment për t’u penduar, sepse vjen një moment tjetër kur edhe po të pendohesh, gjithçka është vonë. Kur njeriut i vjen shpirti në fytyrë, kur njeriut i afrohet vdekja, pendimi dhe kërkimfalja nuk pranohen, sepse është tepër vonë. Gjithashtu, “porta e teubes” do të jetë krejtësisht e mbyllur kur kiameti të jetë fare afër, atëherë kur dielli të lind nga perëndimi.

O njeri! Ti prore duhet ta kesh në hatër dhe kurrë të mos harrosh se sot, në këtë botë ke për të bërë punë e mbase mund të mos jep llogari, kurse nesër do japësh llogari ndonëse punë më nuk ke për të bërë. Prandaj, afrohu te Zoti me vepra të mira, kërko falje nga Ai dhe pendohu pareshtur, dhe

kurrë mos harro se Zoti është Falës i Madh.

Pse, ti, o njeri nuk pendohesh sot sa nuk të është bërë vonë?!!!

Krejt në fund, siç e thamë edhe më sipër, për kërkimfaljen dhe pendesën nuk ka formë të caktuar. Mjafton që ti në shpirt me e ndje ndjenjën e pishmanllëkut, ndërgjegjja jote me ta kërkuar pendesën. Megjithatë, nëse dëshiron formë të përkryer të kërkimfaljes dhe pendesës, zgjidhe më të bukurën, më të mirën, atë që na ka mësuar më i dashuri i Allahut, zgjidhe formën më të lartë:

*Bismil-lâhîrr-Rrahmânîrr-Rrahîm
Estagfirull-llâhel-’adhîm.*

All-llâhumme ente rabbî lâ ilâhe il-lâ ente halaktenî ve ene ‘abduke ve ene ‘alâ abdike ve v’adike mestet’atu. E’ûdhu bike min sherr-rrî mâ sanâtu ebû-u leke binîmetike ‘alejje ve ebû-u leke fagfîrlî fe innehû lâ jagfirudh-dhunûbe il-lâ ente. Subhâneke innî kuntu mînedh-dhâlimîn ve ente erhamurr-rrâhimîn.

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kërkoj falje nga Allahu i Madhërishtëm. O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka Zot përveç Teje, Ti më krijove e unë jam robi yt, do t’i qëndroj besnik besës dhe premtimit që të kam dhënë për aq sa do të mundem. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam bërë, unë jam mirënjohës për dhuntitë e Tua, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal mua, sepse mëkatet nuk i fal askush përveç Teje. I lartësuar qofsh, unë vërtet kam qenë nga keqbërësit, e Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve.

Vëlla i dashur, përkujtoje sa ma shpesh edhe këtë udhëzim të Pejgamberit tonë – Muhamedit a.s.:

“Zoti ynë gëzohet shumë më tepër për pendesën tuaj, se ç’gëzohet dikush që ka humbur diçka me vlerë dhe e gjen atë pikërisht atëherë kur e ka humbur shpresën se do ta gjejë.”

Prandaj, nxito edhe ti e gëzoje Zotin!

1. Taha, 82, 2. Hud, 114, 3. Transmeton Tirmidhiu.

4. Transmetojnë Taberaniu dhe Ebu Nuajmi. 5. Në origjinalin në arabisht është El-Fezazij, ndonëse në shumë vende e hasa si El-Fezazij. 6. Transmeton Ebu Davudi. 7. El-En’am, 54. 8. Transmeton Buhariu, kreu "Deavat-lutjet", nr. 14.

Isa Tërshani

Vlera e dhjetë ditëve të para të dhul-hixhes

Të nderuar besimtarë, jemi në prag të një muaji të madhshenjtë, muajit dhul-hixhe.

E falënderojmë Allahun xh.sh., i Cili e ka krijuar kohën dhe i ka veçuar disa ditë, net e muaj më të vlefshme se të tjerat, ku shpërblimet janë të shumëfishuara, si mëshirë ndaj robërve të Tij. Kjo na inkurajon të bëjmë më shumë vepra të mira, dhe na bën më të përkushtuar për ta adhuruar Allahun e Madhërisëm, në mënyrë që të fitojmë shpërblime të mëdha. Ky sezon i adhurimit sjell përfitime të shumta, si mundësi për t'i korigjuar gabimet tona dhe të fitojmë faljen e mëkateve duke iu kthyer Zotit me punë të mira. E s'ka dyshim se dhjetë ditët e para të këtij muaji janë shumë me vlerë, saqë Vetë Zoti i Madhëruar betohet: "Pasha agimin, dhe dhjetë netët, pasha çiftin dhe pasha tekun!"¹

Myslimani duhet ta kuptojë vlerën e jetës së tij, ta shtojë adhurimin e tij ndaj Allahut dhe të këmbëngul që të bëjë vepra të mira, deri në momentin e vdekjes.

Dijetarët, duke iu referuar ajetit të sipërcituar janë shprehur se këto ditë janë ditët më të mira të vitit. Person i lumtur është ai që e shfrytëzon shumicën e këtyre ditëve dhe orëve të veçanta dhe i afrohet Zotit të tij përmes akteve të adhurimit. Myslimani duhet ta kuptojë vlerën e jetës së tij, ta shtojë adhurimin e tij

ndaj Allahut dhe të këmbëngul që të bëjë vepra të mira, deri në momentin e vdekjes. Allahu xh.sh. thotë: "Dhe adhuroje Zotin tënd deri të të vjen ty e vërteta (vdekja)."²

Prej sezoneve të mëdha të ibadeteve janë edhe dhjetë ditët e para të muajit dhul-hixhe. Këto ditë Allahu i ka veçuar nga të gjitha ditët e vitit. Transmetohet nga Ibën Abasi se Muhamedi a.s. ka thënë: "Nuk ka ndonjë ditë që veprat e mira janë më të dashura tek Allahu se sa këto dhjetë ditë. I thanë, e as xhihadi në rrugën e Allahut! Tha: As xhihadi në rrugën e Allahut, përveç nëse del njeriu me vetën e tij dhe me pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë."³

Këto argumente dhe të tjera, tregojnë se këto dhjetë ditë janë më të vlefshme se të gjitha ditët e vitit. Gjersa janë më të vlefshme se edhe dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Por, dhjetë netët e fundit të Ramazanit janë më të vlefshme për shkak të përfshirjes së natës së Kadrit në të, e cila është më e vlefshme se një mijë muaj.

Pse janë kaq të vlefshme këto ditë?

E para, Allahu është betuar në këto ditë. Betimi është argument për rëndësinë dhe dobinë e saj; e dyta, Muhamedi a.s., ka dëshmuar se këto ditë janë ditët më të vlefshme të kësaj bote, sikur që tregoj për këto hadithi i lartpërmendur; e treta, Pejgamberi a.s., i ka nxitë besimtarët në vepra të mira në këto ditë për shkak të vlerës së kohës dhe vlerës së vendit për haxhilerët; e katërta, Pejgamberi a.s., na ka urdhëruar që të shpeshtojme



dhikrin, për këtë, transmetohet nga Abdullah b. Umeri se Pejgamberi a.s. ka thënë: "... Shpeshtoni në të fjalët La ilahe il-la Allah, Allahu ekber, dhe elhamdulillah."⁴; e pesta, në këto ditë është dita e Arafatit. Në këtë ditë Allahu xh.sh., e ka plotësuar për robërit e Tij fenë e Tij. Agjërimi i kësaj dite i shlyen mëkatet e dy viteve. Po në këto dhjetë ditë është edhe dita e kurbanit, e që është prej ditëve më të vlefshme në përgjithësi; e gjashta, në këto ditë bashkohen dy ibadetet, e ato janë haxhi dhe kurban.

Të arrish këto ditë është një begati e madhe, prej begatave të Allahut ndaj robërve të Tij është se i ka shumë rrugët e veprave të mira.

Çfarë është mirë të bëjmë në këto ditë?

1. Pendimi nga të gjitha mëkatet dhe istigfari, e që duhet ta themi sa më shumë dhe sa më shpesh;

2. T'u kërkojmë falje njerëzve që i kemi bërë zullum (padrejtësi), qoftë përmes fjalës, apo ndonjë veprimi, apo kthimin e borxhit, apo pagesave të veresive etj.;

3. Të mos na ikin namazet, sepse lënia e namazit, konsiderohet ndër mëkatet më të mëdha në raport mes njeriut dhe Zotit;

4. Bamirësia ndaj prindërve;

5. Të largohemi nga mëkatet, qofshin ato edhe të voglat sipas mundësive, sepse mëkatet në këto ditë janë shumë më të mëdha se në ditët e tjera;

6. Agjërimi vullnetar, e sidomos agjërimi i ditës së Arafatit, për të cilën Muhamedi a.s. ka thënë: "Shpresoj që Allahu të m'i ketë falur mëkatet e vitit të kaluar dhe të vitit që vjen."⁵

7. Të mundohemi të japim sadaka për çdo ditë nga këto ditë;

8. Leximi i Kuranit.

9. Mundohu që të hulumtosh një familje që ka nevojë, dhe ta gëzosh atë familje, duke i përgatitur (financuar) drekën e Bajramit dhe duke ia gëzuar fëmijët me veshje për Bajram.

Le të përfitojmë nga këto shanse në këto ditë madhështore.

¹ El-Fexhr, 1-3. ² El-Hixhr, 99. ³ Buhariu, 457. ⁴ Ahmedî, 224. ⁵ Muslimi, 1162.

Prof. ass. dr. Musa Vila

Haxhiu është delegat i madhërisë hyjnore

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Profeti a.s. ka thënë: "Delegatët e Allahut janë tre: haxhiu, kryerësi i umres dhe luftëtari."¹

Njerëzit në këtë botë për nga pozita që marrin mund të jenë udhëheqës, ambasadorë, delegatë, përfaqësues dhe zëdhënës të pushteteve dhe regjimeve që ndërlidhen me një shtet, union, zonë apo njësitë. Jo rrallëherë njerëzit përmes këtyre detyrave ndihen të privilegjuar, të shpërblyer, autoritativë dhe krenarë. Mirëpo me kalimin e kohës këto pozita harxhohen dhe njeriu kthehet i lodhur, i rraskapitur, dhe i braktisur nga shoqëria, rrethi e ndoshta edhe nga gjiri i ngushtë farefisnor. Dikush e lavdëron, e shumë kush e fajëson dhe e ofendon. Pozita dhe krenaria e tij ishin të përkohshme dhe përfunduan me lodhje dhe pesimizëm, e ndoshta edhe i mërëzitur nga kjo jetë. Ndërkaq,

kur kryen një obligim fetar sikurse haxhi, ai shijon emocione dhe përjetime që janë të pavdekshme dhe mbetet i lumtur e optimist. Njerëzit janë krenarë me të qenët e tyre delegat i Allahut xh.sh..

Këtu qëndron kulminacioni i mburrjes dhe krenarisë. Besimtari i devotshëm për ta fituar këtë ofiq kaq të madh bën një sakrificë në shpirt, trup dhe pasuri. Ai duke iu përgjigjur ftesës hyjnore për haxh, bën pastrimin e njetit duke e nxjerr nga pasuria e tij një pjesë të saj për furnizim. Me këtë ai tregon sa ka vlerë ajo vepër që kryhet vetëm për hir të Krijuesit, duke mposhtur çdo pasion të kësaj bote dhe duke u orientuar në begatitë dhe interesat e dy botëve.



Në këtë botë manifeston dhe demonstroi gatishmërinë e tij se është në gjendje të marrë pjesë në kongresin e milionave delegatëve të Allahut xh.sh., ku maksima e tyre është “paqe, unitet, drejtësi dhe barazi për të gjithë”. Ndërsa, në botën tjetër do të jetë i privilegjuar dhe krenar që ishte delegat i Allahut xh.sh..

Në haxh kemi shumë rreze të dritës që ato i ndien besimtari i devotshëm e njeriu i ndërgjegjshëm, ai që ka

Në haxh kemi shumë rreze të dritës që ato i ndien besimtari i devotshëm e njeriu i ndërgjegjshëm, ai që ka moral dhe etikë njerëzore. Aty, njerëzit arrijnë që fytyrat e tyre të jenë të ndriçuara dhe të dorëzuara vetëm Allahut xh.sh..

moral dhe etikë njerëzore. Aty, njerëzit arrijnë që fytyrat e tyre të jenë të ndriçuara dhe të dorëzuara vetëm Allahut xh.sh..

Aty shihen delegatët që zemrat e tyre i kanë përplot besim, mëshirë dhe dashuri ndaj Madhërisë hyjnore dhe të Dërguarit të Tij. Aty derdhen lotët e gëzimit që rrjedhin si lumë. Delegatët janë përplot emocione që nuk mund t'i përballojnë pa lot në sy. Emocionet lindin vetvetiu. Disa nga dashuria e madhe për ta kryer dhe realizuar obligimin e fundit islam, disa emocione janë si përjetim i atmosferës aq madhështore që krijohet në atë vend të shenjtë, disa

vijnë nga përmallimi dhe mallëngjimi për Shtëpinë e Shenjtë, disa vijnë nga të parët e shumë lloj rasash dhe ngjyrash nën flamurin islam, nën flamurin “La ilahe il-lallah”. Kështu që shumë gjëra ndodhin që nuk mund të përshkruhen e as të thuren. Por, një është e qartë se mbi gjitha dominon adhurimi i sinqertë dhe korrektësia ndaj Madhërisë hyjnore. Në kontekst me këtë Allahu xh.sh. thotë: “...Dhe ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim më të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, ta japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.” (El-Bejjineh, 5)

Të sinqertë, duke e ditur se haxhi i pranuar ka për shpërblim Xhenetin, ata me ndihmën e Allahut u zhveshën nga çdo gjë e injorancës dhe u drejtuan sinqerisht kah Allahu, me pendim, adhurim, nënshtrim dhe dëgjueshmëri.

Zëri i tyre që dilte nga gjuhët e pastra ngitej lart në qiell dhe jehonte me një jehonë të fuqishme nga ajo turmë e devotshme dhe e nënshtruar e delegatëve. Ata thoshin: “Lebbejke

Allahumme lebbejk lebbejke la sherike leke lebbejk, innel hamde ve ni'mete leke vel mulk la sherike lek; (Të përgjigjem o Zot (në ftesën tënde) vetëm ty të përgjigjemi se Ti nuk ke rival, vërtet lavdërimet, begatitë dhe sundimi janë vetëm për ty, se ti nuk ke rival”. Kjo thirrje (përgjigje) e cila buron nga miliona delegatë të Allahut xh.sh. njerëzit i kthejnë në natyrshmërinë e tyre të pastër. Përgjigjja është simbol i besimtarëve në çdo adhurim, ngase adhurimet kanë një synim. Ato edhe pse ndryshojnë në formë, mënyrë, kohë dhe sasi, prapë se prapë takohen në një synim. Ai synim është të vërtetuarit e nënshtrimit të sinqertë vetëm për Allahun në çdo sferë të jetës. Në këtë kontekst Allahu xh.sh. thotë: “Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve! Për të nuk ka rival. Dhe për këtë jam i urdhëruar.” (El-En'amë, 162)

“Unë me veten time i drejtohem atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që në adhurime i bëjnë rivalitet.” (El-En'amë, 79)



Delegatët e Tij në haxh janë pasqyrë e unitetit

Që në start, delegatët e Madhërisë hyjnore me veshjen e ihramit demonstrojnë pastërti nga pasioni, epshi, egoizmi etj.. Për t'u drejtuar kah Zoti i tyre i cili e di synimin e çdo besimtar, andaj ai besimtar nuk bën ndonjë vepër përveçse përputhet me kënaqësinë e Zotit të tij. Haxhiu – delegat në çdo hap, sjellje është nën kontroll. Ai i respekton të drejtat e të tjerëve dhe nderon urdhrat hyjnor. Kështu ai nuk rrëshqet, nuk humb e as nuk gabon ndaj të tjerëve. Me këtë haxhiu delegat mbetet njeri me trupin e tij, e me veprat dhe shpirt i përngjet melekëve. Ai i respekton delegatët e tjerë duke mos u fjalosur me askënd. Aty askush nuk rebelohet ndaj tjetrit. As njeriu ndaj njeriut, e as turma ndaj turmës. Të gjithë në aspektin njerëzor janë vëllezër. Të gjithë janë bijtë e Ademit. Njeriu është njeri me moral, etikë dhe sjellje. Delegatët e Zotit aty janë pasqyrë e bukur e unitetit. Ata demonstrojnë një barazi të gjallë me të gjitha tiparet që ka ardhur legjislacioni islam. Ky legjislacion nuk është zbritur që njerëzit të jenë të lumtur vetëm në adhurime, por në çdo pore të jetës. Delegatët janë bashkuar në dëgjueshmëri, ata e ndihmojnë njëri-tjetrin në të mira dhe devotshmëri. Aty nuk ka lajthitje e as hipokrizi, e as intriga e mashtrime. Aty është siguria, drejtësia dhe kontrolli hyjnor. Në haxh sa e sa takime realizohen. Aty krijohet një kongres i pastër me nivel ndërnacional ku nuk ka as dominim, as egoizëm e as tradhti. Aty rikonfirmohet toleranca shpirtërore. Njerëzit njëri-tjetrin e këshillojnë dhe e ndihmojnë. Pra, legjislacioni islam përmes këtij obligimi dëshiron prej besimtarëve që ndaj njëri-tjetrit të jenë të mëshirshëm dhe operativ, ngase kanë një prejardhje njerëzore, kanë një fe, një kible dhe një Zot, që

ata të sakrifikojnë dhe mos të bien viktimë e armiqve për shkak të kontesteve dhe përçarjeve të ndryshme. Allahu xh.sh. thotë: “Mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake).” (El-Enfalë, 46), dhe ta arrijnë devotshmërinë. Allahu xh.sh. thotë: “Dhe dijeni se Allahu është me të devotshmit.” (El-Bekare, 194)

Në hadithin bazë shihet një radhitje mjaft adekuate. Për nga pozita, vlera dhe shpërblimi haxhi krahasohet me luftëtarin i cili çdo gjë sakrifikon vetëm e vetëm për ta mposhtur (përmbysur) armikun. Po ashtu edhe haxhiu në haxh me qëllimin e tij të pastër, e sakrificën në pasuri, lodhjen në trup dhe shpirt e mposht armikun e përbetuar të njeriut – djallin. Kurrë më i mërziur nuk është djalli se sa në kohën e haxhit, në ditën e Arafatit kur i sheh njerëzit të bashkuar krah për krah në veshje, ecje, ndeje, qëndrime, lutje dhe synim. Në një version tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Luftëtarin në rrugën e Allahut, haxhiu dhe vizituesi i Qabesë janë delegatët e Allahut. Ata i thirri Allahu dhe ju përgjigjen Atij. Ata kërkuan nga Allahu, dhe iu është dhënë atyre atë që kërkuan.”²

Për delegatët e Zotit, haxhi dhe umreja janë mposhtje të varfërisë dhe pastrim të mëkateve. Në këtë kontekst Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur ta kryeni haxhin, kryejeni edhe umren; dhe kur ta kryeni umren kryejeni edhe haxhin, se vërtet ato janë mposhtje e varfërisë dhe pastrim prej mëkateve. Ashtu siç e pastron zjarri hekurin, arin dhe argjendin nga mbeturinat e tyre. Dhe për haxhin e pranuar nuk ka shpërblim tjetër, përveç se me Xhenet.”³

Pastrimi prej mëkateve është me përmasa edhe më të mëdha. Në haxh ngrihen shpërblimet, shkruhen të mirat dhe shlyhen të këqijat në çdo ecje dhe hap që e bën delegati – haxhiu rreth Qabesë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush sillet (bën tavaf) rreth Qabesë shtatë herë, ende pa e vendosur njëren këmbë dhe pa e

ngritur tjetren përveçse Allahu xh.sh. me atë ia shlyen një mëkat, e në vend të saj ia shkruan një të mirë dhe me atë e ngritë në shkallë më të lartë.”⁴

Për delegatët e Zotit në haxh çdo gjë është e programuar. Çdo obligim dihet kur fillon, nga fillon dhe kur mbaron. Ibrahim a.s. dëshiroi që njerëzit kur ta fillojnë tavafin ta kenë shenjën e tyre. Ai kërkoi nga biri i tij, Ismaili, që të sjellë një gur veçues dhe dallues nga gurët e tjerë për të qenë aty fillimi i tavafit. Ismaili a.s. filloi të kërkojë një gur të tillë sa që shkoi shumë larg për ta gjetur. Kur papritmas e pa babanë e tij duke e vendosur gurin e zi në vendin e tij. E ai e pyeti babanë e tij se kush ia solli atë gur. Ai i përgjigjet: “Këtë gur ma solli Ai i Cili më mundësoi të mos mbështetem vetë te ti.” Tregohet se atë gur e kishte sjell Xhibrili a.s. prej qiellit. Ai është gur qiellor i vetmi në tokë. Ai është një gjurmë e mbetur nga ndërtimi i Ibrahim a.s. deri më sot. Është i vetmi gur që buzët e nderuara të Pejgamberit a.s. e kanë puthur. Këtë e kanë pasuar sahabët, shokët e tij të nderuar dhe gjithë besimtarët deri në Ditën e Kiametit. Ky gur aq me vlerë do të dëshmojë Ditën e Kiametit për çdo njeri që e ka përshëndetur, e në veçanti për delegatët haxhinj.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Me të vërtetë ky gur ka gjuhën dhe dy buzët për të dëshmuar Ditën e Kiametit për secilin që me sinqeritet e ka përshëndetur.”⁵

Në këtë sezon të haxhit, e në veçanti gjatë qëndrimit të delegatit – haxhiut në Arafat, Allahu xh.sh. krenohet dhe lavdërohet para banorëve të qiellit me punën e banorëve të tokës (Arafatit). Pejgamberi a.s. ka thënë: “Vërtet Allahu krenohet me njerëzit në Arafat para melekëve të qiellit dhe thotë: “Shikoni robërit e Mi, kanë ardhur tek Unë të rras-kapitur dhe të pluhurosuar.”⁶

Në anën tjetër, ata që prezantojnë në Arafat kanë shpresë për të shpëtuar nga zjarri i Xhehenemit. Këtë më së miri e tregon hadithi i përcjell nga Xhabiri r.a. se vërtet Pejgamberi a.s.



ka thënë: “Nuk ka ditë më të vlefshme tek Allahu se sa dhjetë ditët e dhul-hixhes.” Ai tha se një person pyeti: “O i Dërguar i Allahut, ato ditë a janë më të vlefshme se sa ditët e përgatitjes për xhihad në rrugën e Allahut? Ai tha: “Ato janë më të vlefshme tek Allahu se sa ditët e përgatitjes për xhihad në rrugën e Allahut. Nuk ka ditë më të vlefshme tek Allahu se sa dita e Arafatit. Allahu zbret në qiellin e kësaj bote dhe krenohet me njerëzit e tokës para banorëve të qiellit dhe thotë: “Shikojini robërit e Mi të rraskapitur, të pluhurosur, të kallur në diell, kanë ardhur prej viseve të largëta duke shpresuar mëshirën Time, pa e parë dënimin Tim. Asnjë ditë që del nuk ka më tepër të liruuar nga zjarri se sa dita e Arafatit.”⁷

Vërtet kjo ditë është madhështore. Këtë e bën madhështore dashuria aq e madhe e njerëzve. Të gjithë përnjëherë e madhërojnë Allahun dhe i luten atij për vetveten, familjen, fafesisin dhe mbarë besimtarët kudo që gjenden. Epilogu i këtij takimi të madh, në këtë vend të madh është mëshira dhe falja e këtyre njerëzve nga ana e Allahut xh.sh..

Në hadithin e përcjell nga Enesi r.a. tregohet se Pejgamberi a.s. kishte qëndruar në Arafat, e dielli ishte kah perëndonte kur i tha Bilalit: “Qetëso njerëzit.” Bilalli u ngrit dhe tha: “Heshtni po ju thotë Pejgamberi a.s.”. E njerëzit heshtën. Ai u tha: “O njerëz, tani ishte Xhibrili tek Unë. Më përcolli përshëndetjet nga Zoti dhe tha: Me të vërtetë Allahu ka bërë falje për njerëzit e Arafatit, njerëzit e vendit të shenjtë (Muzdelife dhe Mine) dhe i ka siguruar edhe ata që gjenden (vizitojnë) në vendet që pasojnë pas tyre (në haxh). Omeri u ngrit dhe tha: “Kjo është ekskluzive për ne?” Ai tha: “Kjo është për ju dhe për ata që vijnë pas jush deri në Ditën e Kiametit.” Omeri r.a. tha: “Të mirat e Allahut janë shtuar dhe janë begatuar.”⁸

Po ashtu Pejgamberi a.s. është lutur për falje për ata që kur lirohen nga obligim i haxhit (ihrami) e rruajnë kokën apo e qethin. Kjo është një vepër konvencionale e marrë nga tradita e bujshme e Pejgamberit a.s. gjatë kryerjes së haxhit. Pejgamberi a.s. është lutur me këto fjalë: “O Zoti im, mëshiro ata që e rruajnë kokën.” Ata të (pranishmit) i thanë: “E për ata që bëjnë shkurtimin e flokëve, o i

Dërguar i Allahut?” Ai tha: “O Zoti im, mëshiro ata që e rruajnë kokën.” Ata thanë: “E për ata që bëjnë shkurtimin e flokëve, o i Dërguar i Allahut? Ai tha: “Edhe për ata që bëjnë shkurtimin e flokëve.”⁹

Të gjitha këto që u potencuan më lart vlejnë për të dy gjinitë, si për gjininë mashkullore ashtu edhe për gjininë femërore. Ngase me termin delegat i Zotit në haxh përfshihet edhe gjinia femërore. Haxhi për gratë është në vend të xhihadit.

Përcillet nga Aisheja r.a. se e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut: “A nuk bën edhe ne të dalim me ju për të luftuar, se vërtet nuk kam parë vepër më të vlefshme në Kuran se sa xhihadit?” Ai tha: “Jo, vërtet për ju xhihadit më i mirë është haxhi në Shtëpinë e Shenjtë, haxhi i pranuar.”¹⁰

Pra, të mirat dhe begatitë e haxhit janë të shumta. Për secilën vepër në haxh delegati i Zotit kishte shpërblim të veçantë. Nuk kishte vend e as vepër në haxh e që Pejgamberi a.s. të mos ishte lutur për ta për mirësi, mëshirë dhe falje. Nuk na mbetet tjetër përveçse të jemi më vigjilent, më praktikuese dhe të shtojmë adhurimet dhe respektin e plotë çfarë e meriton haxhi si dhe dhjetë ditët e muajit të haxhit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ka vepër të mirë më të dashur tek Allahu se sa ajo vepër që bëhet gjatë këtyre dhjetë ditëve.”¹¹

Për ne mbetet që vërtet të bëjmë vepra të mira, t'i shfrytëzojmë këto dhunti deri në maksimum. Se kjo është një kohë që ka të mirat e saj të veçanta që nuk mund t'i gjejmë në kohërat dhe obligimet e tjera. Le të jetë krenar dhe shumë i lumtur ai që i mundësohet të e kryejë haxhin dhe t'i përjetojë këto begati dhe të mira të atij vendi të shenjtë.

1. *El-Hakim*, “*El-Mushtedrek ala sahihajn*”, vëll. I, fq.441. 2. “*Sunen Ibën Maxhe*”, nr.2893. 3. “*Musned li Ibën Hanbel*”, vëll.I, fq.387. 4. *El-Hakim*, “*El-Mushtedrek ala sahihajn*”, vëll.I, fq.489. 5. “*Musned Ebi Ja'la*”, nr. 2719; *El-Hakim*, “*El-Mushtedrek ala sahihajn*”, vëll. I, fq.457. 6. “*El-Ihsan fi takrib Sahih Ibën Hiban*”, vëll.IX, fq.163. 7. *Po aty*; vëll.9, fq.163, nr.3852. 8. “*Et-Tergibu ve T-terhib*”, lil Mundhiri, vëll. II, fq.203. 9. “*Sahihul Buhari*”, bab el-halk ve taksir, nr. 1727. 10. “*Sahihul Buhari*”, nr.1520. 11. “*El-Edhkar li Nevevij*”, fq.226, nr.523.

Muhamed B. Sytari

Pejgamberët në lutjet e tyre

Në Librin e Allahut, shohim madhësinë e lutjes në jetën e mësuesve të mëdhenj të njerëzimit, si një dëshmi e mrekullueshme që na fton të mos hezitojmë e të mos lëmë pas dore këtë sekret të madh që na është dhënë në komunikimin tonë të përhershëm me Zotin e gjithësisë

Kushdo që lexon në Kuranin famëlartë, do të gjejë në shumë vende shembuj të spikatur të lutjeve plot përkushtim të pejgamberëve të dërguar, sipas rrethanave dhe situatave të ndryshme në jetën e tyre.

Përtej larmisë së këtyre lutjeve, ka një mësim të madh, që na drejtohet në çdo kohë e situatë dhe që është se njeriu, përtej pozitave dhe gradëve të besimit dhe përkushtimit në jetë, përherë është nevojtar për Zotin, dyert e të Cilit nuk mbyllen kurrë për robin e Tij, edhe jobesimtar të jetë! Zoti thotë: “O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd”.¹

Mësojmë dhe kuptojmë se lutja është një mundësi e madhe për të ndryshuar realitetet dhe vështirësitë e

Njeriu, përtej pozitave dhe gradëve të besimit dhe përkushtimit në jetë, përherë është nevojtar për Zotin, dyert e të Cilit nuk mbyllen kurrë për robin e Tij, edhe jobesimtar të jetë!

jetës sonë, pa të cilat kjo jetë s’do kishte kuptim dhe për të cilën Allahu i Madhëruar na mëson se: “Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni

shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve.”²

Kështu, njeriu është i ftuar që të mësojë artin e lutjes, të edukohet me Zotin e tij, të respektojë urdhëresat, të largohet nga ndalesat, të kontrollojë burimet e rizkut të tij dhe mbi të gjitha, të jetë prezent me zemrën e tij, jo i hutuar a i shpërqendruar në lutje. Sepse, siç kemi mësuar nga edukatorët tanë se prej etikës së lutjes, është prezenca e zemrës dhe që njeriu të mos jetë i hutuar, sepse është transmetuar se Resulullahu a.s. ka thënë: “Allahu i Madhëruar nuk i përgjigjet lutjes së robit, nga një zemër e shpërqendruar.”³

Ndërsa prej kushteve të saj, është burimi hallall i rizkut, sepse Resu-



lullahu a.s. i tha Sadit r.a.: “Le të jetë ushqimi yt i pastër, të të përgjigjet lutja jote!”^{4,5}

Nga një vështrim i shpejtë në Librin e Allahut, shohim madhësinë e lutjes në jetën e mësuesve të mëdhenj të njerëzimit, si një dëshmi e mrekullueshme që na fton të mos hezitojmë e të mos lëmë pas dore këtë sekret të madh që na është dhënë në komunikimin tonë të përhershëm me Zotin e gjithësisë, që na fton: “Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”⁶

Në këtë kontekst, dua të vendos para duarve tuaja disa shembuj të përzgjedhur nga duartë e ndryshme të shumë prej të dërguarve të Allahut xh.sh. në kohë të hershme dhe për shkaqe të ndryshme, si një mësim i urtë për secilin prej nesh, që të mos frenohemi kur është koha për t’u drejtuar nga Zoti ynë për çdo gjë në jetë. Ndoshta, ky është edhe një prej shkaqeve, që i Dërguari i Allahut a.s., i udhëzonte sahabët e tij, që për çdo situatë, të drejtoheshin nga dyert e lutjes: “Resulullahu (paqja e Allahut qoftë mbi të) na mësonte istiharen (namazin me lutjen për qartësimin e përzgjedhjes në jetë) në të gjitha çështjet, njësoj siç na mësonte suret e Kuranit...”⁷

Hz. Ademi a.s. dhe nëna jonë, Hava: “Ata thanë: ‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit...”⁸

Hz. Nuhu a.s.: “(Nuhu) tha: ‘O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më quajnë për gënjeshtar!’”⁹

Po ashtu përmendet duaja e tij, a.s., në një moment të thirrjes së tij dhe kundërshtive të forta të popullit të tij idhujtar: “Dhe Nuhu tha: ‘O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues, sepse, nëse Ti i lë, ata do t’i shpien në humbje robërit e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe

Në Librin e Allahut, shohim madhësinë e lutjes në jetën e mësuesve të mëdhenj të njerëzimit, si një dëshmi e mrekullueshme që na fton të mos hezitojmë e të mos lëmë pas dore këtë sekret të madh që na është dhënë në komunikimin tonë të përhershëm me Zotin e gjithësisë

jobesimtarë! O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtare, ndërsa keqbërësve shtoj vetëm shkatërrim...”¹⁰

Hz. Junusi a.s.: “(Kujtoje) Dhuninin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: ‘S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar.’”¹¹

Hz. Ibrahim a.s.: “Kur Ibrahim u lut: ‘Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoj me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!’ Allahu tha: ‘Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.’ Eh, sa vendbanim i keq që është ai!”¹²

Hz. Ibrahim a.s. dhe i biri, Hz. Ismaili a.s.: “Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Qabesë, u lutën: ‘O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! O Zoti ynë!



Na bëj të përlur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlur ndaj Teje! Tregona ritet e haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti! O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'u lexojë shpalljet e Tua, t'ua mësojë librin dhe urtësinë (rregullat e fesë) e t'i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!"¹³

H. Luti a.s.: "Ai tha: 'O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti.'"¹⁴

Për këtë, Resulullahu thoshte: "E mëshiroftë Allahu Lutin, ai ishte mbështetur te një shtyllë e fortë!"¹⁵, që nënkupton mbështetjen e tij në Allahun e Madhëruar dhe lutjen e tij drejtuar Zotit të gjithësisë për ta shpëtuar nga zullumet e popullit të tij.

H. Zekerija a.s.: "Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: 'Zoti im! Dhuro më nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!"¹⁶

H. Sulejmani a.s.: "Ne e vumë në provë Sulejmanin dhe vendosëm në fronin e tij një trup, por ai iu drejtua Zotit dhe tha: 'O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!' Pastaj, Ne ia nënshtuam atij erën që të frynte me urdhrin e tij, andej nga të donte ai..."¹⁷

Po ashtu në Kuran është regjistruar edhe lutja e tij a.s., në momentin kur dëgjoi milingonën duke dhënë kushtrimin e saj: "Kur arritën në luginën e milingonave, një milingonë tha: 'O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë.'"¹⁸ Këtu, h. Sulejmani a.s., iu drejtua Allahut të Madhëruar me një lutje falënderimi, që është përjetësuar në Shpalljen hyjnore: "Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: 'O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të

cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!"¹⁹

Kanë thënë: "Kjo është prej duave më gjithëpërfshirëse dhe prej më të përshtatshmeve për gjendjen e tij a.s., duke parë dhuntitë e Allahut xh.sh., prej mbretërisë madhështore dhe mirësisë së dukshme."²⁰

H. Shuajbi a.s.: "Paria arrogante e popullit të tij tha: 'O Shuajb! Kthehuni në fenë tonë ose do t'ju dëbojmë nga qyteti ynë ty me gjithë ndjekësit e tu.' Shuajbi tha: 'Edhe pse e urrejmë atë?! Nëse do të ktheheshim në fenë tuaj, pasi Allahu na shpëtoi nga ajo, atëherë do të shpifnim gënjeshtër kundër Allahut. Ne nuk mund të kthehemi në të, përveçse po të dojë Allahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijeninë e Vet dhe tek Ai ne mbështetem. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë.'"²¹

H. Jusufi a.s.: "Ai tha: 'O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).'"²²

H. Musa a.s.: "Kështu, Musai u dha ujë kafshëve të tyre e pastaj u kthye te një hije dhe tha: 'Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!'"²³

H. Isa a.s.: "O Allah, o Zoti ynë! – tha Isai, i biri i Merjemes – Zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!"²⁴

Është për t'u theksuar se të gjithë të dërguarit e përmendur në Kuran me lutjet e tyre, dëshmon për mënyrat se si i janë drejtuar Zotit, me përjashtim të h. Muhamedit a.s., të cilin e mëson Vetë Allahu i Madhëruar se si e çfarë të lutet, si për shembull: "Thuaj (o Muhamed): 'O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e

mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ti bën që nata të hyjë te dita dhe që dita të hyjë te nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij."²⁵

Po ashtu, spikat edhe lutja e melekeve a.s.: "Ata (melekët), që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: 'O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakëruës! O Zoti ynë, shpjeri ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me të devotshmit prej prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të vërtetë, është shpëtimi i madh!"²⁶

Në librat e shumtë të haditheve, mësojmë me qindra lutje, të transmetuara nga i Dërguari i Allahut, si një mundësi më shumë për të mësuar se si t'i drejtohem Zotit tonë, por edhe si një udhëzues praktik, që na mëson mbi të gjitha shpirtin e lutjes dhe na frymëzon drejt mos ndarjes nga kjo mirësi, dera e së cilës nuk na mbyllet asnjëherë në jetë!

1. Fatir, 15. 2. Ali Imran, 186. 3. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ahmedi, nga Ebu Hurejra r.a. 4. Transmetuar nga Taberianu në "Es-Sagir", nga Sad ibën Ebi Vekkas r.a. 5. El-Alame Ebil-Kasim El-Kushejri, "Er-Risaletul-Kushejrije", botimi i tretë, Darul-Khajr, Damask, 1997, f. 267. 6. El-Bekare, 186. 7. Transmetuar nga Imam Bukhariu e të tjerë, nga Xhabir ibën Abdilahu r.a. 8. El-Araf, 23. 9. El-Muminun, 26. 10. Nuh, 26-28. 11. El-Enbija, 87. 12. El-Bekare, 126. 13. El-Bekare, 127-129. 14. El-Ankebut, 30. 15. Transmetuar nga Imam Bukhariu, nga Ebu Hurejra r.a. 16. Ali Imran, 38. 17. Sad, 34-36. 18. En-Neml, 18. 19. En-Neml, 19. 20. Abdurrezak ibën Abdelmuhsin El-Bedr, "Fikih-ed'ijeti vel-edhkar", botimi i parë, Mektebetu Daril-Minhaxh, Rijad, 1434 h., f. 836. 21. El-Araf, 88-89. 22. Jusuf, 33. 23. El-Kasas, 24. 24. El-Maide, 114. 25. Ali Imran, 26-27. 26. Gafir, 7-9.

Dr. Bahri Hoxha

Kontakti i hyjnores me johyjnores dhe efektet akaidologjike

Me gjithë dallimet ndërmjet njerëzve të besimeve të ndryshme në perceptimin e tyre ndaj hyjnores, thuhet të gjithë pasuesit e feve monoteiste pajtohen në ekzistimin e saj, si në kuptim të emërtimit po ashtu edhe në trajtimin e saj si koncept.

Tri fetë monoteiste dhe jo vetëm, e kanë më se të qartë nivelin konseptual të hyjnores si nocion përmbajtësor, që në vete përfshin anën transcendentale dhe të fshehtë të asaj ekzistence të përkryer dhe të pakapshme nga perceptimi ndijor empirik (الإدراك الحسي). Edhe pse në parim, si nocione të ndara, edhe hyjnorja edhe johyjnorja kanë konceptin e qartë të shumica e feve dhe disiplinave të caktuara shkencore, ato në shpjegimet, sidomos fetare, në shumë raste pikëtakohen dhe prodhojnë efekte interesante në aspektin besimor, që në shumicën e rasteve nuk definojnë lehtë, sidomos në disa parametra të shpjegimeve të caktuara fetare. Megjithatë, këtu nuk do të flasim vetëm për mundësinë e kuptimit ose jo të këtyre dy koncepteve, por edhe për aspektin

**Te hebrejtë
vërejmë se
kuptimi i hyjnores
dhe shtjellimi i
realitetit të saj
zbret pa ngurrim
në nivel të
paraqitjes
johyjnore dhe
antropomorfeke të
Zotit dhe cilësive
të Tij, duke mos
shfaqur asnjë
kokëçarje rreth
ngatërrimit të dy
koncepteve në
mes vete.**

rezultatit të pikëtakimit të këtyre dy koncepteve në mes vete, si dhe për format e qasjeve tekstuale fetare, në përpjekje për të arritur deri te definimi i realitetit të tyre.

Në relacionin teorik dhe besimor, shumë doktrina humbin balancën teorike e praktike në përpjekjen për të sqaruar pikëtakimet e hyjnores me johyjnores.

Te hebrejtë

Hyjnorja te hebrejtë pasqyrohet në librin e shenjtë me një imazh të johyjnores. Zoti në traditën hebraike ka karakteristika të njerëzore. Ai në disa raste paraqitet si diçka që përkufizohet në kufijtë e lëndores. Perëndia, kur takohet me Abrahamin, i shfaqet atij në mes lisash në pikën e zhegut në rrafshinat e Mamreut. Biseda dhe qëndrimi i Abrahamit pasqyrohet të jetë “ballë për ballë” me Zotin.¹ Pastaj, në kërkesën e Moisiut që të shoh Zotin, i bëhet e ditur se ka mundësi ta shoh Zotin vetëm nga ana e kurrizit (anën e pasme) dhe jo fytyrën e Zotit.² Në bisedën e Tij me Abrahamin, Zoti shfaq qëllimin e Tij pse ka ardhur të vizitojë popullin e Lotit, duke vënë në pah se qëllimi është të vërtetojë lajmet që i janë ofruar, se populli i Lotit bëjnë veprime në kundërshtim me urdhrat e Zotit, në rast të kundërt,



Isai – Jezusi, i lindur si foshnje, dhe i rritur sikur fëmijët e tjerë, pozicioni i tij ngritët në nivel hyjnor. Prandaj pozita e Isait – Jezusit a.s., përmban dy karakteristika, në bazë të së cilave cilësohet edhe si Zot edhe si bir Zoti.

Zoti vjen Vetë që të njoftohet me realitetin.³ Këto dhe tekste të tjera të cilat janë bukur të shumta dhe gjerësisht të shpërndara në librin e shenjtë hebraik, vënë në pah animin kah lëndorja të teksteve hebraike në definimin e konceptit të hyjnore dhe paraqitjes së saj. Kjo është edhe rruga që kanë ndjekur hebrenjtë në shpjegimin e aspekteve që ndërlihen me hyjnoren, të paraqitura në librin fetar. Derisa më vonë, dhe pas një ndikimi nga dijetarët islamë, shfaqen edhe përpjekjet e Musa bin Mejmunit (Moshe Mamonidi), i cili anon me ngulm drejt një kuptimi joliteral të teksteve të tilla biblike hebraike, të cilat paraqesin kuptimin e hyjnore me parametra antropomorfikë. Pra, te hebrenjtë vërejmë se kuptimi i hyjnore dhe shtjellimi i realitetit të saj zbret pa ngurrim në nivel të paraqitjes johyjnore dhe antropomorfike të Zotit dhe cilësive të Tij, duke mos shfaqur asnjë kokëçarje rreth ngatërimit të dy konspekteve në mes vete.

Në doktrinën e krishterë

Në doktrinën e krishterë të shpjegimit të besimit, vërejmë një qasje jo edhe aq mirë të kuptueshme sa i përket relacionit në mes të hyjnore dhe johyjnore. Në shpjegimet krishtere rreth kuptimit të besimit në Zotin Një, gjejmë ndërhyrjen e trinitetit si teori besimore. Kjo e bën shumë të paqartë njëshmërinë e Zotit në kuptimin besimor për shkak të ndërhyrjes së elementeve (الأقنيم) të tjera bashkëpjesëmarrëse në vetë identitetin e Zotit. Nuk e shohim këtu se është vendi për të sqaruar detajet e këtij koncepti besimor, porse në atë që na intereson në këtë rast, mund të vërejmë se nga shkaktarët kryesorë të këtij disbalanci besimor, pikërisht është edhe nevoja për t'i caktuar vend hyjnor njërit prej elementeve që në fakt është johyjnor. Dhe kjo për faktin se ajo që ndodhi me lindjen e Isait pa baba, duhet të ketë një shpjegim. Shpjegimi domosdo duhet të jetë delikat, ndoshta edhe misterioz e i pakapshëm për arsyen njerëzore,⁴ për shkak se kemi një ndërhyrje jo të zakonit të hyjnore në johyjnoren, për dallim nga lindjet e tjera, në të cilat kjo ndërhyrje është shumë më jodirekte, duke qenë se, proceset zhvillohen në rrugën e tyre të zakonit, për të rrjedhur gjërat në relacionin e pranuar logjikisht, shkak-pasojë. Dhe rrjedhimisht, në mënyrë që të vihet deri te definimi i raportit në ekuacionin e pikëtakimit në mes fizikës dhe metafizikës, që kësaj here ishin aq të ngërthyer në mes vete, erdhi deri te “lirimi nga kllapat”, me të cilin proces duhej, ose të zbris hyjnorja në nivelin e njerëzores, ose njerëzorja të ngritët në nivel të hyjnore. Duke qenë se e para është më origjinale, eternale dhe bazike për t'i dhënë kuptim një besimi, ajo qëndroi statike, për t'i lëshuar rend të dytës. Dhe, si rezultat, Isai – Jezusi, i lindur si foshnje, dhe i rritur sikur fëmijët e tjerë, pozicioni i tij ngritët

Edhe në rast pikëtakimi në mes vete të hyjnore me johyjnoren, sipas pikëpamjes së përgjithshme islame, këto dy entitete në të njëjtën kohë edhe ruajnë lidhjen ndërmjet vete duke mbajtur kontaktin, por edhe ruajnë origjinalitetin përkatës duke mos u përzier.

në nivel hyjnor. Prandaj pozita e Isait –Jezusit a.s., përmban dy karakteristika, në bazë të së cilave cilësohet edhe si Zot edhe si bir Zoti,⁵ që në fakt prodhojnë dy problematika në këtë relacion.

E para është përcaktimi i pozicionit të tij në raport me elementet e tjera të trinitetit, kurse e dyta është përcaktimi i vetë natyrës së tij, shikuar konform relacionit të problematikës së parë. Në kontekst të aspektit të parë, Jezusi merr pozitë të barabartë me elementet Ati dhe Shpirti i Shenjtë, kurse në aspektin e dytë, natyra e tij bartë të dy nivelet, atë hyjnor dhe atë johyjnor (اللاهوت والناسوت). Aspekti hyjnor në vetë Jezusin manifestohet në kompetencat e tij tej njerëzore sipas besimit të krishterë, si: gjykimi i njerëzve në Ditën e Llogarisë, autoriteti i tij për sundimin e Ditës së Ringjalljes, etj., kurse aspekti johyjnor manifestohet me pjesëmarrjen e tij në jetën e njerëzve me një natyrë po aq njerëzore sa edhe të tjerët, mishërimi, pastaj vrasja e tij, kryqëzimi, etj..

Në një shikim të gjithmbarshëm, vërehet se orientimi i krishterë në



definimin e hyjnore nga johyjnoria është goxha i kundërt me shtjellimin hebre të kësaj tematike, madje mund të thuhet se qëndron në ekstremin e kundërt me të parën. Përderisa në hebraizëm vërehet një anim i hapur i gjithë pasqyrimin të hyjnore në parametra antropomorfikë, këtu shohim se kjo doktrinë tërheq nivelin njerëzor në nivel hyjnor, kur ndodh ky pikëtakim në mes dy realiteteve, edhe pse si i tillë, ky shpjegim nuk ofron një qartësi dhe as stabilitet në kuptimin e dimensioneve hyjnore, të cilat i mvishen natyrës njerëzore të Jezusit, kur pasqyrohet për shembull, çështja e flijimit të tij.

Në Islam

Në Islam, identiteti i hyjnore përballë johyjnore është i përcaktuar dhe i qartësuar mirë. Dhe pikëtakimi i këtyre dy aspekteve, jo vetëm që është i mundshëm, por ai ka ndodhur dhe me ndodhjen e tij ne sot dimë për besimin dhe fenë. Mirëpo, kur kontakton hyjnorja me johyjnoren, në asnjë formë nuk cenohen kufijtë konceptual të asnjërës nga dy nocionet. Si rezultat, edhe në rast pikëtakimi në mes vete të hyjnore me johyjnoren, sipas pikëpamjes së përgjithshme islame, këto dy entitete

në të njëjtën kohë edhe ruajnë lidhjen ndërmjet vete duke mbajtur kontaktin, por edhe ruajnë origjinalitetin përkatës duke mos u përzier.

Qasja e përgjithshme gnoseologjike islame ndaj hyjnore, konsiston në vete një lloj dorëzimi para këtij realiteti faktik, duke mos hyrë në përpjekjet për të definuar asgjë më shumë se sa që teksti fetar përmban në vete, duke qenë se imagjinata, përvoja, por edhe kapaciteti racional në përshkrimin, kuptimin si dhe definimin e çështjeve metafizike janë shumë të kufizuara në brendësinë e kufijve lëndor.⁶ Imam Tahaviu konstaton se, Zotin nuk e perceptojnë dot mendjet njerëzore dhe as që ka ndonjë ngjashmëri me krijesat.⁷

Përmes kësaj qasjeje, perceptimi islam e pranon pikëtakimin, por në të njëjtën kohë edhe ruan identitetin e të dy konspekteve të ndryshme në mes vete. Pastaj në bazë të rezultatit të dalë, definojnë mundësitë epistemologjike për përcaktimin e burimeve kompetente të njohjes, që mund të kontribuojnë në definimin e mundshëm të të dy aspekteve. Si rezultat i kësaj, burimet me bazë empirike bien totalisht, duke i lëshuar rrugën vetëm mendjes dhe tekstit fetar. Pejgamberi a.s. shprehet kështu: “Ta dini se askush prej jush, para se të

vdesë, nuk ka mundësi ta shoh Zotin.”⁸

Pra, në Islam haptas pranohet fakti i pamundësisë së definimit, qoftë të identitetit apo i realitetit të hyjnore. Dhe kjo nuk përbën në asnjë formë mangësi në kuptimin e vetë fesë. Përkundrazi, nga kuptimi i mirë i besimit është përcaktimi i drejtë i kufijve deri tek të cilët mund të shtrihet mendja, përballë një kuptimi të detajuar të realitetit hyjnor, sepse kjo konsiston me një njohje të mirëfilltë të vetë kapacitetit të saj. Taberaniu përcjell një porosi profetike që shërben bukur në këtë temë: “Meditoni në shenjat e Allahut e mos meditoni rreth Qenies së Tij”⁹. Kjo, edhe për shkakun se, mendja shtrin imagjinatën e vet deri në kufijtë e fushëveprimit të shqisave. Në këtë lidhje, në mes imagjinatës dhe shqisave, bukur dëshmon hadithi i Muhamedit a.s., lidhur me realitetet e përjetimit të kënaqësive në Ahiret, për gjëra që nuk kanë natyrë hyjnore, por që shqisat ende nuk i njohin: “Në të (Xhenet), ka çfarë syri asnjëherë nuk ka parë, as veshi nuk ka dëgjuar, e as mendja (imagjinata) nuk i ka shkuar njeri”¹⁰. Përderisa kështu qëndron puna, për realitete të gajbit nga mesi i krijesave të Zotit, atëherë, si ka mundësi që të njihet realiteti i Zotit nga mendjet e



kufizuara?! Por, kjo nuk do të thotë se në Islam nuk flitet për hyjnoren në asnjë detaj të saj. Studimet fetare islame janë të shumta në përpjekjen e tyre për të dhënë shpjegimet e duhura rreth efekteve të pikëtakimit të hyjnoses me johyjnoren.

Ka disa detaje që tekstet islame e paraqesin hyjnoren përmes disa parametrave, porse kjo paraqitje jo gjithherë anon nga një afirmim pozitiv i realiteteve. Në fakt, tekstet islame përfshijnë edhe afirmimin pozitiv në përshkrimin e hyjnoses, por edhe një lloj përshkrimi përmes mohimit të një përngjasimi, i cili mund të shpie në përzierjen në mes dy koncepteve. Përmes këtyre dy metodave, hyjnorja paraqitet në ajetet e sures Ihlas: “Thuaj Ai (Allahu) është një (i Vetmi). Allahu është Ai, të Cilit krijesat i drejtohen (mbëshetën) për nevojat e tyre. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të.” (El-Ihlas,1-4).

Konfirmimin e vet, për mos qasjen e racios në perceptimin e realiteteve të hyjnoses, shpjegimi islam e bën edhe përmes një lloj cilësimi pasiv (الصفات السلبية), i cili në fakt paraqet mohim të përngjasimit të Krijuesit me krijesat. Një mori tekstesh fetare që të shumica përfaqësuese e spektrit mysliman, bën pjesë në bazën e librit

(أم الكتاب), të shprehur përmes ajeteve të qarta (المحكم), i përkasin kësaj natyre të mohimit të çfarëdo lloj përngjasimi në mes Krijuesit dhe krijesave. Këtë, përveç që e hasim në suren Ihlas, të përmendur më sipër, po ashtu edhe në ajete të tjera kuranore siç është fjala e Allahut: “Asgjë nuk është si Ai, Ai është Dëgjuesi, Shikuesi” (Esh-Shura, 11)

Prandaj, pasqyrimi i një lloj përshkrimi përmes mohimit të përngjasimit, plotëson qëllimin e kërkuar sheriatikisht në akiden islame, se te hyjnorja është me rëndësi të mos ketë asnjë ngjashmëri me realitetet e krijesave, në përshkrimin ose besimin e saj. Ky parim është i paluhatur në akiden islame dhe quhet te shkencëtarët e fushës parimi i mos ngjasimit (عقيدة التنزيه).

Edhe tekstet fetare, qoftë nga Kurani ose Suneti, që kanë përmendur një lloj figurimi në cilësimin e Zotit, dijetarët e Islamit, kryesisht kanë dy drejtime në shpjegimin e tyre:

Shpjegimi i parë, përqendrohet në një stopim të komentimit të këtyre teksteve, duke i lënë kompetencën dijes së Zotit xh.sh. për qëllimin real të këtyre teksteve, për shkak të faktit se këto tekste nuk përmbajnë në vete ndonjë urdhër mbi të cilin sendërtohet ndonjë veprim praktik. Ky

drejtim ishte i përhapur te gjeneratat e para të Islamit dhe quhet medhhebi i tefvidit.

Kurse forma e dytë e shpjegimit, në një farë forme është vazhdimësi e të parës, duke kontestuar anën literale të tekstit, si diçka që nuk i përket përshkrimit real dhe faktik të Zotit, (pikërisht për shkak të një përzierje të mundshme në mes nocionit të hyjnoses me antropomorfizmin), dhe duke kategorizuar shprehjet e tilla në tekst si pjesë të stilistikës së vet, gjuhës arabe në të cilën ka zbritur Kurani, dhe nga bukuria e të shprehurit stilistik është edhe përdorimi i metaforës, që në fakt jep një kuptim tjetër, i cili kuptim ka bazë në vetë gjuhën arabe dhe i përshtatet mundësisë së atribuimit ndaj madhërisë së Allahut xh. sh.. Ky drejtim quhet tek dijetarët medhhebu t’vil.

Ngjashmëria ndërmjet të dy shkollave islame është në atë se të dyja nuk pranojnë në mënyrë totale anën literale të shprehjeve, të cilat shprehin hyjnoren me parametra antropomorfik. Kurse dallimi është në atë se, e para nuk hyn të sqarojë kuptimin real të saj, kurse shkolla pasuese jep një komentim të teksteve, në bazë të disa parimeve të pajtuar në to shumica islame, duke i futur këto tekste në mesin e teksteve të vlefshme për komentim.

Edhe ata dijetarë islamë që anuan kah shpjegimi literal i këtyre teksteve fetare, nuk pohuan asnjëherë se ekziston ndonjë ngjashmëri në mes të hyjnore në këto tekste dhe johyjnore. Ata, ani pse pranojnë kuptimin parësor të teksteve, dalin nga përngjasimi duke e kufizuar kuptimin përmes fjalës “pa përngjasim”. Ky qëndrim historikisht mori kritika nga shumica përfaqësuese e dijetarëve islamë, pikërisht për shkak të një mos saktësie në definimin e qartë të kufirit në mes hyjnore dhe johyjnore.

Është me rëndësi të dihet se, në të gjitha çështjet, ku hyjnorja ka një lloj pikëtakimi me johyjnore, medoemos duhet të lindin mendime të ndryshme rreth përkufizimit sa më të saktë të natyrës së këtij kontakti në mes të dy nocioneve. Është gati e pamundur që të gresh kontaktin e hyjnore me johyjnore edhe në meselet e akides islame, e mos të ketë komplikim dhe divergjencë, si në qasjen studimore të këtyre çështjeve në mes dijetarëve, po ashtu edhe në rezultatet shkencore të këtyre qasjeve.

Dhe kjo nuk paraqet asnjë problem në vetë çështjet, por tregon për problematikat e qasjeve mendore (shkencore) në fushat e gajbit, për të cilat mendja nuk ka kapacitet që t'i definojë.

Shembuj

Nga shembujt e këtyre, në akiden islame, mund të veçojmë çështjen e Kadasë dhe Kaderit, pikërisht në definimin e saktë, rreth asaj se deri ku është shtrirja e veprimtimit njerëzor, në raport me veprimin hyjnor dhe debatin e gjatë në mes grupimeve të ndryshme të shmangura nga mesatarja islame, siç ishin kaderinjtë¹¹ ose xhebrintjtë¹², rreth pikëpamjeve të tyre në çështjen e autorësisë së veprave të njeriut, nëse janë krijim i vetë njeriut ose jo.

Apo, në çështjen e shtrirjes së lirisë njerëzore në raport me paracaktimin hyjnor, se njeriu ka apo nuk ka fare liri veprimi në jetën e tij, për pasojë

njeriu është ose jo i determinuar në çdo veprim. Shpjegimet që paraqesin doktrinën e këtyre fraksioneve, zakonisht mbajnë ekstreme të kundërta, duke shtyrë disa nga ta në një mohim të rrolit hyjnor në krijim të veprave, përballë një sovraniteti të plotë të njeriut në autorësinë e krijimit të veprave, kurse disa të tjerë duke mohuar lirinë njerëzore në total, për çfarë detyrohen pastaj të mbajnë anën e një determinimi të plotë të çdo angazhimi njerëzor nga hyjnorja.

Kështu, si zakonisht dijetarët e përfaqësimit shumicë të Islamit, të quajtur Ehl-i Suneti dhe Xhemati (pasuesit e sunetit – shumica), refuzojnë të dy qëndrimet, duke bërë përpjekje të bashkojnë në mes kuptimit të teksteve fetare në një shpjegim të kapshëm logjik. Gati të gjitha shpjegimet që u paraqiten nga studiuesit islamë, në këtë temë, nuk kaluan pa ndonjë kritikë, të madhe ose të vogël. Edhe të dy shkollat e shumicës përfaqësuese në këtë pikë, ani pse në detaje sekondare, vërejmë se kanë dallimet e tyre në qasjen shpjeguese të kësaj tematike akaidologjike - kelamiste. Dhe këtë pra, e arsyetojmë për shkak të faktit se, çështje të tilla, ku ndodh kontakti i hyjnore me johyjnore, detyrimisht do të ketë divergjencë në historinë e mendimit islam.

Shembull tjetër në këtë aspekt, është edhe diskutimi i gjerë në mes të Ehl-i Sunetit, mutezilites, e fraksioneve të tjera, rreth Kuranit, nëse është i krijuar ose jo. Duke dal në shesh kështu ekstreme të ndryshme në këtë pikë nga pikëpamjet mutezilite që paraqesin të folurit e Allahut si të krijuar, deri te prononcimet e papjekura hasheвите, të cilat e cilësojnë çdo harf dhe zë që prodhon lexuesi i Kuranit, si diçka eternal (قديم). Kjo po ashtu, për shkak se fjala e Allahut xh.sh., paraqet në një farë forme kontaktin e hyjnore me johyjnore. Gjegjësisht, faktit që, përmes fjalës së Allahut xh.sh., njeriu kontakton me kërkesat hyjnore drejtuar Atij, të cilat kërkesa duhet të aplikohen pastaj në nivel fiziko-praktik. Ose, edhe për

shkak të mos qartësisë së mendjeve në mes të “të folurit” e Allahut (كلام الله), që është atribut eternal i Allahut dhe zërave që prodhon lexuesi. Shumë debat shkencor u zhvillua në literaturën islame, rreth asaj se cili ishte kufiri konceptual në eternalitetin e fjalës së Allahut xh.sh., dhe cilat aspekte përshkruese cenonjë këta kufij.

Shembull i tretë është diskutimi klasik dhe bashkëkohor rreth çështjeve të sifateve haberije, në të cilat vërehet cilësimi i Zotit me attribute që nuk i përkasin hyjnore. Edhe këto diskutime janë bukur të gjata dhe dallojnë qasjet e dijetarëve myslimanë sa i përket saktësisë së tyre pas tenzihut që i bëjnë Allahut nga çdo mangësi. Për secilin nga shembujt nuk mjafton një studim i shkurtër si ky për të sqaruar qasjet e dijetarëve dhe argumentet e tyre, porse dëshirojmë të vëmë në spikamë se në meselet ku hyjnorja është në një pikëtakim me johyjnore domosdo do ketë divergjencë në mes mendjesh në ixhtihadet e tyre shkencore rreth një definimi të saktë dhe të pranuar që nuk e kundërshton tekstin fetar dhe përkon edhe me një pëlqim të shëndoshë logjik të shpjegimit të tekstit islam. Lexuesi i bagazhit studimor të këtyre kolosëve islamë që u morën me shpjegimin e temave bukur të komplikuar, mbetet i fascinuar, si për nivelin interesant të shpjegimeve, po ashtu edhe për arritshmërinë e tyre në definimin e akides së pastër islame dhe demantimin e devijimeve eventuale.

1. Zanafilla, 18:1-9. 2. Ekozodi, 33:23. 3. Zanafilla, 18:21. 4. Dedë Abazi, Si na është zbuluar Zoti, Prishtinë 2008, f. 163. 5. Zija Abdullahu, Studim letrësor i feve, Prishtinë 2010, f.418. 6. Fabrud din Rrazi, Esasu takdis, el kulijati el Ez-herije, 2001, f.79-80. Alij Tantauvi, Prezantim i përgjithshëm i Fesë Islame, f.25-26. 7. Vehbi S. Gavoçi, Njja e besimit sipas Imam Tahaviut, 2015, f.29. 8. Transmeton dhe thotë se është hadithi hasen sabih. 9. Taberani, El Mu'xhemul Evsat (6501). Edhe pse në disa metra të këtij hadithi ka dobësi, dijetarët thonë se ky hadith ka bazë. Transmetohet edhe mekufen nga Ibni Abbasi me sened të mirë. 10. Buhariu (4779) dhe Muslimi (2824). 11. Fraksion që mohoi Kaderin në tërësi. 12. Fraksion që konsideron se e tërë veprimtaria njerëzore është e determinuar nga Zoti.

Eduart Thartori

Bujaria e Allahut xh.sh.

Allahu nuk e përzuri Ademin nga Xheneti. Përkundrazi, Ai e mësoi atë në Xhenet. Ia mësoi si të kërkojë falje, dhe e fali.

Si mendoni, nëse një mik do t' u vinte në shtëpi. Do ta respektonit, do t' i dhuronit atij gjithë të mirat tua?! Do t' i lejonit të rrinte si në shtëpinë e tij?! Oborri i shtëpisë të ishte krejt i hapur për të! Brendia e shtëpisë të ishte krejt e hapur për të! Të rrijë aty sa të dojë, të ushqehet si të dojë! Të hapë frigoriferin vetë, e të marrë çfarë të dojë! Nëse do para, ti i jep sa të dojë!

Mirëpo, pas gjithë këtyre të mirave, i thua atij: “Të gjitha janë tuat, ha, jeto sa të duash, kënaqu, por vetëm një amanet e kam: “Mos e hap atë kutinë e bizhuterive aty”, sepse është çështje personale imja.”

Miku yt, ngacmohet. Diçka e gërry-en përbrenda. Pse jo atë kuti? Ai mi ka lënë të gjitha, por atë kuti, jo. Çfarë ka aty? Pse mos ta hapë e ta shoh?

E në fakt, shejtani e nxit nga ana e tij dhe ai shkon e hap dhe merr bizhuteritë e saj.

Ademi shijoi shumë emocione, por nuk kishte shijuar akoma emocionin e lakmisë, kuriozitetit, kundërshtimit, emocionin e thyerjes së zemrës, pendimin dhe turpin. Për të gjitha këto ai kishte nevojë të trajnohej. Dhe vendi i duhur për trajnim ishte Xheneti

Kur vini në shtëpi, çfarë do të bënit me këtë njeri?

Nuk ka askund në këtë dynja që nuk do të më thotë se do ta kapja për fyti dhe do ta përzija me shkelma nga shtëpia. E di se çdokush do ta bënte këtë.

Por, tek Allahu nuk funksionon kështu. Ademi a.s. u krijua nga Allahut xh.sh. dhe u perfeksionua në formën më të bukur. Allahu i tha atij, se Xheneti është krejt në dispozicionin e tij, ama mes gjithë të mirave të Xhenetit është një pemë që nuk duhet të hajë prej frutave të saj. Ndërsa Ademi bëri pikërisht këtë. Shkoi dhe hëngri prej frutave të asaj peme.

Por Allahu nuk reagoi si njeriu, në lidhje me shpagimin ndaj Ademit.

Ai e dinte në fakt se Ademi do ta bëjë këtë kundërshtim të ndalesës së Tij, sepse Allahut xh.sh. nuk i fshihet asgjë.



Dikush do të më thotë: “Dakord edhe Allahu e përzuri Ademin nga Xheneti, sepse hëngri nga kjo pemë e ndaluar.” Por nuk është fiks kështu.

Në asnjë vend në Kuran nuk thuhet se Ademi u përzua nga Xheneti dhe as se arsyeja ishte ngrënia e pemës së ndaluar.

Ajo që ndodhi ishte, se menjëherë pas kundërshtimit të urdhrit, Ademit dhe gruas së tij Havasë, iu zhduk drita e shenjtërisë që i mbulonte trupat e tyre. Nga humbja e saj, atyre iu dukën pjesët e turpshme. Kjo bëri që ata të mbledhin gjethë nga Xheneti që të mbulohen me to.

Mirëpo Allahu nuk e përjashtoi Ademin nga Xheneti. Përkundrazi.

Allahu e dinte edhe zemrën e Ademit, tashmë të penduar nga kundërshtimi që kishte bërë. E dinte se ajo ishte e penduar. Por nuk dinte si të shprehej. Andaj Allahu i mësoi Ademit se si të kërkonte falje për këtë vepër. E sapo Ademi kërkoi falje, Allahu menjëherë ia fali.

Po pse atëherë Allahu e përzuri Ademin nga Xheneti?

Allahu nuk e përzuri Ademin nga Xheneti. Në asnjë vend në Kuran, as në hadith nuk thuhet kjo. Pasi në fakt atë (Xhenetin) ia ka caktuar shtëpi për Ademin dhe krejt pasardhësit e tij besimtarë, që në fillim të herës.

Atëherë kur do të krijohej Ademi, Allahu tha se do të krijojë një kujdestar për Tokën. Pra me këtë kuptojmë se Ademi ishte krijuar për një mision. Dhe ai mision nuk ishte në Xhenet, por në planetin Tokë. Qëndrimi i Ademit në Xhenet, dhe vetë sprovimi i tij me pemën e ndaluar, ka të bëjë me një tjetër arsye.

Si kujdestar i tokës, Ademit i duhej të kishte liri të plotë zgjedhje. Ai duhej të merrte vendimet e tij vetë. Të mira ose të këqija, por ato duhej të ishin vendime personale, të pa imponuara nga dikush. Madje as nga Allahu xh.sh..

Për këtë, ai kishte nevojë për një trajnim konkret. Kishte nevojë të vinte në punë emocionet e tij më të mira dhe më të këqija. Në Xhenet,

Allahu nuk e përzuri Ademin nga Xheneti. Përkundrazi, Ai e mësoi atë në Xhenet. Ia mësoi si të kërkojë falje, dhe e fali.

Ademi shijoi shumë emocione, por nuk kishte shijuar akoma emocionin e lakmisë, kuriozitetit, kundërshtimit, emocionin e thyerjes së zemrës, pendimin dhe turpin. Për të gjitha këto ai kishte nevojë të trajnohej. Dhe vendi i duhur për trajnim ishte Xheneti, para se të vinte në një botë me ligje të tjera, ku nuk ofrohen shumë mundësi përmirësimi.

Pasi edhe këtë trajnim të veçantë e mori Ademi a.s., tashmë ishte gati

për të shkuar në misionin e tij për të cilin u krijuar. Ishte gati për të zbritur në dynja.

Në fillim të këtij shkrimi, folëm për bujarinë e Allahut. Por si ndodhi kjo me këtë zbritje të Ademit në tokë?

Allahu nuk e përzuri Ademin nga Xheneti. Përkundrazi, Ai e mësoi atë në Xhenet. Ia mësoi si të kërkojë falje, dhe e fali. Pastaj i premtoi se do të ketë vazhdimisht kujdesin dhe udhëzimin e Tij gjatë kohës që do të jetë në dynja. E në fund fare, kur të mbarojë me sukses misionin e tij në Tokë, do ta kthejë përsëri në Xhenetin që ia kish caktuar si banesë të tij të përherëshme.

Kjo është bujaria e vërtetë, ky është kulmi i mëshirës, i dashurisë dhe i përkujdesjes që Allahu ka për krijesat e Tij.

Më tregoni pra kush tjetër veç Allahut e bën këtë?



Argjent Xheladini

E drejta e gruas për trashëgimi sipas sheriatit islam

Sistemi islam i trashëgimisë para së gjithash është sistem i matur dhe shumë i drejtë. Ka sqaruar kush janë trashëgimtarët e ligjshëm, dhe u ka dhënë pozitën që u takon.

Prej mirësive të së drejtës së sheriatit është edhe fakti se e ka caktuar femrën si pjesëmarrëse në trashëgimi, pasi që ajo ishte e privuar nga trashëgimia. Përkundër kësaj edhe në ditët e sotme në disa shtete islame privohet nga trashëgimia, duke i ndjekur zakonet e periudhës së injorancës para-islamike. Islami erdhi me drejtësinë absolute, ku edhe femrës i dha të drejtat në pasuri.¹ Femra është e denjë të ketë pasuri dhe të veprojë me të tamam si mashkulli. Këtu shihet edhe nderimi për femrën. Pronësimi i pasurisë është ndihmesë për femrën dhe për plotësimin e nevojave të saj.²

E drejta e sheriatit e gradoi femrën në pozitë shumë të lartë, pozitë që më herët kurrë nuk e kishte pasur dhe as që do ta arrinte pos Islamit. Zoti i Madhëruar në Kuran thotë: “Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit

Islami barazon ndërmjet mashkullit dhe femrës aty ku barazia është e logjikshme dhe e natyrshme dhe bën dallimin mes tyre aty ku dallimi është i natyrshëm dhe i arsyeshëm. Prej sferave më të rëndësishme ku bëhet dallim ndërmjet tyre është në ndarjen e trashëgimisë.

(pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).”³

Sistemi islam i trashëgimisë para së gjithash është sistem i matur dhe shumë i drejtë. Ka sqaruar kush janë trashëgimtarët e ligjshëm, dhe u ka dhënë pozitën që u takon, varësisht afërsisë së pasardhësve dhe pozitës së tyre shoqërore në jetë. Islami barazon ndërmjet mashkullit dhe femrës aty ku barazia është e logjikshme dhe e natyrshme dhe bën dallimin mes tyre aty ku dallimi është i natyrshëm dhe i arsyeshëm. Prej sferave më të rëndësishme ku bëhet dallim ndërmjet tyre është në ndarjen e trashëgimisë. Allahu i Lartësuar, në këtë kontekst thotë: “Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë për) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra.”⁴



Nëse thellohemi në ajetin fisnik vërejmë se Allahu ka urdhëruar për çështjen e trashëgimisë për fëmijët, pastaj ka sqaruar se mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave. “Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë për) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra”. Në origjinë, urdhri është për fëmijët, ndërsa për mashkullin hise sa për dy femra është një rast prej njëzet e katër rasteve të trashëgimisë dhe se kjo ndarje nuk zbatohet në të gjitha rasteve të trashëgimisë. Le të sjellim vetëm tre shembuj prej shembujve ku femra është e barabartë me mashkullin, ndërsa shembuj ka edhe më shumë se këto që do t’i përmendim:

- Nëse i vdekuri ka lënë fëmijët, babanë dhe nënën. Prindërit, respektivisht babai dhe nëna, marrin $1/6$ e pasurisë pa dallim ndërmjet burrërisë së babait dhe feminitetit të nënës, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: “...për prindërit, për secilin nga ata, ju takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri), nëse ka fëmijë.”⁵

- Nëse i vdekuri ka lënë vëllanë dhe motrën nga nëna dhe këta të dy nuk ka kush i pengon nga trashëgimia, atëherë secili prej tyre merr $1/6$, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: “...po ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta.”⁶

- Nëse i vdekuri ka lënë dy e më tepër vëllezër nga nëna dhe dy e më tepër motra nga nëna, atëherë vëllezërit bashkërisht trashëgojnë $1/3$, ndërsa motrat trashëgojnë $1/3$. Pra, pa dallim mashkull ose femër duke u mbështetur në fjalën e Allahut të Lartësuar: “e në qoftë se janë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë).”⁷

Le të sjellim dy shembuj kur femra merr shumëfish më tepër se mashkulli, kurse shembuj të tillë kemi edhe më shumë se këto:

- Nëse gruaja e vdekur ka lënë bashkëshortin dhe një vajzë. Në këtë rast, vajza e së vdekurës trashëgon gjysmën e pasurisë, kurse babai i saj,

Ndarja e trashëgimisë në ligjin islam nuk bëhet për shkak të burrërisë apo feminitetit, por për shkak të detyrave që bën secili.

respektivisht bashkëshorti i së vdekurës, trashëgon një të katërtën. Prandaj, në këtë rast femra trashëgon dyfishin e asaj që trashëgon mashkulli.

- Nëse i vdekuri ka lënë bashkëshorten, dy vajza dhe një vëlla të tij. Në këtë rast bashkëshortja merr të tetën e pasurisë, vajzat dy të tretat, ndërsa ajo që mbetet i takon xhaxhait të vajzave, respektivisht vëllait të të vdekurit. Kësisoj, secilës prej tyre u takon më shumë sesa i takon xhaxhait, d.m.th. secilës i takon kuota $8/24$, ndërsa xhaxhait $5/24$.⁸

Ndarja e trashëgimisë në ligjin islam nuk bëhet për shkak të burrërisë apo feminitetit, por për shkak të detyrave që bën secili. Gjithashtu, merret në konsideratë edhe nevoja e

trashëgimtarit, lloji i lidhjes ndërmjet tij dhe pasardhësve. Pra, çështja është absolutisht ekonomike. Kemi vërejtur se ka raste kur femra trashëgon njëjtë si mashkulli, ndërsa ekzistojnë raste të tjera kur ajo trashëgon më tepër se mashkulli.⁹

Situatat në të cilat ligji islam i ka dhënë më tepër mashkullit se sa femrës nuk janë është thjesht pa dobi, por për shkak të pozitës së tij për sa i përket shpenzimit familjar. I zoti i shtëpisë merr përsipër mbikëqyrjen dhe shpenzimin për familjen e tij.¹⁰ Nëse është i pamartuar, me rastin e martesës jep mehrin (paja e nusërisë), siguron vendbanimin, orenditë etj.. Atij i obligohet mbikëqyrja materiale ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve. Për të gjitha këto, gjykata e obligon burrin dhe jo femrën. Nëse llogarisim atë që merr burri me sistemin llogaritës pas shpenzimeve, do të na bëhet e qartë se ai është i barabartë me atë që merr gruaja apo ndoshta edhe më pak.¹¹

Sistemi bashkëkohor, më saktësisht ai amerikan, bën ndarjen e trashëgimisë sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet bashkëshortëve para vdekjes. S’ka dyshim se në këtë sistem ka padrejtësi, ngase ai nuk i merr parasysh detyrat individuale për të dy gjinitë.¹² Mund të privohet dikush që



është më parësor në trashëgimi ose nuk mund të ketë fare marrëveshje ndërmjet dy partnerëve. Ndërsa kush thotë se pozita e femrës ka ndryshuar pasi ajo në të kaluarën ka qenë amvise e sot është nëpunëse, themi se çfarëdo të jetë pozita e saj, ajo nuk obligohet për mbikëqyrjen materiale ndaj fëmijëve e as ndaj bashkëshortit.¹³ Sipas ligjit islam:

- Për një femër të pamartuar, sigurimi i jetesës duhet të sigurohet nga babai i saj. Në mungesë të babait, meshkujt e afërm, duke përfshirë vëllezërit, gjyshin dhe xhaxhallarët, janë përgjegjës për furnizimin e mbajtjes së saj.

- Furnizimi për mbajtjen e një gruaje të martuar është përgjegjësi e plotë vetëm e burrit të saj; burrit i kërkohet të paguajë mehrin për gruan e tij sipas martesës: “Dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit.”¹⁴

Ky mëhër zotërohet i gjithi nga vetë gruaja dhe burri nuk ka asnjë të drejtë t’ia marrë atë, edhe nëse divorcohen: “Në qoftë se dëshironi të ndërtoni grua, duke e lëshuar njërin për të marrë një tjetër, asaj që i keni dhënë pasuri, mos i merrni nga ajo (pasuri) asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?! Si do t’ia merrnit atë dhuratë, kur ju i keni dhënë njëri-tjetrit dhe kur ato kanë marrë nga ju besë të fortë?”¹⁵

- Gruaja nuk ka asnjë obligim financiar, çfarëdo që ajo fiton apo trashëgon është vetëm pasuri e saj personale. Ajo është e lirë ta shpenzojë pasurinë e saj në mënyrën që ajo dëshiron dhe burri nuk ka të drejtë t’ia marrë, vetëm nëse ajo e dëshiron këtë. S’ka dyshim se kësajsoj ruhet nderi dhe respektohet liria e saj. Islami e ka caktuar përgjegjësinë e saj për shpenzim prej lindjes e deri në vdekjen e saj.¹⁶

Sikur të imagjinonim se Islami e ka obliguar femrën me shpenzim ndaj shtëpisë, me këtë rezulton se e obligon të dalë dhe të fitojë, gjë e cila e fut familjen në konfliktet në të cilat ka rënë shoqëria perëndimore, mirë-

po Islami deshi ta respektojë femrën duke ia siguruar furnizimin në mënyrë që të jetë e qetë, si dhe të jetë e përsosur në edukimin e brezave dhe kujdesin ndaj shtëpisë. Në të njëjtën kohë i ka siguruar lirinë ekonomike kur i hapi asaj mundësinë e punës dhe kjo vullnetarisht për të, ndërsa burrin e detyroi. Nëse femra fiton pasuri, ajo është ekskluzivisht e saj dhe nuk i takon askujt t’ia marrë përveçse me dëshirën e saj.¹⁷

Trashëgimia është çështje e llogarisë e jo çështje ndjenjash e pretendimesh. Femra merr një të tretën që të shpenzojë vetëm për veten e saj, kurse meshkulli dy të tretat që të shpenzojë fillimisht për bashkëshorten (grua), pastaj për familjen dhe fëmijët e tij. Pra, kush merr më tepër me logjikën e llogaritjes dhe logjikën e numrave? Ekzistojnë edhe raste të pazakonshme për meshkullin, i cili tërë pasurinë e shpenzon për veten, nëse nuk martohet dhe nuk krijon familje, mirëpo ato janë raste të rralla.¹⁸ Kjo sa i përket çështjes së pasurisë së trashëguar pa u lodhur. Ndarje e drejtë nga ana e Allahut të Lartësuar i Cili u jep “secilit sipas nevojës”, kurse peshorja e nevojës këtu nënkupton detyrimet e obliguara të secilit prej tyre. Ndërsa sa i përket pasurisë së fituar me të gjitha format e saj si shpërblimi për punën, fitimin në tregti, nuk ka dallim ndërmjet meshkullit dhe femrës, ngase këtu peshohet me peshore tjetër e ajo është barazia ndërmjet angazhimit dhe shpërblimit.¹⁹ Gjysma e asaj që merr meshkulli më tepër se femra në disa raste është thelbi i drejtësisë, ngase pasuria e meshkullit do të pakësohet përmes mehrit dhe shpenzimeve familjare, ndërsa pasuria e saj do të rritet me mehr dhe investim nëse ajo investon. Shumica e vendeve skandinave akoma vazhdojnë të bëjnë dallim në trashëgimi ndërmjet meshkullit dhe femrës. Meshkullit i japin më tepër se sa femrës, përkundër barazisë së tyre në obligime dhe përgjegjësi materiale.²⁰

Barazia në trashëgimi është parim themelor i Ligjit për Trashëgiminë i

Kosovës, i cili në mënyrë shprehimore ka papaparë se të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi.²¹ Po ashtu, LTK ka përcaktuar se trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre. Me ligj, trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti i tij jashtëmartesor, i cili barazohet me bashkëshortin martesor. Bashkësi jashtëmartesore në kuptim të këtij Ligji konsiderohet bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgatur një kohë të gjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, me kusht të kenë qenë plotësuar prezumimet për vlefshmërinë e martesës.²² Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Personat nga paragrafi (1) i këtij Neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.²³

Literatura:

1. Almedin Ejupi, “E drejta trashëgimore islame”, Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, Prishtinë, 2011.
2. Hamude Abdulati, “Islami në Fokus”, Shkup 2000.
3. Hamude Abdulati, “Struktura familjare në Islam”.
4. Ilmije Kuqi, “Trashëgimia e femrës në Islam”, Prishtinë, 2019.
5. Kurani. Të gjitha ajetet kuranore janë marrë nga Kurani (Përkthim me komentim), të përkthyer dhe të komentuar nga H. Sherif Ahmeti, botuar në Prishtinë, më 1988.
6. “Dituria Islame”, nr. 280, Prishtinë, 2013.
7. Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë i Kosovës.
8. <https://kohaislame.com/trashgegimia-e-femres-ne-islam/>

1. Almedin Ejupi, “E drejta trashëgimore islame”, Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, Prishtinë, 2011, fq. 8. 2. Më gjerësisht lidhur me trashëgiminë e femrës në të drejtën e shariatit, shih Ilmije Kuqi, “Trashëgimia e femrës në Islam”, Prishtinë, 2019. 3. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 7. 4. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 11. 5. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 11. 6. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 12. 7. Po aty. 8. <https://kohaislame.com/trashgegimia-e-femres-ne-islam/> 9. Hamude Abdulati “Islami në Fokus”, Shkup 2000, fq. 233. 10. Dituria Islame”, nr. 280, Prishtinë, 2013, fq. 25. 11. Po aty. 12. Hamude Abdulati “Struktura Familjare në Islam”, fq. 157. 13. Hamude Abdulati “Struktura Familjare në Islam”, fq. 157. 14. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 4. 15. Kuran, Kaptina Nisa, verseti 21-22. 16. <https://kohaislame.com/trashgegimia-e-femres-ne-islam/> 17. Po aty. 18. Po aty. 19. Po aty. 20. Po aty. 21. Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë i Kosovës, neni 3 parag. 1. 22. Po aty, neni 11. 23. Po aty, neni 12.

Mr. Driton Arifi

Multikulturalizmi dhe të drejtat e grupeve minoritare në konceptin islam

Multikulturalizmi është koncepti që kërkon përfshirjen e pikëpamjeve dhe kontributeve të anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë, duke ruajtur respektin për dallimet e tyre dhe duke mënjanuar kërkesën për asimilimin e tyre në kulturën dominuese.¹

Brenda diskursit filozofik e juridiko-politik, multikulturalizmi, pra i referohet njohjes, pranimit dhe respektimit të “dallimeve të ngulitura kulturalisht” në një shoqëri të caktuar njerëzore.

Si nocion, për herë të parë u përdor në 1957, në Kanada, për të marrë hov më pastaj diku kah fundi i vitit 1960. Ai u përhap shpejt në vende të tjera anglisht folëse.

Edhe Komisioni Evropian për Emigrim dhe Punë të Jashtme, kur e definoi atë në glosarin e vet, saktësoi se multikulturalizmi është një politikë që miraton parimin e diversitetit kulturor dhe mbështet të drejtën e grupeve të ndryshme kulturore dhe etnike për të ruajtur identitete të veçanta kulturore, duke siguruar qasjen e tyre të barabartë në shoqëri, duke përfshirë parimet kushtetuese dhe vlerat e përbashkëta që mbizotërojnë në shoqëri.²

Në realitet, nëse e shohim dhe analizojmë, sa herë që në një shoqëri njerëzore, apo te një komunitet i ngushtë hasim në përputhshmëri të plotë të mendimeve, qëndrimeve e ideve, duhet të kemi të qartë se një gjë e tillë është në kundërshtim me ligjin hyjnor. Një gjë e tillë në

shumicën e rasteve është tregues për dy gjëra:

E para: shtypje e dominim të një grupi të shoqërisë ndaj një grupi tjetër, gjë që e ka bërë të heshtin të tjerët, ose i ka bërë ata që të ndjekin hap pas hapi përmes shfaqjes (falco) së mbështetjes ndaj tyre.

E dyta: pasimi i verbër i në grupi ndaj një grupi tjetër, pavarësisht saktësinë e ideve të grupit të pasuar. Të dy gjendjet janë tregues të këqij dhe sinjalizojnë për sëmundje të shoqërisë e jo shëndet të saj.

E konformiteti, përputhshmëria e tërësishme ashtu siç është shterpë e pavlerë në anatominë e njeriut, po ashtu është shterpë edhe në nivel

idesh e pikëpamjesh. Ajo në fakt e eliminon në intelektin tonë atë nxitësin ose shtytësin intelektual për të prodhuar më shumë ide dhe më tepër mendime. Është kështu sepse shumë prej ideve të reja lindin si rezultat i konfrontimit, përballjes e ballafaqimit të mendimeve të ndryshme rreth të njëjtës çështje.³

Po të bëhen studime pak më të thella në burimet juridike islame, do të vërejmë se shumësia e feve dhe dallimet ndërmjet njerëzve, në burimet islame njihen si fenomene krejt normale, që ndodhin brenda vullnetit e dijes së Zotit të Madhërishëm. Ai në njërin prej citateve kuranore, tha: “Sikur të kishte dashur Zoti yt,



Koncepti i “umma-së” të cilin e lansoi i Dërguari i Zotit a.s., ishte një koncept që njihnte specifikat e dallimet e komuniteteve që jetonin asokohe në Medinë, dhe njëkohësisht i tilli rrëfen zemërgjerësinë islame e gatishmërinë për të pranuar tjetrin ashtu siç është pa presion që ai të bëhet ndryshe ose që të konvertohet në Islam.

do t'i bënte njerëzit të një komuniteti-feje, por ata nuk kanë pushuar kurrë së qeni të ndryshëm, përveç atyre që Zoti yt i ka përfshirë me mëshirën e Tij; dhe për këtë Ai i krijoi ata.” (Hud, 118-119).

Diversiteti i njerëzve, multikulturalizmi e multireligjioziteti i tyre është edhe vullnet hyjnor, andaj duhet garantuar mbrojtje për të.

Perspektiva islame është ajo që “njëshmërinë” si tipar ia atribuon vetëm Krijuesit, i Cili nuk ka shok, e askënd të ngjashëm me Të. Ai është i Vetëm. Ndërsa të gjitha krijesat në të gjitha aspektet janë të larmishme e të ndryshme, si në aspektin e krijimtarisë së tyre, atë ideologjik, emocional e mendor. I tërë sistemi i krijimtarisë pra është ngritur mbi konceptin e “larmisë” diversitetit. Ky është ligj universal i Zotit, i pandryshueshëm e i përhershëm në të gjitha

fushat e jetës, qofshin ato fusha materiale, shoqërore e të tjera.⁴

Edhe i Dërguari ynë - Muhamedi, a.s. me të emigruar në Medinë, dekretoi një traktat juridik – Kartën e Medinës, menjëherë pas shpërnguljes së tij atje, në të cilin dokument gjeti hapësirë për të ligjësuar diversitetin e multikulturalitetin e këtij qytet-shteti të parë islam. Ai në paragrafin-nenin 25 theksoi:

“Hebrenjtë e klanit ‘Auf janë një komunitet i përbashkët (umma) me besimtarët. Por ata (hebrenjtë) kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre. Këtë të drejtë do ta kenë edhe aleatët-bashkëpunëtorët e tyre sikur vetë ata (hebrenjtë nënshkruer të traktatit), përveç atyre që bëjnë padrejtësi ose e shkelin këtë traktat. Ata do t'i sjellin keq-shkatërrim vetvetes dhe familjes së tyre.”⁵

Atyre iu tha: ju keni fenë tuaj, ne kemi fenë tonë. Ju praktikoni tuajën, e ne do të praktikojmë tonën.

Siç edhe deklaruan një numër studiuesish të huaj, Muhamedi a.s. nuk krijoi një ymet-komunitet duke denoncuar të gjitha mënyrat e jetës përveç Islamit, ose duke njohur Islamin si fe e vetme që duhet t'i sigurohet mbrojtja. Në vend të kësaj, ai bashkoi të gjithë banorët e qytetit nën një flamur të jetesës etike dhe parimeve morale të përbashkëta ndërmjet të gjithë njerëzve dhe të gjitha feve. Profeti u bazua në thelbin e unitetit, respektit, tolerancës dhe dashurisë për të kombinuar dhe krijuar një komunitet pluralist.⁶

Koncepti i “umma-së” të cilin e lansoi i Dërguari i Zotit a.s., ishte një koncept që njihnte specifikat e dallimet e komuniteteve që jetonin asokohe në Medinë, dhe njëkohësisht i tilli rrëfen zemërgjerësinë islame e gatishmërinë për të pranuar tjetrin ashtu siç është pa presion që ai të bëhet ndryshe ose që të konvertohet në Islam.

Mirëpo, është e mahnitshme të shohësh se si interpretimi i Muhamedit –Profetit të Zotit që i bënte Kuranit ose intencave të shariatit ishte kaq tolerant dhe i mbushur me

dhembshuri, ndërsa interpretimi bashkëkohor i disa myslimanëve i të njëjtave tekste është kaq i ashpër, aq autoritar dhe kaq jo tolerant. Ne duhet të mësojmë prej tij jo vetëm parimet e besimit, por edhe virtytet njerëzore të mëshirës, dhembshurisë, barazisë, drejtësisë dhe tolerancës.⁷

Të drejtat e grupeve religjioze minoritare në botën islame

Shoqëria medinase në të cilën u “dekretua” traktati i parë i të drejtave të njeriut - Karta e Medinës, ishte një shoqëri ku jetonin një komunitet multikulturor e multireligjioz. Aty kishte një shumicë fetare myslimane që përfaqësoj nga vetë Muhamedi a.s., dhe të tjerët që ishin minoritarë. Për të ruajtur e siguruar të drejtën e minoriteteve për ekzistencë, dhe për t'iu garantuar atyre të drejta dhe liri të barabarta, profeti i përvijoi vetë ato të drejta në këtë Kartë, duke përcaktuar se të gjithë ata gëzojnë të drejtat humane të barabarta të një shoqërie multireligjioze në Medinë. Paragrafi i 16 theksoi se “Hebrenjtë që na bashkëngjiten neve, u takon ndihma (jonë) dhe janë të barabartë me ne. Atyre nuk do t'i bëhet as e padrejtë dhe kundër tyre nuk do të ndihmohen armiqet e tyre.”⁸

Askush nuk u detyrua të konvertohej në Islam, dhe myslimanët, paganët dhe çifutët i përkisnin një komuniteti unik-umma. Ata nuk mund të atakonin njëri-tjetrin dhe u zotuan se do t'i ofronin mbrojtje njëri-tjetrit. Ky konceptualizim i ri i shtetit të porsaformuar, nënkuptonte se aty është strukturuar një bashkësi gjithëpërfshirëse, duke e vendosur në qendër fenë e Zotit, dhe kjo për atë kohë ishte jo konvencionale, andaj edhe mbetet tejet domethënëse.

Nëse shohim në periudhat pak më të vonshme të historisë islame, madje edhe në sytë e vrojtuesve të huaj e jomyslimanë, gjejmë deklarata e vlerësime objektive që vlerësojnë me paanshmëri raportin dhe tretmanin që shteti islam u ofronte minoriteteve jomyslimane.

Njëri prej këtyre analistëve është edhe Peter Demant,⁹ i cili bëri një



analizë rreth trajtimit të pakicave në shtetin islam dhe tha: “Ne vërejmë se një trajtim i arsyeshëm mbizotëronte gjatë shumicës së kohës në vendet islame, edhe pse do të ishte anakronike t’i referoheshim kësaj si tolerancë moderne. Në këmbim të çaromatimit, e pagesës së xhizjes,¹⁰ dhimmitë (komunitetit jo islam që jetonte nën juridiksionin e shtetit islam) gëzonin autonomi të gjerë dhe mund të hynin në pothuajse të gjitha profesionet. Toleranca ishte më e mira në periudhat kur myslimanët kishin fuqinë më të madhe, por prirej të zvogëlohej me kalimin e kohës. Ndërsa, osmanët shkuan edhe më tej në formalizimin e statusit të pakicave. Deri në shekullin XIX, disa pakica kontrollonin një pjesë të konsiderueshme të segmenteve të ekonomisë osmane. Pas dekretëve të vitit 1854 dhe 1869, që praktikisht shfuqizuan diskriminimin, u vendos barazia civile.”¹¹

Mund të duket paradoksale, veçse pas cilësdo analizë objektive do të konstatojmë se përqendrimi i gjendjes së minoriteteve në shtetet islame, pastaj nëpërkëmbja e të drejtave të njeriut atje, është përshkallëzuar ndoshta proporcionalisht me distancimin e myslimanëve nga mësimet hyjnore islame.

E nëse bëjmë një analizë të panoramës së minoriteteve në botën islame, mund të vërejmë se ekziston një tipologji e trefishtë e “minoriteteve” atje. Kjo tipologji mund të kategorizohet si në vijim:

(1) Arabë, por jomyslimanë: e që janë ato grupe fetare që janë etnikisht/gjuhësisht myslimanë, por jo sunitë, ku bëjnë pjesë disa komunitete të krishtera arabe, ortodoksë (koptë), katolikë, maronitë, latinë dhe protestantë – si dhe sekte të ndryshme myslimane, ‘alevitë, druzët, dhe ismailitët, e të tjerë;

(2) Myslimanë, por jo arabë: grupe etnike/kombëtare që janë myslimanë sunitë por jo arabë, si kurdët, amazigët/berberët, turkmanët, çerkezët etj.;

(3) Grupet që nuk janë as arabë e as myslimanë: çifutët, armenët, asirianët dhe fiset sudaneze jugore.

E nëse shohim numrin e atyre azilkërkuesve nga Lindja e Mesme që kërkuar strehim në botën perëndimore, gjatë dekadave të fundit, nuk mund të mos e pranojmë se disa prej grupeve minoritare atje përjash-tohen simbolikisht nga sfera publike dhe jeta politike, por edhe iu nënshtrihen shtypjeve e represionit nga qeverisja në vendet e tyre. Veçse ato shtypje e diskriminime mund të kenë për referencë, fanatizmin ideologjik, apo arsytet e tjera politike e sociale, por jo burimet kredibile islame e as interpretimet e denja të shkollarëve të Islamit. E themi këtë sepse një numër i madh i atyre që kërkojnë strehim e azil politik nga vendet arabe-islame, janë edhe nga komunitet shumicë, të cilët ikin nga atje për shkak të politikave arbitrare, qeverisjeve autoritare e despotike, si dhe për shkak të shkeljeve të të

drejtave të tyre në formën më flagrante në vendet e tyre.

Por, duhet ditur edhe një gjë që gjatë periudhave të ndryshme historike, sunduesit myslimanë ishin të ndryshëm dhe dallonin trajtimet që i bënin ata gjatë sundimit të tyre për minoritetet jo islame. Historianët modernë përgjithësisht pajtohen se jomyslimanët nën sundimin mesjetar mysliman ishin më mirë se sa jo të krishterët ose të krishterët heretikë nën të ashtuquajturin krishterim mesjetar. Historiani i shquar Bernard Lewis vërejtë me vend se “nuk ka asgjë në historinë islame që mund të krahasohet me masakrat dhe dëbimet, inkuizicionet dhe persekutimet që të krishterët i bënin zakonisht jo të krishterëve, dhe akoma më shumë që ata bënin kundër njëri-tjetrit. Në vendet e Islamit, persekutimi ishte përjashtim; në të ashtuquajturat vende krishtere, persekutimi mjehrisht, ishte normë.”¹²

1. Shih: <https://www.britannica.com/topic/multiculturalism> 2. https://ec.europa.eu/home-affairs/pages/glossary/multiculturalism_en 3. Bekkar, A. (2021). *Menaxhimi i diversitetit*. Bot. Fakulteti i Studimeve Islame-Prishtinë, fq.8. 4. Imareh, M. (2008). *El Islam Ve Et tteaddudijje. Mektebetu Esh Shuruk ed Devlije*, fq. 8 5. *Karta e Medinës*. 6. WHITE, S.William. (July - August 2010). *Medina Charter and Pluralism*. Rev. Fountain Magazine. Shih linkun: http://www.metpdx.org/images/MEPdf/Medina_Charter_Pluralism.pdf (P.s. Sean William White është titullar i fushës “Histori Islame” në Monash University, Melbourne). 7. Khan, M (Published in the *Mirror International* May 30, 2001). *The Compact Of Medina: A Constitutional Theory Of The Islamic State*. (P.s. Dr. M. A. Muqtedar Khan është profesor në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve ndërkombëtare në University of Delaëare-SHBA). Shih linkun: <https://www.ijtihad.org/compact.htm> 8. Hamidullah, M. (1983) *Akdem Dushur Musexh-xhel fil Alem- Xhamia El Uthmanijje, Hajder Abad*, fq. 98. 9. Peter Demant si një autor i shumë shkrimeve e novelave ishte biri i një familjeje të asimluar hebreite, nga nazistët. Ai e kaloi fëmijërinë dhe rininë e tij në Czernowitz. Ai studioi në një shkollë të mesme gjermane, më pas në universitetet e Brno, Çekosllovakia dhe Aachen, Gjermani. Shih: https://en.wikipedia.org/wiki/Peter_Demant 10. *Xhizja (arabisht: jizyah) është një taksë vjetore për frymë, e vendosur historikisht në formën e tarifës financiare për dhimmitë, domethënë subjektet e përhershme jomyslimane të një shteti të qeverisur nga ligji islam*. 11. Demant, P (2006). *ISLAM vs. ISLAMISM. The Dilemma of the Muslim World. Firsi published in 2006 from Praeger Publishers*. Londër. Fq.79-80. 12. Bowering, G. (2015). *Islamic Political Thought*. Princeton University Press. Neë Jersey. Fq. 133 (p.s. Titulli i punimit është (Minorities) nga autori Yohanan Friedmann, i cili ia ka bashkangjitur këtë punim librit të edituar nga Bowering).

Prof.Ass.Dr. Rexhep Suma

Polemizimi në formën më të bukur, shenjë e thirrjes islame

“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit!” (En-Nahl, 125).

Duke u nisur nga ajo që kemi shtjelluar mbi kontekstin e debatit dhe dialogut, gjejmë se polemika ka forma të ndryshme, prej tyre ka të lejuara, ashtu siç ka edhe të ndaluara. Duke iu referuar argumenteve dhe fakteve të cilat na i paraqet Krijuesi ynë mbi këtë çështje gjejmë një sërë argumentesh të tilla të cilat na i qartësojnë rrugën se në cilën frymë duhet kanalizuar debatin dhe polemikën tonë gjatë thirrjes dhe komunikimit të mesazhit hyjnorë.

Islami në radhë të parë konfirmon fjalën tevhidit (besimin në njëshmërinë e Allahut) dhe tevhidin e fjalës (njëshmërinë e fjalës, unitetin e umetit islam që nënkupton unifikim e tyre rreth fjalës). E para, thërret në besim (iman), kurse e dyta është reflektim praktik i së parës. Ata që kanë një Zot, një të Dërguar, një Libër, një Kible dhe një shkak të krijimit dhe jetës së tyre, doemos që edhe fjala e tyre të jetë një: “Vërtet, ky është besimi juaj – besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua!” (El-Enbija, 92).

Kur mospajtimi bëhet i papranuar dhe kur bëhet i pranuar?

Mospajtimi për nga motivet ndahet në tri grupe: mospajtim i nxitur nga epshi dhe vetëpëlqimi, që

“Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. Allahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar.”

(En-Nisa, 107)

është mospajtim i papranuar; mospajtim i nxitur nga e vërteta, siç është mospajtimi me pjesëtarët e librit, idhujtarët dhe hipokritët; dhe mospajtimi që hamendet midis lavdërimit dhe qortimit, mospajtim ky që shfaqet në gjëra që midis njëra-tjetrës ekziston një lloj preferimi ose pëlqyeshmërie më e madhe. Në kohën e të Dërguarit a.s. nuk ekzistonte diçka që do të mund të nxiste mospajtim, sepse i Dërguari i Allahut a.s. ishte pikë referimi i të gjithëve. Mirëpo, shokët e të Dërguarit a.s. ishin ata që pas kohës së tij a.s. nxitën mospajtime në shumë gjëra.¹

Allahu i Lartësuar thotë: “Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit!” (En-Nahl, 125).

Kurse në suren El-Ankebutë, Kurani përdor këtë diskurs duke iu drejtuar besimtarëve: “Ihtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thoni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.” (El-Ankebutë, 46)

Ashtu siç paraqitet në dritën e këtyre verseteve kuranore, polemika dhe diskutimi lejohen, madje urdhërohen, por me dy kushte: e para, të mbrohet e vërteta me të vërtetën; dhe e dyta, që të jetë me të mirë. Polemika është e padëshirueshme dhe e ndaluar në situatat e mëposhtme: E para, kur mbrohet e gabuara apo e pavërteta. Allahu i Lartësuar thotë: “Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. Allahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar.” (En-Nisa, 107). Pra, mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten me padrejtësi dhe mashtrim.

“Të tillë (zotat) që këta po lusin (pos Zotit), vetë ata (zotat e tyre) kërkojnë afrimin (te Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të Zotit tënd është për t’iu ruajtur.” (El-Kehf, 56).

E dyta, kur bëhet pa dije. Allahu i Madhëruar thotë: “Ka disa njerëz që diskutojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie dhe ndjekin rrugën e çdo djalli të ndërkrer.” (El-Haxh, 3).

E treta, kur nuk bëhet në mënyrën më të mirë dhe argumentet për këtë i përmendëm më parë. E katërta, kur bëhet për gjëra të paqarta, për të ndezur fitne apo për gjëra që nuk kanë vlerë. Allahu thotë: “Ai është që ta zbriti ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qarta (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt qartë për të shkakuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: “Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes.” (Ali Imran, 7).

Metodat e Kuranit për trajtimin e gjërave janë të shumëllojshme, ai disa herë nisat nga bota e padukshme (gajbit) drejt botës së dukshme (shehade), që përsëri të kthehet në botën e padukshme (gajbit), duket sikur lëvizë pandërprerë midis botëve të ndryshme, e që njeriu ndodh të dijë diçka prej saj, por edhe të mos dijë shumëçka nga këto bota, sepse njeriut iu është dhënë fort pak dije për këtë. Që këtë, të gjitha njohuritë njerëzore, në radhë të parë ato që njihen si njohuri të “tevhidit apo

akides ose kelamit”, nuk do të mundën kurrë të bëjnë që njeriu t'i arrijë horizontet e larta të tyre ose të frekuentojë në ato panjohuri.²

Debatin që e ka qortuar feja dhe e ka ndaluar atë, ka të bëjë me debatin që shpjen në kotësi, mbështetet mbi të pavërtetat, shpifjet, shkelja e të drejtave njerëzore, marketingut të dyshimeve e gjërave të ndaluara, epsheve apo debate që zhvillohet mbi metafizikën (gajbijatet) që është kërkuar nga ne t'i besojmë e mos të debatojmë rreth tyre siç janë lajmet mbi vahjin, emrat e Zotit dhe cilësitë, xhenetin e xhehenemin, ringjalljen apo debatin mbi vetë Kuranin. Andaj polemika që ka për substancë këto çështje dhe i lëndon këto gjëra atëherë ulemaja i kanë llogaritur si humbje kohe dhe që i ka ndaluar feja dhe për këtë çështje ka argumente të shumta.³

“Mos polemizo për ata që tradhetojnë vetveten. Allahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar.” (En-Nisa, 107). Po ashtu në një vend tjetër thotë: “Populli i Nuhut dhe grupet pas tyre patën përgënjeshtuar përpara këtyre (idhujtarëve), dhe secili popull (që përgënjeshtroi), u përpoq ta asgjësojë të dërguarin e vet dhe luftoi me çështje të kota, ashtu me ato deshi ta likuideojë të vërtetën,

e Unë i ndëshkova ata, e çfarë ishte ndëshkimi Im ndaj tyre.” (Gafir, 5)

“Rreth argumenteve të Allahut nuk kundërshton kush, pos atyre që nuk besuan; pra ty të mos të mashtrorë lëvizja e tyre nëpër qytete.” (Gafir, 4).

“E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së Allahut, duke mos patur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm.” (El-Haxh, 8)

Kurse të dërguarve, Zoti u dhuroi forcë në argumentim dhe urtësi dhe mençuri në misionin e daves për t'u përballur me të kotën (batilin) me anë të fjalës së fortë dhe argumenteve të qëndrueshme dhe bindëse. Kështu e lavdëron Allahu xh.sh. forcën e argumentit të Ibrahimit a.s.:

“Këto janë argumentet tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë në shkallë të lartë atë që duam. Zoti yt çdo send e vë në vendin e vet, asgjë nuk mund t'i fshihet.” (El-En'amë, 83).

Ibrahimit a.s. iu kishte dhënë një formë e argumentimit shumë e fortë, sa që kundërshtarët e tij kanë mbetur të pa tekst dhe të mahnitur nga fuqia e argumenteve të cilat i ofronte ai në polemnikën me të jobesimtarët dhe shkëlqeu e vërteta.

“Ata thanë: “O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, sillni pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!” (Hud, 32).

Por, disa popuj i ka qortuar Kurani pasi që humbën të vërtetën nuk gjetën fuqi për ta mbrojtur atë: “A, atë që rritet me stoli, e në dialog është i paqartë (ia përshkruajnë Zotit)?” (Ez-Zuhruf, 18).

Islami historikisht është mbrojtur me anë të argumenteve e në raste kur është ushtruar agresion mbi vlerat islame atëherë në raste specifike iu është imponuar lufta si opsion për ta mbrojtur atë nga errësira dhe sendet e kota. Lufta me fjalë e argumente ishte më e rëndë dhe më e vështira për politeistët dhe të humburit sesa lufta me anë të armës për t'i hedhur poshtë thirrjet dhe besimin e kotë të tyre.



Gjuha ndihmon në krijimin e realitetit duke u dhënë kuptim ngjarjeve

Ka një ndryshim të madh midis rritjes natyrale të gjuhës së gjallë dhe keqpërdorimit të saj. Ta keqpërdorosh gjuhën, është më shumë, sesa thjesht një çështje fjalësh. Ndryshe nga sa besohet rëndom, gjuha nuk e pasqyron realitetin, ajo nuk bën përshkrim të thjeshtë të botës siç shfaqet. Përkundrazi, gjuha ndihmon në krijimin e realitetit duke u dhënë kuptim ngjarjeve, ajo nuk është neutrale. Fjalët që përdorim për të emërtuar një ngjarje, shprehin në një masë të madhe edhe reagimin tonë ndaj asaj ngjarjeje. Kini parasysh debatin publik për eutanazinë (vdekje e vullnetshme ose vetëvrasje me ndihmën e mjekut). Nëse e sheh këtë akt si “imoral”, si një formë “vrasjeje” dhe si “dhunim të detyrës së mjekut për të shpëtuar jetë”, me siguri që do t’i kundërshtosh ata që përipiqen ta lejojnë atë. Por, nëse vetëvrasjen me ndihmën e mjekut e sheh si “të moralshme”, si një mënyrë për të dhënë “vdekje me dinjitet”, si një “alternativë e pranueshme kundër dhimbjes dhe vuajtjes së panevojshme” për ata që janë me sëmundje të pashërueshme, atëherë me siguri që në disa raste do të mbështesësh përpjekjet për ta lejuar atë. Por çfarë i ndan këto dy këndvështrime nga njëra-tjetra? Jo mundësitë e mjekësisë moderne; jo kushtet e pacientëve me sëmundje të pashërueshme; as edhe vetë akti i vetëvrasjes me ndihmën e mjekut. Të gjitha këto janë njësoj në të dyja rastet. Ndryshimi qëndron te kuptimi që u jepet atyre nga fjalët që i emërtojnë ato. Ndaj edhe, siç ka thënë një shkrimtar dikur, zgjedhja e fjalëve është gjithashtu zgjedhja e botës. Fjalët janë jetike edhe për vetë mendimin, pasi të menduarit dhe gjuha janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ne nuk mendojmë fillimisht një ide dhe pastaj falët që ta

shprehim atë. Në fakt, zakonisht, mendojmë me fjalë. Sa herë të ka ndodhur të thuash: “E di se çfarë dua të them, por nuk po më vjen fala e duhur.” Në fakt, nëse vërtet do ta dije se çfarë do të dëshiroje të thoshe, me siguri që do ta shprehje atë. Në shumicën e rasteve, kur kërkojmë falën e duhur, në fakt, jemi duke kërkuar idenë e duhur.⁴

Ofrimi i argumentit është i domosdoshëm për ta mbështetur dhe sqaruar të vërtetën dhe ofruar mbrojtje për të derisa të hapen drynat e zemrave dhe në këtë aspekt ndihmesë e nevojshme do të ishte urtësia e cila mbetet forcë e së vërtetës dhe polemika në formën më të mirë dhe të bukur do mbetet armë dhe fortësë për të vërtetën. Andaj thirrësit (predikuesit) duhet t’i marrin këto mësimë për të shfaqur të vërtetën dhe komunikimin e saj deri te masa.

Pra, rregulli bazë që një polemikë të jetë e lejuar, është që çdo polemikë që bëhet me dije, me të mirë, duke dashur njohjen e së vërtetës dhe ndjekjen e udhëzimit. Kjo është e pëlqyeshme, por nëse shkelet një nga këto kushte, atëherë është qortueshme. Për sa u përket teksteve që flasin se brezat e parë të myslimanëve e ndalonin polemikën, ka të bëjë me të shëmtuarën dhe të ndaluarën. S’ka si të jetë ndryshe, pasi po kështu kemi të tjerë dijetarë të brezave të parë që e lavdërojnë polemikën, pa përsëritur këtu që kjo gjë urdhërohet në Kuran dhe Sunet, siç e kanë përdorur edhe të dërguarit a.s. si dhe vetë dijetarët.⁵

Polemika në Kuran

Kurani famëmadh në rrjedhën e tij të mrekullueshme ka përmendur të gjitha format e polemikës: dialogun, debatin dhe i ka ftuar kundërshtarët në të, brenda kushteve që përmendëm më parë.

Ftesa për polemikë: “Zoti xh.sh. thotë: “Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes



jush: të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zot pos Allahut!” (Ali Imran, 64)

Nëse ata nuk pranojnë, kjo është një ftesë e sinqertë ndaj tyre për ta hapur kanalet e dialogut dhe ndërtimit të urave të komunikimit mes tyre, atëherë ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!”

I thirruri gjatë diskutimit dhe polemikës mund të arrijë deri në atë shkallë sa ta akuzojë thirrësin se është në humbje të qartë. Mirëpo, thirrësi nuk do të çuditet me sjelljen e thirrësit dhe se ky do të jetë i qetë dhe i butë ndaj tij sikur është rasti me Nuhun a.s.. Andaj thirrësi duhet gjithmonë ta ketë parasysh këtë dhe sa herë që të bëjë polemika e diskutime të përdorë fjalë dhe shprehje të mira, të jetë modest dhe i edukuar duke folur, të mos e ngrejë zërin, të mos jetë i vrazhdë, të mos tallet dhe që të jetë shumë i kujdesshëm duke sjellë argumente dhe fakte bindëse.⁶

Kjo vërtetohet nga ajeti kuranor: “Ti (Muhamed thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.” (En-Nahl, 125).

Kur ndodh që i thirruri këmbëngul në devijimin e tij dhe qëndron

kokëfortë në qëndrimin e tij dhe biseda me të bëhet e kotë, atëherë thirrësi duhet ta ndalë bisedën dhe polemikën me të e duhet ta rikujtojë fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Thuaj: O ju njerëz, juve ju erdhi e vërteta nga Zoti juaj, e kush merr rrugën e drejtë, ai e ka vetëm për veten e vet, ndërsa kush e merr të shtrembrën, ai e ka humbur veten. Unë nuk jam roja juaj!” (Junus, 108).

“E ti thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr që muret e tij (të flakës) i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai.” (El-Kehf, 29).

Kjo është metoda e ndërprerjes së polemikës, metodë shumë e sigurt, ngase disa njerëzve nuk u bën dobi polemika, ata me të nuk dëshirojnë të arrijnë tek e vërteta, por qëllimi i tyre është arroganca dhe mohimi. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Edhe sikur të zbritnim ty një libër të shkruar në letër, e ta preknin atë me duart e tyre, ata që mohuan do të thoshin: “Kjo nuk është tjetër përveç një magji e qartë.” (El-En’am, 7).

Pamje të dialogut në Kuran

Kurani polemizon me njerëzit duke dialoguar dhe kjo shfaqet qartë në shumë ajete, si për shembull: “Thuaj: “Më thoni, atë që Allahu ju dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?” Thuaj: “A ju lejoi Allahu ju, ose ju i shpifni Allahut?” (Junus, 59).

“Thuaj: “Më tregoni, nëse u vjen dënimi i Tij natën ose ditën, e çka i shtyn të nguten për të, kriminelët?” (Junus, 50).

“Thuaj: “Më thoni për ata që pos Allahut i adhuron, më tregoni se çka krijuan ata në tokë dhe a kanë pjesëmarrje në (krijimin në) qiejt? Nëse e thoni të vërtetën, më sillni ndonjë libër para këtij ose ndonjë

gjurmë të mbetur prej diturisë.” (El-Ahkaf, 4).

Imazhe të debatit në Kuran

Shenjat e debatit në Kuran duken në shumë ajete, ku kundërshtari vihet në vështirësi, madje shushatet dhe nuk është në gjendje të përgjigjet. Tematika që trajtohet, është e gjerë që nga krijimi i njerëzimit, Dita e Kiametit e deri te dorëzimi dhe besimi. Të kërkojë përgjigje dhe të sfidosh kundërshtarin, është një nga format e debatit, të cilën e gjejmë shpesh në Kuran.

“O turmë e xhinëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra, po nuk mundeni vetëm me ndonjë fuqi të fortë.” (Er-Rrahman, 33). “A ju e krijoni atë, apo Ne jemi që e krijojmë?” (El-Vakia, 59). “Pra, ata janë drejt, le ta sjellin një ligjërim si ai.” (Et-Tur, 34).

Pamje polemikash nga Suneti

Edhe tradita profetike nuk ngelet mbrapa në këtë drejtim nga Kurani. Një nga debatet interesante që na ka treguar Dërguari i Allahut, është edhe ndodhia mes Ademit dhe Musait a.s.. Ebu Hurejra tregon se Muhamedi a.s. tha: “Ademi dhe Musai replikuan me njëri-tjetrin. Musai i tha: “O Adem, ti si babai ynë na ke zhgënjyer dhe na ke nxjerrë nga Xheneti.” Ademi i tha: “Ti je Musai, që Allahu të përzgjodhi me fjalët e Tij, ta shkroi Teuratin me dorën e Tij, po më qorton për diçka që Ai e kishte caktuar për mua dyzet vjet para se të më krijonte?!” (Muslimi 2652, Ebu Davudi, 4701).

Këtu mund të përmendim dialogun që i Dërguari a.s. zhvilloi me Thumamen, ditën kur u zu rob dhe ishte akoma jobesimtar, deri sa u bë mysliman. Ebu Hurejra thotë: “Profeti a.s. dërgoi një grup kalorëshish

në drejtim të Nexhdit dhe ata sollën me vete një burrë nga fisi Beni Hanife që quhej Thumame ibën Athal, të cilin e lidhën pas një kolone të xhamisë. Profeti a.s., shkoi drejt tij dhe i tha: “Çfarë të shkon nëpër mend, o Thumame?” – “Mirësi, o Muhamed. Nëse më vret, vret një njeri që i merret gjaku, por nëse më trajton mirë, trajton një njeri që është mirënjohës. Nëse do pasuri, kërko ç’të duash.” Atë e lanë ashtu deri të nesërmen, pastaj ai (Profeti) i tha: “Çfarë të shkon nëpër mend, o Thumame?” - Atë që të thashë: “Nëse më trajton mirë, trajton një njeri që është mirënjohës...” Atë e lanë ashtu përsëri deri të nesërmen. Dhe Profeti i tha: “Çarë të shkon nëpër mend, o Thumame?” - Atë që të thashë. – “Lëreni të lirë Thumamen.” Ai u largua pranë disa palmave në afërsi të xhamisë, u la dhe pastaj hyri në xhami dhe tha: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij.” (Buhariu 462).

Shiko se çfarë rezultati pozitiv jep dialogu konstruktiv dhe i mençur.[7]

Polemika, debate janë teknika të lejuara dhe një nga format e mira që thirrja islame të arrijë te masa e gjerë. Gjatë debatit duhet të tregohet kulturë e debatit se përndryshe dëmet janë të pallogaritshme dhe të pafalshme. Gjatë zhvillimit të debatit duhet të respektohen parimet për të cilat kanë rënë në dakord para tij. Po ashtu pikë tjetër në debat duhet të mos përmbajë mesazhe të cilat zgjojnë huti dhe dyshim te masa rreth ndonjë çështje të caktuar.

1. Taha Xhabir Ulvan, “Etika e mospajimit në Islam”, Logos-A, Shkup, 2021, f.11. 2. Taha Xhabir Ulvan, po aty, f.25. 3. Abdulrahim El-Magdavi, El usus el ilmije li menhexhi edda veti el islamije, Daru-l hadare lin-neshr vet-tevzi, bot.3, Riad, 2018, f.729. 4. Stephen E.Lucas, Arti i të folurit publik, UETPRESS,Tiranë,2010,f.305. 5. Ebu Abdullah Ubejdullah El Ukberi (Ibën Bata), El Ibanetu-l kubra,2/529, darur-rajaje, Riad,1994. Xhamiu-l bejan el -ilm, e Ibën Abdulberrit, 422, 436. 6. Abdulkerim Zejdani, Usulu-d-ave, Muesesetu errisale, botimim i IX-të, Bejrut, 1999, f. 578. 7. Adnan Al Araur, Menhexhu eddaveti fi dav’il kitab ve essune, f. 270.

Prof. dr. sc. Edin Tule

Vrimat e zeza në organizimin islam

Xhamitë që në brendinë e tyre kishin xhemate apo ekipe të tilla kanë qenë fanarë të aftë që të akumulojnë sasi të mjaftueshme të erës në gjirin e tyre duke udhëhequr shoqëri të tëra myslimane në ardhmëri të shkëlqyer.

Xhamitë e periudhës osmane të ndërtuara kudo në botë, por edhe te ne, janë një kujtim i bukur i një periudhe të rëndësishme të progresit të iniciuar nga mendjet ambicioze dhe entuziaiste të myslimanëve të asaj kohe.

Duke marrë parasysh funksionin e tyre, me objektet përcjellëse të inkuorporuar bukur (medrese, musafirhane, konakë, mejtepe) me përbërje të pasur, me një arkitekturë mahnitëse, mund të themi me plot të drejtë se ato objekte kanë qenë sensacion dhe simbol i prosperitetit kohor.

Duke vështruar p.sh. eksterierin e Xhamisë së Hadumit, këtë godinë madhështore arkitektonike me dimensione të mëdha, njeriu ndien një refleks të qetësisë, bukurisë dhe rahatisë shpirtërore.

Psikologjia moderne na mëson që njeriu së bashku me qëndrimet e tij,

Vallë, a ka diku në ndonjë vend, shtet islam apo më gjerë që imami pas hytbes së xhumasë, para se të zbresë nga mimberi, të kërkojë mendimin apo informatën pohuese nga auditoriumi?

traditat, e formon edhe mjedisin i cili e rrethon.

Xhamia apo mesxhidi është i menduar si pikë qendrore ku bashkohen myslimanët, e që është edhe kuptimi literar (arab. - xhami) me qëllim të

organizimit, edukimit, lutjes dhe punës ekipore. Ekipi, apo grupi ekipor sipas definicionit, është një grup njerëzish i cili takohet rregullisht, konsultohet reciprokisht, e njeh bukur detyrën, kryen ndarjen e rregullt të detyrave dhe në mënyrë të sinkronizuar synon të arrijë qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata duke dhënë secili individ mundin maksimal.

Shembulli më i mirë i këtyre ekipeve të xhematit janë ekipet sportive.

Xhamitë që në brendinë e tyre kishin xhemate apo ekipe të tilla kanë qenë fanarë të aftë që të akumulojnë sasi të mjaftueshme të erës në gjirin e tyre duke udhëhequr shoqëri të tëra myslimane në ardhmëri të shkëlqyer.

Por, ajo që sot kemi në shumicën e xhamive në tërë botën islame mund ta përshkruajmë me fjalën grumbull (grup). Ndërsa grumbulli, sipas definicionit, është një grup njerëzish i afërt në një hapësirë të caktuar, në




Fig.1 Grumbulli




Fig.2. Masa




Fig.3. Ekipi



afat të caktuar kohor, me një interaksion sipërfaqësor, me një rrjedhë njëkahëshe të informatave, pa kurrfarë ndarjeje të punës dhe me një lidhje të pamjaftueshme ndërmjet tyre. Shembulli i këtyre grumbujve mund ta shohim p.sh. në aeroplanë, në teatër, tramvaj, autobus, tren etj..

Duke vështruar nga ky kënd, nuk ka fare ndryshim në mes të grupit, i cili për çdo të premtë kalon gjysmë ore në xhami duke dëgjuar një ligjëratë të mërzitshme dhe uniforme të ligjëruesit dhe grumbullit të njerëzve i cili udhëton me tramvaj prej një vendi në një vend tjetër duke dëgjuar një përmbajtje edukative të caktuar nga radioja, duke jetuar në iluzion se ky grumbull punon diç të dobishme.

Xhamitë me këtë mentalitet dhe praktikë janë “kasaphane” potenciale ose dhoma të gazeve për të ngulfatur çdo iniciativë apo vrima të zeza të cilat në kreativitet të avangardës së re janë të ndërtuara në frikë dhe padituri të liderëve.

Liderët e vërtetë krijojnë që në fillim njerëz, gjegjësisht liderë të vërtetë potencialë.

Pejgamberi a.s. është shembulli më i mirë për këtë, i cili në haxhin lamtumirës para turmës së njëqindmijë njerëzve haptas dhe drejtpërdrejt

Myslimanët potencialë, të caktuar me intelekt kritik, ose heshtin ose nuk vijnë në xhami, për të mos i identifikuar me arkitekturën e xhamive.

kërkoji informatën kthyesë nga auditoriumi i shumtë me pyetjen: “...A ju komunikova shpalljen?”, duke dëshiruar mendimin, komentit apo mospajtimin eventual pas së cilës pasoi përgjigjja vërtetuese. Vallë, a ka diku në ndonjë vend, shtet islam apo më gjerë që imami pas hytbes së xhumasë, para se të zbresë nga mimberi, të kërkojë mendimin apo informatën pohuese nga auditoriumi?

Xhamitë e kohëve tona janë bërë teatro pa repertor të mirëfilltë, me paraqitjen amatoreske të imamëve, të cilët janë në trendin e thellë të paarsimimit.

Xhamitë zakonisht i vizitojnë pleqtë në prag të fundit të jetës së

tyre, pa vizion dhe plan, me një refleks indiferent.

Myslimanët potencialë, të caktuar me intelekt kritik, ose heshtin ose nuk vijnë në xhami, për të mos i identifikuar me arkitekturën e xhamive.

Pyetjet që paraqiten para nesh:

1. A kërkon shekulli XXI një arkitekturë më atraktive dhe më të freskët e cila sipas funksionit do t'i përgjigjet nxitjeve teknologjike të kohës e cila vjen?

2. Si t'i bëjmë xhamitë si potencial për ardhmërinë e avangardës rinore?

3. Si ta formojmë frymën ekipore të xhematit, e jo të jemi grup apo masë e paorganizuar, pa plan program dhe detyra e obligime?

4. Cilat janë ato programe, faktorë argëtues dhe elemente motivuese që xhamisë do t'ia kthejnë epitetin e saj nga e kaluara - busulle e shoqërisë myslimane?

5. Përse askush nga ju pas hytbes, nuk pyet asgjë ditën e xhumasë?

Po cila është zgjidhja atëherë?

NUK MË SHKON NDËRMEND TË MENDOJ NË VENDIN TUAJ!

*Përktheu dhe përshtati:
Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi*

Blerim Musliu

Ezani, pranverë e shpirtit dhe zemrës

“Kur ta dëgjoni ezanin, thoni ashtu siç thotë myezini, e pastaj bini salavat për mua, sepse kush bie salavat një herë për mua, Allahu i Madhëruar do të bie dhjetë herë salavat për të. Pas salavateve, luteni Allahun për mua, për “vesile”, e ai është vend i posaçëm në Xhenet, i cili i takon një robi prej robërve të Allahut, e shpresoj se ai rob do të jem unë. Ai i cili bën lutje (dua) për “vesile”, unë do t’i bëhem atij ndërmjetës.” (Muhamedi a.s.)

Pranvera që gjallëron shpirtin dhe mendjen tashmë ka shtrirë bukurinë e saj në çdo cep. Ajo ka mposhtur të ftohtët dhe thatësinë dimërore, ngase bukuritë e saj janë pothuajse të pa përshkuara. Këtë thujse e dinë të gjithë, por e veçanta e saj është kthjelltësia dhe qetësia e mbrëmjeve të saj, që shoqërohet me erën e luleve, e cila sikur të merr me vete e të shëtit në bukurinë dhe gjallërinë e mendjes e të shpirtit, pas një pushimi të gjatë dimëror.

Rëndom gjatë kësaj kohe dëshiroj të qëndroj në oborrin e xhamisë, nga ku sodis me vëmendje yjet në lartësi, të cilët me përpikëri i kryejnë detyrat e Krijuesit të tyre, e njëra prej detyrave të tyre është edhe zbukurimi i qiellit. Mjafton të mos e shikosh qiellin me syrin e përditshmërisë, por me një meditim për ta parë bukurinë e hënës, e cila sikur të lë pa fjalë në këtë përshkrim, dhe për shumë kënd mbetet e pa shijuar si kënaqësi e shikimit në të.

Shumica nga njerëzit në këtë kohë qëndrojnë me familjet e tyre, disa të lodhur nga punët pranverore, e disa të tjerë tashmë kanë dalë në ballkonet e kafeneve për të pirë ndonjë kafe. E kur tiktaket e orës shënojnë kohën e caktuar, myezini e thyen këtë heshtje të qytetit, për të na thirrur në një heshtje tjetër, para Krijuesit të asaj që e përshkuam deri më tani.

Ezani, kjo thirrje e bukur që dëgjohe në çdo qoshe të qytetit, madje era pranverore e bartë edhe nëpër fshatra. Është një thirrje që jo rastësisht fillon me “Allahu Ekber” – Allahu është më i Madhi, e padyshim se Ai është më i Madhi se çdo gjë që e shohim apo nuk e shohim, e dimë apo nuk e dimë

Ezani, kjo thirrje e bukur që dëgjohe në çdo qoshe të qytetit, madje era pranverore e bartë edhe nëpër fshatra. Është një thirrje që jo rastësisht fillon me “Allahu Ekber” – Allahu është më i Madhi, e padyshim se Ai është më i Madhi se çdo gjë që e shohim apo nuk e shohim, e dimë apo nuk e dimë. Thirrja e bukur vazhdon me dy shehadetet, ku



dëshmojmë atë që është thellë e ngulitur në zemrat dhe mendjet tona, e këtë sikur e dëshmon çdokush që e dëgjon, se nuk ka më meritore që të adhurohet, t’i lutemi, ta duam e ta madhërojmë se Allahu, Krijuesi i çdo gjëje. I vetmi Krijues i pashoq, që nuk ka lind askënd, e as nuk është i lindur prej askujt, e këtë dëshmi çuditërisht nuk e besojmë vetëm një



pakicë njerëzish, që mbesin pakicë në raport me të gjitha krijesat e tjera, që i janë nënshtruar me dashuri dhe dëshirë Zotit të tyre.

“Dëshmojmë se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Zotit” – e kjo për ne është nder dhe privilegj, që ta besojmë e ta pasojmë njeriun më të mirë, njeriun me virtytet më të larta, atë që i dha njerëzimit atë që i mungonte, që nga njohja e Zotit e deri tek edukata, mirësjellja, drejtësia e bujaria. Muhamedi a.s. ishte i dërguar rahmet e mëshirë nga Zoti Fuqplotë.

“Eja në namaz” – është thirrja e radhës, që çdo njeri e dëgjon, por jo çdokush i përgjigjet, ngase Allahut i përgjigjen vetëm ata që Allahu i ka udhëzuar, e nëse Allahu ta ka mundësuar që t’i përgjigjesh, kjo është një begati dhe dhunti prej Tij, sepse Ai nuk ka nevojë për ne.

Namazi është barka e shpëtimit, e thirrja më e bukur, ezani, e bartë edhe këtë. “Eja në shpëtim” – kjo është thirrje që nuk dëgjohet me vesh, por ndjehet me zemër, për atë që arrin të

lëvizë nga ndeja e muhabeti me shoqëri e familje, për të dëshmuar fjalën e parë të ezanit, se Allahu për të është më i Madhi. Për Allahun ai braktis çdo gjë, për t’u takuar, për t’u relaksuar, për të qëndruar para Tij, e me Të të bashkëbisedojë, për të shpresuar në shpëtim nga turbullirat e dynjasë e nga vështirësitë e Ahiretit.

Nëse nuk arrin të lëvizësh kur ta dëgjosh ezanin, si shpreson t’u bësh ballë momenteve të vdekjes, e të shpresosh në forcën për ta dëshmuar dashurinë, kur këtu nuk arrin ta largosh kënaqësinë. Si shpreson në shpëtim kur arrin ta injorosh thirrjen “Eja në shpëtim”?!

Tani ezani veçse përfundoi, përsëri më dëshminë se Allahu është më i Madhi, e besimtarët që e dëgjuan këtë ezan po bëhen gati për t’u radhitur në safë, për ta përjetuar kënaqësinë e atyre që ezanin e dëgjojnë me zemra e jo vetëm me vesh.

KUR VDES NJERIU I MIRË

Ndërroi jetë një njeri i mirë
Me pamje të buzëqeshur
Dorë e tij ngeli e shtrirë
Fytyrë çelur
Mbeti në shuplakë të botës
Nuk ishte duarshtrënguar
As mërrolat
S’iu panë hullive të ballit
Jetë ndërroi njeriu i mirë
Këtë kumt
E dhanë engjëjt kasnecë

MATEMATIKË SHPIRTI

Parajsa
Parajsa
Parajsa
+
Drita
=
Pendimi
+
(Purgatori)
-
Ferri
Ferri
Ferri
+
Terri
=
Mëkatari

KUJTESË

Në një cak vetmitar
I humbi lutja për shpëtim
Pastaj
Engjëjt ia çelën faqën e tretë
Lexoi fjalën... AMIN

Bilall Maliqi

Erëza Sahiti

Qëllimi i jetës në kornizat islame

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dharijat, 56).

Kuptimi i jetës si fenomen psikologjik kuptohet vetëm në bazë të perspektivës së vendeve perëndimore, gjë që kërkon të eksplorohet perceptimi i myslimanëve rreth këtij koncepti. Gjetjet zbulojnë se studentët myslimanë që e perceptojnë jetën si një marrëdhënie të ngushtë me Zotin dhe shërbim ndaj qëllimit të Tij, i ndihmon ata ta perceptojnë jetën si kuptimplotë.

Për këtë studim u morën subjekt 15 studentë pasi morën pjesë vullnetarisht në intervistën ballë për ballë.

Cila ishte gjetja parësore e këtij studimi?

Gjetja parësore e këtij studimi ishte se studentët myslimanë e perceptuan kuptimin ekzistencial si nga faktorët shpirtërorë ashtu edhe ata materialë të jetës. Koncepti i kuptimit nga këndvështrimi i një myslimani pasqyron një fenomen holistik dhe gjithëpërfshirës pasi elementet fetare dhe elementet e kësaj bote priren të lidhen në një formë ose në tjetrën. Kështu, qëllimi që një mysliman shpreston të arrijë përmban atë që është e natyrshme në këtë botë dhe në botën tjetër. Për më tepër, marrëdhënia midis temave tregoi një perceptim holistik të kuptimit të jetës te studentët myslimanë. Në mënyrë të ngjashme, O'Connor dhe Chamberlain (1996) zbuluan se shfaqja më e madhe e përvojave kuptimplotë ishin ato që lidhen me zhvillimin personal, fenë, shpirtëroren dhe marrëdhëniet me njerëzit.

El-Gazaliu thekson se ata që mendojnë seriozisht për përjetësinë e kaluar gjatë së cilës bota nuk ekzistonte, dhe përjetësinë e ardh-shme gjatë së cilës ajo nuk do të ekzistojë, do të shohin qartë se bota në thelb është si një pikë kalimi.

Një numër në rritje i studimeve tregojnë se një numër njerëzish raportojnë zhvillim psikologjik pasi

kanë përjetuar trauma. Kjo mund të jetë kështu sepse vuajtja stimulon nevojën dhe kërkimin e kuptimit. Edhe pse faktorët e situatës dhe personalitetit luajtën role të rëndësishme, ky studim tregon qartë rëndësinë e pjekurisë së besimit dhe rritjes post-traumatike për promovimin e mirëqenies holistike të atyre që preken nga trauma. Besimet fetare



mund të kundërshtojnë mungesën e shpresës dhe të formojnë një amortizator të rëndësishëm në këtë ekuacion.

Cili është kuptimi dhe qëllimi i jetës sipas konceptit islam?

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dharijat, 56).

Tani, a do të thotë që adhurimi është të falim namaz gjatë gjithë ditës? Jo, gjithçka që e duam më së shumti ose i bindemi ose mbështetemi më së shumti, ai është akt adhurimi, që do të thotë se secili prej nesh po adhuron diçka ose dikë në çdo moment. Si shembull, disa njerëz e duan paranë aq shumë sa që kjo dashuri e tyre për para është akt adhurimi. Disa njerëz mbështeten tek alkooli për të kaluar një kohë të mirë, pa të, ata janë të dëshpëruar, janë të mërzitur, kjo mbështetje tek alkooli është akt adhurimi dhe për këtë shkak, Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “A e ke parë ti atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin.” (El-Xhathijeh, 23).

Po, ne mund ta adhurojmë vetveten, nëse duam diçka dhe i bindemi çfarë do gjëje, sado imorale që të jetë atëherë ne e kemi adhuruar vetveten tonë. Tani, këtu tregohet bukuria e vërtetë e Islamit. Duke adhuruar Allahun xh.sh., dhe duke e përmbushur qëllimin tonë, që do të thotë, ta njohësh Madhështorin, t'i bindesh Atij më së shumti, ta duash më së shumti dhe të mbështetesh tek Ai më së shumti, e lirojmë veten nga adhurimi i çdo gjëje tjetër. Pra përfundimi është se ne e adhurojmë Krijuesin tonë dhe jo krijimin e tij dhe nga kjo perspektivë, ky është çlirim i vërtetë. Kur e shpreh kështu duket si diçka shumë e lehtë për t'u kuptuar. Pse nuk do ta adhuroje Allahun, apo jo? Po çka nëse gjërat vështirësohen



shumë në jetë, për këtë arsye Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’iu provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi.”

Po në Islam jeta është test, të gjitha dobësitë, konfliktet, problemet tona janë pjesë e këtij plani. Se a do të vazhdojmë të adhurojmë Ngadhënjuesin, pa marrë parasysh se çka ndodh në jetët tona duke mos harruar që Allahu xh.sh. na dha gjithë këto të mira falas?! Nëse po, atëherë e kemi kaluar testin nga ky këndvështrim dhe çfarë do vjen pas këtij testi, pas vdekjes, aty do të gjejmë perfeksion të vërtetë dhe pafundësi.

Kur zhvillojmë veten dhe kur kuptojmë qëllimin e ekzistencës sonë në tokë mbi adhurimin e të Plotfuqishmit dhe përgatitjen për ditën që do të takojmë të Plotfuqishmin, ne duhet të përsosim veten, duhet t'i premtojmë vetes se do të jemi versioni më i mirë që nga kjo ditë, sepse nuk kemi shumë kohë në tokë, ne duhet të lëmë një gjurmë, një trashëgimi.

Duhet të kuptojmë se cila është urtësia hyjnore që jemi këtu dhe kjo jo vetëm për të adhuruar të Plotfuqishmin, por në të njëjtën kohë për të njohur dhe respektuar dhe përmbushur të drejtat e krijesave të tjera.

Njerëzit thonë se e dua Allahun xh.sh., e dua Krijuesin tim, lutem, jap lëmoshë, agjëroj, kam qenë në haxh, bëj shumë vepra të mira, largohem nga shumë të këqija, por çfarë nëse ju keni lënduar ndjenjat e njerëzve, jeni një racist ose shprehni negativitet ndaj njerëzve, ju dëmtoni, ju lëndoni, ju mashtroni, jeni mbushur me xhelozitë!

Duhet të dimë se nuk e kemi dashur ende Krijuesin tonë, nëse nuk e duam atë që ka krijuar Krijuesin jonë.

Në fund të fundit, misioni ynë duhet të jetë adhurimi i Krijuesit tonë, fitimi i njohurive për t'u bërë një besimtar ideal, duke i shërbyer njerëzimit, bërja e përpjekjeve për t'i ndihmuar njerëzit e tjerë që të jenë të dashur nga Allahu. Veprat e bëra me zemër të pastër, qëllime të sinqerta, me përpulësi, dashuri dhe kujdes përmbushin misionin e jetës.

Referencat:

1. Kurani. 2. <https://www.sciencedirect.com>.
3. Al-Ghazali, 1954. Al-Ghazali, A.H. (1954) *The Alchemy of Happiness; A Compendium of some chapters of "Ihya'Ulum al-Din"*. Translated by Sh. Muhammad Ashraf, Claud Field. Lahore.
4. Badri, 1979. M.B. Badri *The Dilemma of Muslim Psychologists MWH London Publishers* (1979).
5. <https://www.youtube.com/watch?v=1AqV4bB3CZl-what-is-your-purpose-Mufti-Menk>.
6. https://eastsidemosque.com/content/Purpose_of_Life.pdf.

PhD (C) Melihate Zeqiri

Shumëgjuhësia institucionale (2)

Kosova një Zvicër e vogël linguistike e ballkanike

Faktorët që ndikojnë në dygjuhësinë shqip – serbisht në Kosovë

Dygjuhësia si dukuri është e pranishme gjithandej nëpër botë dhe pothuajse nuk ka entitet shoqëror apo shtetëror që është krejtësisht njëgjuhësh. Pothuajse në çdo vend, dukuria e bilinguizmit i ka tiparet dhe karakteristikat e veta specifike. Kjo dukuri, që shfaqet si rezultat i kontakteve gjuhësore, është shumë komplekse dhe variabile, e ndërlidhur ngushtë me zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike e kulturore. Ndryshimet e këtyre faktorëve ndikojnë drejtpërdrejt edhe

në aspekte të bilinguizmit në kuadër të entiteteve shoqërore dygjuhëshe. Për shkak të këtyre dimensioneve komplekse, dygjuhësia paraqet një sfidë për planifikimin e gjuhës, sidomos për planifikimin e statusit dhe të funksioneve të gjuhës, sepse ky planifikim reflekton edhe qasjen, qëndrimet dhe nivelin e tolerancës së bashkësisë shoqërore në raport me gjuhët. Planifikimi gjuhësor shpërfaq synimin e bashkësisë shoqërore për të stimuluar dominimin gjuhësor ose, e kundërta, synimin për të promovuar barazinë gjuhësore. Në kuadër të shembujve të ndryshëm të planifikimit gjuhësor të dygjuhësisë, që mund të gjenden gjithandej nëpër botë, rasti i dygjuhësisë shqip – serbisht në Kosovë paraqet një shembull mjaft me interes për t'u

Derisa shqiptarët tashmë nuk janë të detyruar ta flasin serbishten, pasi prestigji i saj i dikurshëm është shuar, serbët ende kanë paragjykitime ndaj gjuhës shqipe

studiuar. Më sipër, përshkruam vendimet që janë marrë në fushën e planifikimit të statusit të shqipes në Kosovë pas vitit 1999. Po ashtu theksuam se bilinguizmi shqip – serbisht në Kosovë shfaqet si dukuri e bilinguizmit asimetrik dhe si



rrjedhje e kontaktit dhe e konfliktit gjuhësor.

Kur bëhet fjalë për dygjuhësinë shqip – serbisht në Kosovë dhe për faktorët kryesorë që e përcaktojnë këtë dukuri, duhet theksuar se në këtë drejtim duhen marrë parasysh disa kriteret të rëndësishme, siç janë: kriteri demografik, domenet e kontaktit, interaksioni (ndërkomunikimi), kompetenca gjuhësore, qëndrimet ndaj gjuhëve dhe nxënia e tyre. Këto janë disa nga kriteret kryesorë për të cilët do të diskutojmë në kapitujt në vazhdim dhe, siç do të shohim, shumë çështje të dygjuhësisë dhe të raporteve midis shqipes dhe serbishtes dhe folësve të këtyre gjuhëve varen nga këta faktorë. Kur bëjmë fjalë për çështjet e dygjuhësisë institucionale, duhet theksuar se meqenëse shqiptarët përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë së Kosovës (sipas regjistrimit të vitit 2011), ata janë bartës kryesorë të institucioneve të Kosovës dhe duke qenë shumicë kanë mundësi ta favorizojnë gjuhën e tyre. Pra, kriteri demografik ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol kryesor në raportet midis shqipes dhe serbishtes në Kosovë. Në anën tjetër, si pasojë e luftës, marrë-

dhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve janë ftohur në masë të madhe dhe kjo ka çuar pothuaj në ndarjen e hapësirave ku jetojnë ata. Sot serbët jetojnë kryesisht në disa qytete e fshatra të Kosovës në bashkësi kompakte, të cilat kryesisht janë të ndara jo vetëm nga popullsia shqiptare, por edhe nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Me fjalë të tjera, domenet e kontakteve midis shqipes dhe serbishtes janë kufizuar ndjeshëm. Kontaktet e përditshme, sidomos ato joformale, midis shqiptarëve dhe serbëve janë reduktuar në masë të madhe dhe kjo është reflektuar edhe në dendurinë e komunikimit gjuhësor reciprok. Nëse dikur shqiptarët dhe serbët në Kosovë përbënin bashkësi komunikuese, sot shqiptarët dhe serbët janë bashkësi pothuajse të ndara gjuhësore. Ndërkomunikimi i reduktuar gjithashtu ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e bilinguizmit shqip – serbisht në Kosovë. Institucionet e Kosovës janë duke bërë përpjekje që t'i integrojnë pakicat në Kosovë dhe mund të ndodhë që kjo situatë të ndryshohet në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ndarja fizike ka bërë që brezat e rinj

të mos jenë në gjendje ta mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit. Në të vërtetë, siç do të shohim në vazhdim, tash e pothuaj tri dekada ka filluar një proces i shuarjes së bilinguizmit shqip – serbisht te brezat e rinj të folësve shqiptarë të Kosovës. Prandaj, kompetenca gjuhësore paraqet problem thelbësor për zbatimin e bilinguizmit shqip – serbisht. Derisa shqiptarët tashmë nuk janë të detyruar ta flasin serbishten, pasi prestigji i saj i dikurshëm është shuar, serbët ende kanë paragjykimet ndaj gjuhës shqipe dhe ende mbajnë qëndrime politike lidhur me rrethanat dhe raportet politike e shoqërore të krijuara në Kosovë pas vitit 1999. Për shkak të epërsisë që kishte dikur serbishtja, shqiptarët e Kosovës, brezat e mesëm dhe të vjetër, në masë të madhe ishin bilingë, sot ata hezitojnë të flasin serbisht në rastet kur duhet të komunikojnë me serbët. Në anën tjetër, edhe brezat e mesëm dhe të vjetër të serbëve, duke jetuar në fqinjësi me shqiptarët duket se e kuptojnë dhe e flasin shqipen, por hezitojnë ta flasin kur komunikojnë me shqiptarët, mbase për shkak të sedrës së tyre. Qëndrimet reciproke



Autorja Sara Thomason thekson se nuk ka asnjë provë në Ballkan për marrëdhëniet e mbizotërimit asimetrik në shkallë të gjerë të një gjuhe ndaj një gjuhë tjetër, përveç dominimit turk dhe, po ashtu, nuk ka asnjë provë për ndërrim të gjuhës në shkallë të gjerë.

ndaj gjuhës serbe, respektivisht shqipe, janë gjithashtu një element i rëndësishëm që ndikon në bilinguizmin shqip – serbisht. Një tjetër zhvillim ka të bëjë me nxënien e gjuhëve dhe dy gjuhët zyrtare të Kosovës më nuk mësohen as në sistemin arsimor. Nxënësit shqiptarë në shkollat e tyre e mësojnë anglishten dhe jo më serbishten, ndërsa as nxënësit serbë nuk e mësojnë shqipen. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar që ndonëse në Kosovë kemi dygjuhësi zyrtare të deklaruar dhe të vendosur në kushtetutë, megjithatë, në realitet, dygjuhësia është e reduktuar vetëm në funksione e domene formale, por edhe në këto funksione epërsia e shqipes, për shkak të kriterit demografik, është domethënëse. Këto janë vetëm disa nga problemet më evidente të bilinguizmit zyrtar shqip – serbisht. Në vazhdim do të përpiqemi t'i trajtojmë disa nga problemet e cekura më lart dhe ndikimin e tyre në zbatimin e dygjuhësisë në Kosovë.

Gjendja e sotme e dygjuhësisë shqip – serbisht në Kosovë

Treva e Kosovës për shekujt me radhë ka qenë vendtakim midis shqipes dhe serbishtes si dy gjuhë të familjes indoeuropiane, por që u takojnë grupeve të ndryshme gjuhësore brenda kësaj familjeje. Në trungun e gjuhëve indoeuropiane shqipja del si gjuhë e veçantë, ndërkaq serbishtja hyn në grupin e gjuhëve sllave, më saktësisht në nëngrupin e gjuhëve sllavo-jugore. Për shekujt me radhë banorët e Kosovës, kryesisht shqiptarët dhe serbët etnikë, kanë jetuar dhe ndërvepruar me njëri-tjetrin, pothuajse në të gjitha domenet e komunikimit. Në masë të madhe, folësit e shqipes dhe të serbishtes në Kosovë kanë qenë bilingë, ndërkaq raportet midis gjuhëve të tyre janë ndikuar drejtpërdrejt nga raportet e përgjithshme shoqërore, politike e kulturore. Duhet përmendur se për një periudhë të gjatë, që nga gjysma e dytë e shekullit XV, shqiptarët dhe serbët në Kosovë kanë jetuar nën administrimin e pushtetit otoman. Prandaj, sa u përket raporteve midis gjuhëve ballkanike në ato rrethana, autorja Sara Thomason thekson se nuk ka asnjë provë në Ballkan për marrëdhëniet e mbizotërimit asimetrik në shkallë të gjerë të një gjuhe ndaj një gjuhë tjetër, përveç dominimit turk dhe, po ashtu, nuk ka asnjë provë për ndërrim të gjuhës në shkallë të gjerë. Pas largimit të Perandorisë Osmane nga trevat e Ballkanit kanë ndryshuar rrethanat dhe raportet midis gjuhëve të Ballkanit. Në Kosovë, pas vitit 1912, për shkak të rrethanave politike, ekonomike e kulturore, shqipja është vendosur në një gjendje të vështirë dhe në raporte trysnie nga serbishtja. Pa u ndalur në historinë e mëhershme të kontakteve të shqipes dhe të serbishtes në shekujt e kaluar, të theksojmë edhe një herë se dygjuhësia shqip – serbisht në Kosovë gjatë shek. XX shfaqet si dukuri e

bilinguizmit asimetrik dhe si rrjedhojë e kontaktit dhe e konfliktit gjuhësor. Në kapitullin e dytë theksuam se gjendja dhe raportet e bilinguizmit në Kosovë kanë qenë subjekt i ndërhyrjes planifikuese, e cila ka pasur për qëllim përcaktimin e statusit të shqipes dhe të serbishtes, por edhe planifikimin e funksioneve të tyre, sidomos në rrafshin zyrtar dhe administrativ. Për ta pasqyruar gjendjen e dygjuhësisë shqip – serbisht në Kosovë dhe problemet e zbatimit të dygjuhësisë, kemi kryer disa hulumtime dhe kemi trajtuar disa çështje që ndërliidhen kryekëput me dukurinë e bilinguizmit Hulumtimi i kryer në vitin 2011, që u pasqyrua në kapitullin e tretë, kishte vërtetuar disa hipoteza kryesore që i kishim ndërtuar qoftë si rezultat i vëzhgimeve josistematike, qoftë si rezultat i përshtypjeve të fituara nga jeta e përditshme në këtë ambient në Kosovë. Në bazë të gjetjeve kryesore kemi konstatuar se në Kosovë është duke ndodhur një proces i vazhdueshëm i shuarjes së dygjuhësisë shqip – serbisht te shqiptarët e Kosovës. Prandaj, ndonëse politika gjuhësore që ndiqet në Kosovë promovon dygjuhësinë, gjendja dhe praktika gjuhësore në terren e vështirëson zbatimin. Hulumtimi i parë i kryer, për të cilin bëmë fjalë pak më parë, na ka nxitur që të kryejmë edhe hulumtime të tjera në terren, për të rivlerësuar se cila është gjendja e dygjuhësisë shqip – serbisht në Kosovë, në mënyrë që të jemi në gjendje për ta parë procesin e zhvillimit të tanishëm të kësaj dukurie. Të dhënat që i kemi marrë, në një pjesë të konsiderueshme të tyre, përkojnë me të dhënat e hulumtimit paraprak, por këtë radhë kemi synuar grupe të tjera shoqërore për t'i përfshirë në hulumtim dhe jemi përpjekur t'i gjejmë vatrën kryesore të kontaktit aktual midis folësve të shqipes dhe të serbishtes, si dhe të hulumtojmë se cilat janë format dhe kodet e ndërkomunikimit në ato vatra të kontaktit.

Reportazh nga vizita e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në EBA, Arabinë Saudite dhe në Katar

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti, qëndruan për vizite zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite dhe në Katar. Ai gjatë kësaj vizite mori pjesë në konferenca dhe zhvilloi shumë takime zyrtare me ministra, myftinj, liderë dhe zyrtarë të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Vizita në EBA



Me ftesë të Qeverisë së EBA-së, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori merr pjesë në sesionin e dytë të forumit të Këshillit Botëror të Shoqërive Myslimane.

Forumit me titullin “Uniteti islam – koncepti, mundësitë dhe sfidat” u mbajt në qytetin Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe. Forumi filloi punimet me datë 11 maj dhe u hap me lexim të ajeteve nga Kurani fisnik, për të vazhduar më pas me fjalën hapëse nga ministri i Tolerancës, sheiku Nehjan bin Mubarak al-Nahjani. Ai, që në fillim theksoi përkushtimin e Qeverisë së EBA-së në manifestimin dhe përhapjen e tolerancës dhe bashkëjetesës. Në hapje të forumit, një fjalë rasti mbajti edhe dietari i mirënjohur,

Abdullah bin Beja, i cili njëherësh është edhe kryetar i Këshillit të Fetvasë në EBA. Ai theksoi rëndësinë e ngritjes së vetëdijes së myslimanëve rreth konceptit të unitetit islam, si dhe rreth tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet gjithë njerëzimit pa dallim. Në hapje të këtij forumi folën edhe ministri i Vakëfeve të Egjiptit, dr. Muhamed Muhtar Xhuma, kryetari i Dijanetit të Turqisë, dr. Ali Erbash, sekretari gjeneral i Konferencës për Bashkëpunim Islamik, dr. Husein Ibrahim Taha etj.. Ky forum u organizua nën patronatin e Qeverisë së Emirateve, përkatësisht nga Ministria e Tolerancës dhe Bashkëjetesës dhe zgjati dy ditë. Në të morën pjesë ministra, myftinjë, mendimtarë, dietarë dhe liderë nga më shumë se 150 shtete të botës. Këshilli Botëror i

Shoqërive Myslimane u themelua në vitin 2018 dhe për synim ka përhapjen e tolerancës dhe bashkëjetesës, si dhe ngritjen e vetëdijes shoqërore të shoqëritë myslimane.

Në margjinat e konferencës Myftiu Tërnavë zhvilloi takime të shumta, siç ishin takimi me kryetarin e Dijanetit të Turqisë dr. Ali Erbash, me Reis Uleman e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shaqir ef. Fetahun, kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiun, myftiun e Kroacisë dr. Aziz Hasanovic, myftiun e Sllovenisë, Nevzat Poric, sekretarin e Përgjithshëm të Këshilli Botëror të Shoqërive Myslimane, dr. Mohamed Beshari, myftiun e Australisë, dhe me shumë personalitete të tjera të botës islame.

Vizita në Dubai

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe delegacioni që po e shoqëron, zhvilluan në Dubai një takim me dr. Mirza As-Saeg, anëtar i Këshillit Drejtues të Fondacionit Al Maktum.

Duke pas parasysh se ky ishte takimi i parë pas pandemisë covid-19, si dhe pas kalimit në botën tjetër të donatorit të madh të BIK-it, sheikut Hamdan bin Rashid Al Maktum – Allahu e mëshiroftë!, Myftiu Tërnavë shprehu ngushëllimet e tij në emër të BIK-it, duke lutur Allahun xh.sh. që sheikun Hamdan bin Rashid Al Maktum ta shpërblejë më të mirat e Tij.

Myftiu Tërnavë gjithashtu falënderoi nikoqirin për mikpritjen dhe falënderoi qeverinë e EBA-së për përkrahjen ofruar Kosovës. Myftiu e njohu nikoqirin me gjendjen e projekteve të realizuara në Kosovë në bashkëpunim me BIK-un, duke veçuar me lutje dhe falënderim ish-ministrin e Financave të EBA-së, sheikun Hamdan bin Rashid Al



Maktum - Allahu e mëshiroftë!, për përkrahjen e ofruar për BIK-un në realizimin e projekteve të ndryshme.

Nga ana e tij, nikoqiri falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën duke çmuar lart edhe ngushëllimet e ofruara për vdekjen e sheikut Hamdan bin Rashid Al Maktum. Ai gjithashtu konfirmoi se Fondacioni Al Maktum,

të cilin tani e kryeson Rashid bin Hamdan Al Maktum, do të vazhdojë bashkë-punimin me BIK-un në realizimin e projekteve të ndryshme, duke rithek-suar qëndrimin zyrtar të EBA-së dhe vazhdimësinë e përkrahjes së Kosovës, si dhe cilësoi marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve si të shkëlqyeshme.

Vizita në Arabinë Saudite

Pas Emirateve të Bashkuara Arabe, Myftiu Tërnavë me datë 11 maj filloi një vizitë disa ditore në Arabinë Saudite.

Gjatë qëndrimit në Arabinë Saudite, Myftiu vizitoi Rijadin, Xheden, Medinën dhe Mekën.

Ai u prit në aeroportin ndërkombëtar “Mbreti Halid” në kryeqytetin Riad nga zv. sekretari i RABITA-së, dr. Abdurrahman az-Zejd.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, në Riad mori pjesë në “Forum global të vlerave të përbashkëta të



pasuesve të religjioneve të ndryshme”, si dhe realizoi shumë

takime zyrtare me autoritetet e shtetit saudit.

Forumi global i vlerave të përbashkëta të pasuesve të religjioneve të ndryshme

Me ftesë të sekretarit gjeneral të Ligës së Botës Islame (RABITA), dr. Muhamed Abdulkërim al-Isas, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në Forumin global të vlerave të përbashkëta të pasuesve të religjioneve të ndryshme, i pari i këtij lloji dhe i

cili u mbajt në kryeqytetin e Arabisë Saudite, në Riad.

Në këtë takim morën pjesë mbi 70 liderë nga gjitha religjionet, si islame, krishtere, hebreje, budiste, hinduse etj.

Në hapjen e takimit, një fjalë rasti mbajti sekretari gjeneral i RABITA-s,

dr. Muhamed Abdulkërim al-Isa, i cili fillimisht u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve, duke theksuar rolin dhe rëndësinë e secilit pjesëmarrës në këtë takim. Ai përmendi gjithashtu nevojën dhe rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit me përgjegjësi të lartë në përhapjen e tolerancës dhe

bashkëjetesës, si dhe për luftimin e urrejtjes fetare në çdo cep të botës.

Në hapje të Forumit, foli edhe kryepeshkopi i Kostandinopojës, patriarku Ekumenik Bartolomeo, i cili falënderoi RABITA-n për iniciativat e tilla, duke ftuar kështu të gjithë pjesëmarrësit që të kontribuojnë dhe të punojnë me ngulm për dialog dhe bashkëjetesë, pa marrë parasysh sfidat e kohës moderne.

Ndërsa, Walter Kim, kreu i Unionit Kombëtar Ungjillor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shpjegoi se jemi në një rast historik që bën thirrje për optimizëm për të ardhmen që ka një mundësi për paqen dhe ndërtimin e urave, duke theksuar nevojën që komunitetet fetare të bëjnë gjithçka që kanë në fuqinë e tyre për t'i dhënë fund varfërisë pas krizës që përjetuam gjatë pandemisë korona.

Nga ana tjetër, kryerabini i Italisë, kongregacioni i Rabinëve Evropianë, Riccardo Designe, tha se roli i fesë duhet të jetë pozitiv për të përhapur paqen, duke vlerësuar përpjekjet e bëra nga Lidhja Botërore Myslimane në përhapjen e paqes dhe tolerancës midis pasuesve të feve.

Kryetari fetar hindu, Lama Haman-deleshwar Swami Vadisan tha: “Dialogu mund të ketë sukses aty ku luftërat kanë dështuar, ndaj jam krenar që jam një nga pjesëmarrësit në këtë forum të organizuar nga Liga Botërore Myslimane, e udhëhequr nga avokati i paqes dhe Islamit, shkëlqesia e tij, shejh dr. Muhamed bin Abdulkerim al-Isa.”



Ndërsa zyrtari budist në Sri Lanka dhe Japoni, Banagala Obatisa Therou, theksoi se urrejtja nuk vritet nga urrejtja, por nga dashuria, dhe kjo është arsyeja pse çdo fe bën thirrje për shmangien e dhunës në të gjitha format e saj verbale dhe aktuale.

Kryetari i Këshillit të Fetvasë së EBA-së, Abdullah bin Beja dhe Myftiu i Egjiptit, dr. Shevki Alam, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit në mirësi dhe ndalim të së keqes. Thellimi i bashkëpunimit mbi vlerat e përbashkëta, rëndësia e respektimit të besimeve dhe bindjeve fetare, ishin ndër pikat e rëndësishme që përmendën kryetari i Këshillit të Fetvasë dhe Myftiu i Egjiptit.

Një fjalë rasti në këtë Forum pati, edhe kardinali Pietro Parolin, sekretari i shtetit të Shenjtërisë së Tij, Papa Françeskut, i cili tha se Konferenca me temën “Vlerat e përbashkëta mes pasuesve të feve” është historike dhe pozitive”, duke theksuar se dialogu i

vërtetë ndërmjet feve është ai që fokusohet te të përbashkëtat pa lënë pas dore dallimet, duke vënë në dukje nevojën për të mbrojtur të rinjtë nga ndikimi i gjuhës së urrejtjes që çon në ekstremizëm.

Në këtë Forum, të pranishmëve iu drejtua edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij paraqiti përvojën dhe traditën e popullit shqiptar në bashkëjetesë dhe tolerancë ndërmjet besimeve të ndryshme. Theks të veçantë në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë, i kushtoi edhe përkushtimit të Bashkësisë Islame të Kosovës në edukimin, vetëdijesimin dhe promovimin e paqes, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet besimtarëve në Kosovë.

Vlen të theksohet se në këtë Forum, Myftiu Tërnavë, ishte i vetmi përfaqësues i bashkësive islame të Evropës Lindore.

Takimi me sekretarin gjeneral të Ligës së Botës Islame, RABITA, dr. Muhamed Abdulkerim al-Isa

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, gjatë vizitës së tij në Riad, u prit në takim nga sekretari gjeneral i Ligës së Botës Islame, RABITA, dr. Muhamed Abdulkerim al-Isa.

Dr. Al-Isa falënderoi Myftiun Tërnavë për pjesëmarrje në këtë takim të rëndësishëm global, si përfaqësuesi i vetëm nga bashkësitë islame për Evropën Lindore, duke çmuar kështu edhe kontributin e tij në këtë Forum me fjalën që paraqiti para të pranish-



mëve. Dr. Al-Isa çmoi lart aktivitetin e Bashkësisë Islame të Kosovës për bashkëjetesën dhe tolerancën të cilën e promovon dhe me të cilën veçohet populli shqiptar.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi nikoqirin për mikpritjen dhe e përgëzoi atë për suksesin e këtij takimi global. Gjithashtu, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që ta njoh dr. Al-Isa me zhvillimet e fundit në

Kosovë, si dhe me sfidat e shtetformimit, duke vënë theksin në kërkesën për një angazhim më të madh të Ligës së Botës Islame për njohje të reja të shtetit të Kosovës.

Vizita në Qendrën Globale për Luftimin e Ideologjisë Ekstremiste

Në kuadër të Forumit për vlerat e përbashkëta të pasuesve të religjioneve të ndryshme, të organizuar nga Liga e Botës Islame (RABITA), përfaqësuesit e feve islame, krishtere, hebreje dhe hinduse, janë pritur në një takim në Qendrën Globale për Luftimin e Ideologjisë Ekstremiste.

Pjesë e këtij delegacioni ishte edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Të pranishmit në këtë qendër i priti sekretari gjeneral i Qendrës, dr. Mensur al-Shumeri i cili ndër të tjera theksoi: “Në dritën e zhvillimeve të komunikimit dhe revolucioneve teknike, veçanërisht në lidhje me platformat e rrjeteve sociale, kjo paraqet një kuantikë progresive, por në të njëjtën kohë rritë barrën që ka të bëjë me sfidat, duke përfshirë edhe përhapjen e përmbajtjes ekstremiste, duke synuar kryesisht grupet rinore. Kjo na vendos para një nevojë urgjente për përpjekje të përbashkëta, në mënyrë që të mos konfrontohen në të ardhmen. Ne e dimë rëndësinë e formulimit të strategjive të përbashkëta për t'u marrë me këto sfida dhe për të qenë në gjendje për t'u ballafaquar me to. Gjithashtu, ne



theksojmë rëndësinë e fuqizimit të grave për të ushtruar rolin e tyre të besimit në familje dhe shoqëri.”

Gjatë kësaj vizite, delegacioni vizitoi ambientet e Qendrës dhe kontrollit të Departamentit të Qendrës, si dhe u njohën me punën, aktivitetin dhe sukseset e kësaj qendre. Delegacioni ndoqi nga afër mekanizmat e monitorimit dhe analizës së Qendrës Etidal, si dhe teknikat dhe modelet e ndërhuara dhe të zhvilluara në kuadër të kësaj qendre.

Gjatë vizitës Myftiu Tërnavë deklaroi se ajo që kishte pa në qendrën

“Etidal” ishte impresionuse, duke theksuar rëndësinë e bashkimit të të gjitha forcave në luftimin e radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorit zmit në çdo vend, sepse këto fenomene nuk njohin vend, komb apo fe. Andaj na duhet unitet ndërmjet popujve, kulturave dhe konfesioneve fetare dhe ndërmjet shoqërive në përgjithësi, e sidomos ndërmjet të rinjve në luftimin e këtyre dukurive të dëmshme për njerëzimin. Ne si BIK kemi qenë dhe jemi të përkushtuar në luftimin e çdo lloji të ekstremizmit dhe radikalizmit.

Vizita në Ministrinë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite

Gjatë qëndrimit në Riad të Arabisë Saudite, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, zhvilloi një takim në Ministrinë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, në të cilën u prit nga zëvendësministri, dr. Avad al-Anzi.

Myftiu Tërnavë falënderoi zëvendësministrin Al-Anzi për kontributin e Mbretërisë Saudite për Kosovën, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy institucioneve.

Në këtë takim u diskutua edhe për themelimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, duke theksuar



rëndësinë e përhapjes së tolerancës, bashkëjetesës dhe luftimin e radi-

kalizmit, ekstremizmit dhe islamofobisë.

Vizita në Ambasadën e Kosovës në Riad

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, gjatë qëndrimit në Riad të Arabisë Saudite, ka vizituar Ambasadën e Kosovës në Riad, ku është pritur në takim nga ambasadori i Kosovës në këtë vend, z. Lulzim Mjeku.

Në këtë takim u diskutua rreth punëve dhe angazhimeve të Ambasadës së Kosovës në Arabinë Saudite, si dhe për intensifikimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Myftiu Tërnavë gjithashtu e njohu ambasadorin edhe me angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, që në vendin tonë të mbretërojnë paqja dhe harmonia



ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare.

Ambasadori z. Mjeku, shprehu falënderime për Myftiun Tërnavë dhe

për institucionin e BIK-ut, për rolin

që kanë luajtur në të gjitha proceset

shtetndërtuese të vendit.

Vizita në Asamblenë Botërore të Rinisë Myslimane WAMY

Gjatë qëndrimit në Riad të Arabisë Saudite, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi zyrën qendrore të WAMY, në të cilën u prit nga sekretari i përgjithshëm dr. Salih al-Vuhejbi.

Myftiu Tërnavë falënderoi nikoqirin Al-Vuhejbi për kontributin e WAMY-it për Kosovën të dhënë që nga pas lufta. Në këtë takim u diskutua edhe për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, duke theksuar rëndësinë e projekteve edukuese për të rinjtë.



Vizita në qytetin historik të Turejfit – Dirijeh

Në kuadër të Forumit për vlerat e përbashkëta të pasuesve të religjioneve të ndryshme, të organizuar nga Liga e Botës Islame (RABITA), përfaqësuesit e feve islame, krishtere, hebreje dhe hinduse, vizituan edhe qytetin historik të Dirijes.

Dirijeh është vendi historik i krijimit të shtetit të parë saudit dhe konsiderohet xhevahiri i Mbretërisë. Ai mishëron shpirtin e historisë së kombit dhe vizionin për të ardhmen e tij. Për qindra vjet, ndërtesat e saj të ftohta me tulla balte kanë qenë një strehë për ata që kërkojnë pushim nga nxehtësia e shkretëtirës dhe një qendër ku komunitetet



mund të mblidhen, ndajnë dhe rriten së bashku.

Në periudhën ndërmjet viteve 1744 dhe 1818 Dirijeh u bë vendi i

kryeqytetit të parë saudit, i njohur si At-Turaif.

Mysafirët u njohën nga afër me historikun e shtetëndërtimit të Arabisë Saudite që nga themelimi.

Takimi me Myftiun e Arabisë Saudite Abdulaziz al-Shejh

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, gjatë qëndrimit në Riad ka vizituar edhe selinë e Presidencës së Përgjithshme për Fetva dhe Kërkime Studimore. Aty delegacioni i BIK-ut u prit nga myftiu i Madh i Mbretërisë së Arabisë Saudite, njëherësh kryetar i Këshillit të Dijetarëve të Lartë dhe president i përgjithshëm i Kërkimeve Dijetarë dhe Fetva, shejh Abdulaziz bin Abdullah al-Shejh.

Myftiu i Saudisë theksoi rëndësinë e takimeve të tilla ndërmjet liderëve islamë për konsultim dhe bashkëpunim ndërmjet tyre, gjithnjë në atë që i shërben myslimanëve.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, përgëzoi përpjekjet e kujdestarit të Dy Xhamive të Shenjta dhe Princit të



Kurorës, në shërbim të Islamit dhe përkujdesjes ndaj Dy Xhamive të Shenjta, haxhive dhe vizitorëve, duke theksuar se këto përpjekje vlerësohen nga të gjithë myslimanët anekënd botës.

Myftiu Tërnavë theksoi rëndësinë e takimit që ka pasur me Myftiun e Mbretërisë Al-Shejh, për diskutimet që ai i zhvilloi, duke synuar kështu thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite dr. Abdulatif al-Shejh

Pas vizitës në kryeqytetin Riad, Myftiu Tërnavë udhëtoi për në Xhide, ku u prit në aeroportin ndërkombëtar "Mbreti Abdul Aziz" nga zyrtarët e lartë të Ministrisë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, përkatësisht nga drejtori i Departamentit të Xhamive, z. Khalid bin Abdullah al-Maliki.

Gjatë qëndrimit në qytetin bregdetar në Xhide të Arabisë Saudite, Myftiu Tërnavë u prit në takim nga ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite dr. Abdulatif al-Shejh.

Nikoqiri i dëshiroi mirëseardhje Myftiut dhe e falënderoi për vizitën. Ministri saudit theksoi se Arabia Saudite, me popullin, qeverinë dhe me mbretin e saj Selman bin Abdulaziz Al-Saud dhe trashëgimtarin e Fronit Muhmed bin Selman janë të përkushtuar për bashkëpunim, mirëqenie dhe prosperitet për të gjithë popujt e botës. Ai theksoi se populli i Kosovës ka vend të veçantë në zemrat e popullit saudit.

Ministri për Çështje Fetare i Arabisë Saudite e njohu Myftiun me punën madhore që po bën Arabia



Saudite në luftimin e ekstremizmit, terrorizmit dhe radikalizmit dhe me kontributin e madh që po jep për t'u respektuar të gjitha besimet dhe për një bashkëjetesë të të gjithëve pa dallim feje, race, gjuhe dhe etnie.

Myftiu Tërnavë falënderoi Mbretërinë e Arabisë Saudite për përkrahjen ofruar Kosovës në periudha të ndryshme dhe në sfera të ndryshme. Ai gjithashtu e njohu nikoqirin me punën dhe aktivitetin e BIK-ut duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame për kultivimin e bashkëjetesës

dhe tolerancës ndërfaqetare ndërmjet qytetarëve të Kosovës.

Nga ana e tij, ministri saudit çmoi punën dhe kontributin e BIK-ut në Kosovë dhe vlerësoi shumë angazhimet e Myftiut dhe të BIK-ut për ta afirmuar shtetësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai potencoi gatishmërinë e qeverisë së Arabisë Saudite për të thelluar bashkëpunimin me Kosovën në fusha të ndryshme dhe gatishmërinë e ministrisë që ai udhëheq për bashkëpunim me BIK-un.

Vizita në Medine

Pas vizitës në Xhide, delegacioni i BIK-ut vizitoi Medinën e ndritshme.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, gjatë qëndrimit në Medine ka zhvilluar një vizitë në Kompleksin për Botimin e Kuranit “Mbreti Fehd”, shtypshkronjën më të madhe në botë, e cila gjendet në Medine.

Delegacioni nga Kosova u prit nga përfaqësuesit më të lartë të Kompleksit, nga sekretari i përgjithshëm z. Khalid Sulejman el-Nefisi.

Myftiu Tërnavë çmoi lart punën që po bëhet në këtë kompleks në shërbim të Librit të Allahut, duke thënë se Arabia Saudite, populli i saj, Qeveria dhe Mbreti i saj, Selman bin Abdulaziz al-Saud, janë të përkushtuar në shërbim të Kuranit dhe kujdesin ndaj tij, duke e dëshmuar këtë me punën madhore që po bëhet në këtë fushë. Myftiu Tërnavë i njohu mikpritësit me institucionin e BIK-ut dhe aktivitetet e saj, e në veçanti kontributin e dijetarëve shqiptarë dhe institucionit të BIK-ut në përkthimet dhe komentimin e Kuranit. Gjithashtu Myftiu Tërnavë e njohu nikoqirin për projektin e BIK-ut në nxjerrjen e një përkthimi të bazuar në përkthimin më të famshëm të



shqiptarët, atij të Sherif ef. Ahmetit, i cili është në përfundim e sipër nga Komisioni përkatës.

Nga ana e tij, z. En-Nefisi, e njohu delegacionin e Kosovës me Kompleksin “Mbreti Fehd” dhe traditën e shkëlqyer të kësaj shtëpie botuese të Kuranit famëlartë, për kontributin mbarë botëror që ka në botimin dhe përhapjen e kopjeve të librit të shenjtë në mbi 74 gjuhë e 80 versione, si dhe zhvillimin e saj të vazhdueshëm për t’ju përgjigjur nevojave të kohës. Ai theksoi se ky kompleks vitin e kaluar ka arritur të shtypë mbi 19 milionë kopje të Kuranit, ndërsa nga fillimi i punës së këtij kompleksi janë nxjerrë mbi 360 milionë kopje të Kuranit famëlartë.

Më tej, ndërmjet dy delegacioneve u zhvillua një mbledhje, ku në krye të delegacionit mikpritës kësaj here ishte z. Emir el-Karavî, zëvendëssekretar i përgjithshëm për Çështjet Shkencore pranë të njëjtit institucion. Gjatë mbledhjes u diskutua rreth marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunimit në projekte të mundshme në të ardhmen për t’i shërbyer Kuranit famëlartë.

Pas vizitës në Medine delegacioni i BIK vizitoi Mekën ku edhe kryen ritualin e umres.

Vlen të theksohet se qëndrimi i Myftiut Tërnavë në Arabinë Saudite u përcoll me vëmendje nga mediat vendore, duke raportuar për të gjitha takimet dhe vizitat e realizuara.

Vizita në Katar

Pas qëndrimit disaditore në Arabinë Saudite, Myftiu Tërnavë i shoqëruar nga shefi i kabinetit, Besim ef. Mehmeti vizituan Katarin.

Myftiu në Katar mori pjesë në Konferencën e 14 për dialogun ndër-fetar, me titull “Fetë dhe gjuha e urrejtjes ndërmjet praktikës dhe teksteve”. Kjo konference u organizua nën patronazhin e shkëlqesisë së tij, sheikh Khalid bin Khalifa bin Abdulaziz al-Thani. Në këtë Konferencë morën pjesë rreth 300 personalitete të ndryshme nga 70 vende të botës, delegacione të shumta nga e mbarë bota, ministra, zëvendës-ministra, përfaqësues të religjioneve të ndryshme, hulumtues, studiues





dhe personalitetet më eminente të kësaj fushe nga vendet e ndryshme të botës.

Konferenca u hap nga ministri për Çështje të Jashtme i shtetit të Katarit, Sulltan bin Sad al-Murejhu, i cili të pranishmëve iu dëshiroi mirëseardhje, duke theksuar se Qeveria e Katarit dhe populli i saj janë të përkushtuar për dialog ndërfaqetor dhe për respektim të vlerave të larta morale e njerëzore.

Më pas, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua drejtori i Qendrës

DICID, dr. Ibrahim al Nuajmi, i cili iu uroi mirëseardhje mysafirëve pas një mungese 2 vjeçare për shkak të virusit Korona. Ai në fjalën e tij u përqendrua në rëndësinë e dialogut ndërfaqetor dhe ndikimit të tij në përmirësimin e bashkëjetesës ndërmjet popujve dhe shoqërive anekënd botës, duke theksuar kështu rolin e të gjithë njerëzve vullnetmirë për luftimin e gjuhës së urrejtjes, andaj edhe kanë zgjedhur si temë boshte të kësaj Konference temën

“Fetë dhe gjuha e urrejtjes ndërmjet praktikës dhe teksteve”.

Konferenca më pas vazhdoi me shfaqjen e një filmi të shkurtër, ku u shfaqën aktivitetet e Qendrës DICID Doha gjatë një dekade në kontributin e saj për dialogun ndërfaqetor.

Në këtë seancë gjithashtu u shpërblyen edhe tri personalitetet dhe tri institucione për aktivitetin e tyre në dialogun ndërfaqetor.

Takimi me zëvendësministrin nga Omani

Gjatë qëndrimit në Doha të Katarit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka zhvilluar një takim me zëvendësministrin e Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Sulltanatit të Omanit, dr. Muhamed bin Said al-Maamari.

Myftiu Tërnavë e njohu zëvendësministrin Al-Maamari për zhvillimet e jetës fetare në Kosovë, si dhe për

sfidat dhe projektet e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai gjithashtu shfrytëzoi rastin që ta njohu zv. ministrin edhe për bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfaqetore, me të cilën shquhet populli shqiptar.

Në këtë takim u diskutua edhe për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, duke theksuar kështu rëndësinë e përhapjes së tolerancës, bashkëjetesës dhe luftimit të

radikalizmit, ekstremizmit dhe islamofobisë.

Zv.ministri Al-Maamari e falënderoi Myftiun Tërnavë për këtë takim, duke shprehur gatishmërinë e ministrit dhe të Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Omanit për bashkëpunimin në fusha të ndryshme në interes të përbashkët të dyja vendeve. (Mr. Besim Mehmeti)



Myftiu Tërnavë mori pjesë në mbrëmjen e maturës së maturantëve të Medresesë

Më 29 maj, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë mori pjesë në mbrëmjen e maturës së maturantëve të Medresesë, duke shënuar kështu me sukses përfundimin e shkollës së mesme të lartë të nxënësve të Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë.

Në një organizim festiv të organizuar për nder të përfundimit me sukses të Medresesë, nxënëset u shprehën të lumtur për këtë të arritur të tyre, duke falënderuar këtë shkollë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës. Nga një fjalë rasti mbajtën drejtori Fadil Hasani dhe Myftiu Tërnavë, të cilët uruan nxënëset për këtë sukses të treguar dhe duke iu uruar atyre shëndet e suksese në jetën e mëtutjeshme të tyre, duke porositur që mos t'i harrojnë mësimet dhe edukatën e marr nga bankat e shkollës. "Këto mësimet do t'ua lehtësojnë rrugën në jetë. Mos u lakoni nga rruga e Kuranit



dhe traditës profetike dhe këto mësimet t'i përcillni te gjeneratat e reja që do të vijnë pas jush" - tha drejtori Hasani.

Në fjalën e tij, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë para maturantëve dhe stafit të shkollës tha se "Imamët kanë luajtur rol të madh në avancimin zhvillimin e jetën fetare, ekonomike, sociale dhe kombëtare të Kosovës dhe

jo vetëm, në këtë Medrese është projektuar ardhmëria e vendit tonë dhe në këtë amfiteatër kanë kaluar kokat më të ngritura të kombit shqiptarë në veçanti nga vitet 1989-1999."

Edhe maturantët falënderuan stafin e Medresesë Alauddin dhe Kryesinë e BIK-ut për angazhimin e tyre që nxënësit të pajisen me dije e edukatë sa më shumë.

Mbahen garat e Kuranit në nivel të Medresesë

Më 6 maj në ambientet e ShML "Medreseja Alauddin" – paralelja e ndarë fizike në Prizren, u zhvilluan garat e Kuranit në nivel shkolle ndërmjet klasave të 11-ta dhe 12-ta të shkollës amë dhe dy paraleleve të ndara fizike të Prizrenit dhe Gjilanit.

Gara ishte cilësore dhe u zhvillua në tri fusha:

1. Lexim të Kuranit,
2. Pjesë të mësuara përmendsh, dhe
3. Texhvid.

Gjithsej garuan 51 nxënës, të ndarë në 17 ekipe garuese, të cilët u vlerësuan nga juria katër anëtarëshe në krye me kryeimamin e BIK-ut, Vedat ef. Sahiti.

Rezultatet dhe renditja e ekipeve:

Kategoria e djemve:

Klasat e 11-ta

1. Vendi i parë, kl.11/2 Prishtinë;
2. Vendi i dytë, kl. 11/7 Gjilan;



3. Vendi i tretë, kl.11/1 Prishtinë.
Klasat e 12-ta

1. Vendi i parë, kl.12/1 Prishtinë;
2. Vendi i dytë, kl. 12/5 Prizren;
3. Vendi i tretë, kl.12/8 Gjilan.

Kategoria e vajzave:

Klasat e 11-ta

1. Vendi i parë, kl.11/3 Prishtinë;
2. Vendi i dytë, kl. 11/4 Prishtinë;

3. Vendi i tretë, kl.11/6 Prizren.
Klasat e 12-ta

1. Vendi i parë, kl.12/3 Prishtinë;
2. Vendi i dytë, kl. 12/9 Gjilan;
3. Vendi i tretë, kl.12/4 Prishtinë.

Drejtorja e shkollës uroi ekipet fituese dhe të gjithë garuesit për rezultatet e arritura dhe iu dëshiroi suksese edhe në të ardhmen!

Kryeimami Sahiti vizitoi xhaminë e Mulla Idriz Gjilanit në fshatin Dunav

Më 9 maj, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me kryetarin e Këshillit të BI-se të Gjilanit, Naim ef. Aliun, vizituan xhaminë e Mulla Idriz Gjilanit në fshatin Dunav të Gjilanit, e cila po restaurohet nga MKRS nga fondi i intervenimeve emergjente dhe po realizohet nga zyra regjionale e Institutit të Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës.

Pas përfundimit të punimeve restauruese të xhamisë, KBI në Gjilan



do të fillojë me rikonstruimin e Mejtepit të Mulla Idriz Gjilanit. Vlen

të përmendet se këto dy objekte janë ngritur nga vetë Mulla Idriz Gjilani.

Drejtori Simnica priti në takim Nexhat Zumerin, anëtar i xhamisë së Regensdorfit të Zvicrës

Më 11 maj, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Siminca, priti në takim Nexhat Zumerin, anëtar i xhamisë së Regensdorfit të Zvicrës.

Drejtori Siminca falënderoi z. Zumeri dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje.

Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.

Ndërkaq, z. Zumeri e falënderoi drejtorin Simnica për pritjen dhe për gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të kenë një bashkëpunim të mirëfilltë me qendrat shqiptare në diasporë.



Sekretari Sadriu priti në takim rektorin e Universitetit "Ondokuz Mayıs University"

Më 12 maj, sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka pritur në takim një delegacion nga Universiteti "Ondokuz Mayıs University", i udhëhequr nga rektori, prof. dr. Yavuz Unal. Sekretari Sadriu fillimisht i uroi mirëseardhje mysa-firëve, e më pas i njohu ata me mbarëvajtjen dhe ecurinë e punëve dhe angazhimeve të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai përmendi raportet e mira që ka Kosova në përgjithësi dhe BIK-u në veçanti me shtetin mik turk, për të cilin shprehu falënderime për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për shtetin e Kosovës. Sekretari Sadriu gjithashtu e njohu mysafirin edhe me institucionet që veprojnë në



kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, siç janë Medreseja "Alauddin" dhe Fakulteti i Studimeve Islame. Nga ana e tij, rektori, dr. Yavuz Unal, shprehu falënderime për sekretarin Sadriu dhe për institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për

pritjen. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të fakultetit që ai drejton që të fillojë bashkëpunimin me dy institucionet e BIK-ut, Medresenë "Alauddin" dhe FSI-në, për shkëmbimin e nxënësve dhe të studentëve.

Kryeimami Sahiti priti në takim Abdulaziz Alobaidin

Më 13 maj, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim Abdulaziz Alobaid, drejtor gjeneral i Fondacionit Kuvaj-tian për Bamirësi, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në vendin tonë. Kryeimami Sahiti falënderoi drejtorin Alobaid për vizitën dhe për bashkëpunimin e organizatës kuvajtiane me Bashkësinë Islame në realizimin e një sërë projektesh të rëndësishme për Bashkësinë Islame, sidomos në fushën humanitare dhe zhvillimore të vakëfeve. Nga ana e tij, drejtori Abdulaziz Alobaid falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen dhe bashkëpunimin, si dhe theksoi për-



kushtimin e tij dhe të institucionit për thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në fushat e interesit të përbashkët.

Në fund të takimit, kryeimami Sahiti i dhuroi mysafirit katalogun e dorëshkrimeve arabe të bibliotekës së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Drejtori i IHSI-së, Sabri ef. Bajgora zhvillon disa takime në Turqi

Më 13 maj, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora i shoqëruar nga PHD(c) Besir Nezir, anëtar i Këshillit Drejtues të IHSI, kanë zhvilluar disa takime zyrtare me personalitete të larta shkencore në shtetin e Turqisë.

Fillimisht ata janë pritur nga prof. dr. Ali ÖZTÜRK, dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Universitetin Trakia, në Edirne, dhe nga prof. dr. Ilir Rruga, prodekan, pastaj kanë zhvilluar një takim me doç. dr. Ibrahim KELAĞA AHMET, drejtor i Institutit për Hulumtime Ballkanike në Universitetin Trakia, në Edirne, kurse më pas kanë takuar edhe doç. dr. Abdullah Taha İMAMOĞLU, drejtor i Qendrës për Hulumtime dhe Aplikime të Islamit dhe Artit Islam "Rumeli".



Me këtë rast, drejtori Bajgora i njohu ata me punën dhe aktivitetin e IHSI si dhe objektivat dhe sfidat e tij. Mes tjerash drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora tha se themelimi i tij është projektuar dhe është paraparë që të jetë institucioni më i lartë kërkimor dhe shkencor në Bashkësinë Islame të Kosovës, rreth të cilit po

mblidhen dhe japin kontributin e tyre studiues të shumtë të fushave fetare, kulturore e historike, gjithnjë në shërbim të ndriçimit të së vërtetës fetare dhe kombëtare. Sipas tij, këto takime do të përforcojnë edhe më shumë bashkëpunimin mes institucioneve tona në realizimin e projekteve të përbashkëta shkencore.

Në Turqi i zhvilloi punimet simpoziumi ndërkombëtar "Trashëgimia kulturore dhe fetare në Ballkan përgjatë historisë"

Më 15-16 maj në Turqi i zhvilloi punimet simpoziumi ndërkombëtar "Trashëgimia kulturore dhe fetare në Ballkan përgjatë historisë", organizuar nga Universiteti Kirklareli - Fakulteti i Studimeve Islame-Ilahijat, në

qytetin Kirklareli të Turqisë. Në këtë simpozium morën pjesë mbi 70 studiues, akademikë, hulumtues, profesorë etj., nga Turqia, Ballkani perëndimor dhe nga shtete të ndryshme të botës. Në këtë ngjarje

shkencore po marrin pjesë edhe përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kosovës, të cilët po japin kontribut të theksuar me kumtesat e tyre.

Prof. Sabri ef. Bajgora, drejtor i Institutit për Hulumtime dhe

Studime Islame, u paraqit me kumtesën "Roli i Medresesë "Pirinaz" në formimin e elitës intelektuale islame te shqiptarët", e prezantuar në gjuhën arabe; prof. ass. sr. Rexhep Suma - ligjërues në Fakultetin e Studimeve Islame, paraqiti në gjuhën arabe kumtesën "Medreseja "Alaud-din", kala e pamposhtur në mbrojtje të identitetit islam në Ballkan"; PHD(c) Besir Neziri, asistent në kabinetin e Myftiut Tërnavë lexoi në gjuhën turke kumtesën "Medreseja islame e planifikuar të hapet në Prishtinë (në vitin 1911)"; ndërsa PHD(c) Besnik Jaha, profesor në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë ekspozoi në



gjuhën angleze kumtesën: "Studiuesit shqiptarë në Perandorisë Osmane dhe pas vitit 1912 në Ballkan". Kumtesat e tyre zgjuan shumë inte-

resim të të pranishmit, dhe kjo shihej në saje të pyetjeve dhe komenteve dashamirëse të shumta që u bënë rreth kumtesave të tyre. (R.S.)

Drejtori Bajgora viziton qendrën "ISAM" në Turqi

Më 17 maj, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora, u prit nga sekretari gjeneral i Qendrës për Hulumtime Islame (ISAM) dr. Fahrettin ERGÜN.

Drejtori Bajgora e njohu nikoqirin për aktivitetet e IHSI-së që nga themelimi, e pastaj u bisedua gjerësisht edhe për mundësitë e bashkëpunimit në shumë fusha, sidomos në hulumtimin e dokumentacioneve nga periudha osmane që kanë të bëjnë me shqiptarët, përkatësisht ulematë shqiptarë, xhamitë, medresetë dhe përgjithësisht me trashëgiminë islame përgjatë shekujve të kaluar. U bisedua edhe për disa projekte të përbashkëta, të cilat do të mund të realizoheshin mes dy institucioneve si p.sh. përkthimi i pjesërishëm i Enciklopedisë Islame të botuar nga ISAM-i, sidomos zërat apo njësitë që kanë të bëjnë me



shqiptarët dhe Ballkanin. Shpresojmë se ky projekt së shpejti mund të nisë për t'u pasuar edhe me projekte të tjera, që do të kontribuojnë për ndriçimin e të kaluarës sonë.

Drejtori Bajgora, po ashtu, pati një takim pune edhe me drejtorin e Bibliotekës së ISAM-it, z. Mustafa Birol Ülker, i cili dha sugjerimet e tij për hapat që duhen ndjekur nga

IHSI, në formimin e një biblioteke moderne e cila do t'u vihej në dispozicion studiuesve nga mbarë trojet shqiptare. Ai u shpreh i gatshëm që të ndajë përvojat e tij në këtë drejtim, deri në funksionalizimin e plotë të bibliotekës së IHSI-së. Në shoqërim të drejtori Bajgora ishte PHD (c) Besir Neziri, anëtar i Këshillit Drejtues të IHSI-së.

Drejtori Hasani vizitoi Këshillin e BI-së së Gjilanit

Më 19 maj, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Islam Hasani, së bashku me zyrtarin financiar, msc. Tanseli Rogova, vizituan Këshillin e Bashkësisë Islame të Gjilanit, në të cilën u pritën nga kryetari i këtij Këshilli, Naim ef. Aliu.

Kryetari Aliu i njohu përfaqësuesit e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me punën, sfidat dhe mbarëvajtjen e jetës fetare në Gjilan, me theks të veçantë për çështjet financiare. Ai i njohu edhe me kontributin e besimtarëve gjatë muajit Ramazan, më konkretisht për dhënien e zekatit dhe

të sadakatul-fitrit. Drejtori Hasani falënderoi kryetarin Aliu dhe gjithë administratën dhe imamët për punët dhe angazhimet e tyre në të mirë të besimtarëve myslimanë.

Më pas, përfaqësuesit e Kryesisë së bashku me kryetarin Aliu, vizituan paralelen e Medresesë "Alauddin" në

Gjilan, në të cilën u mirëpritën nga koordinatoreja, znj. Merita Boroci.

Këta uruan znj. Boroci për marrjen e detyrës si koordinatore, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Znj. Boroci i njohu përfaqësuesit e Kryesisë me punët dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kjo paralele. Ajo mori përkrahjen dhe mbështetjen e drejtorit Hasani për aktivitetet dhe angazhimet e Medresesë.



Drejtori Shkodra qëndroi në Londër

Më 23 maj, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese i BIK-ut, z. Ramadan Shkodra së bashku me prof. Ejup Ramadanin realizuan një vizitë pune në Londër, ku të shoqëruar nga imami i Komunitetit Shqiptar në Londër, Mehmet ef. Stublla, u pritën në Këshillin Bashkiak në Waltham Forest London nga këshilltari z. Kastriot Berber.

Z. Berberi pasi i falënderoi mysafirët nga Prishtina për vizitën, i njohu më pas me angazhimin e tij si i zgjedhur i popullin në Këshillin Bashkiak të Waltham Fores, si dhe angazhimin e tij për komunitetin shqiptar në Londër, ku ai potencoi se është pranë komunitetit në çdo rast ku i jepet mundësia, madje ai theksoi se, që kur ai është zgjedhur, për çdo 28 Nëntor e 17 Shkurt ngrit flamurin e Shqipërisë e Kosovës në oborrin e Këshillit, si dhe i ndriçon muret me ngjyrat e flamujve të dy shteteve. Ai çmoi lart edhe kontributin dhe angazhimin e imamit Stublla.

Pas takimit, të shoqëruar nga z. Berberi, vizituan edhe ambientet e brendshme të Bashkisë së Welham Forest të Londrës. Përndryshe z.



Kastriot Berberi me origjinë nga Burreli është shqiptari i parë që zgjidhet këshilltar në një bashki në Britaninë e Madhe.

Drejtori Shkodra e falënderoi për pritjen e përgëzoi atë për punën dhe rezultatet që ka arritur si dhe dhe çmoi lart kontributin e tij për komunitetin shqiptar në Londër.

Po të hënën, z. Shkodra, së bashku me z. Ramadanin, e të shoqëruar nga imami Stublla vizituan "Xhaminë e Londrës Lindore & Qendra Myslimane e Londrës", që njihet si një ndër më të mëdhatë në Evropë në funksion të komunitet myslimanë. Mysafirët u pritën nga drejtori i qendrës Dilowar H. Khan, i cili i

njohu me historikun e themelimit të qendrës si dhe me aktivitetet që zhvillohen në Qendrën myslimane në Londër.

Ndërsa prof. Ramadani dhe drejtori Shkodra e njohën nikoqirin shkurtimisht me organizimin dhe funksionim e BIK-ut.

Gjatë takimit z. Dilowar Khan shprehu dëshirën që ta vizitoi Kosovën.

Ndërsa, të dielën patën një takim shumë të veçantë e miqësor me autorin e librit "Islami në Andaluzi" Ahmet Thomson, të cilin e përgëzuan për punën që ka bërë në trajtimin e historisë së Andaluzisë, libër ky i botuar edhe në gjuhën shqipe.

Promovohet libri "Islami në Andaluzi"

Më 22 maj, në Qendrën Britaniko-Shqiptare të Komunitetit Mysliman (British Albanian Muslim Community) në Londër, u promovua libri "Islami në Andaluzi", i autorit anglez, Ahmet Thomson, i përkthyer në shqip nga prof. Ejup Ramadani. Fillimisht, para të pranishmëve, një fjalë rasti rreth librit e mbajti imami i

Qendrës, Mehmed ef. Stublla, i cili vlerësoi lart botimin në shqip të këtij libri që i kushtohet Andaluzisë myslimane. Ndërkaq, përkthyesi i librit, prof. Ejup Ramadani, para të pranishmëve shpalosi motivet dhe faktorët që kanë ndikuar që ai t'i rreket punës për ta sjell në gjuhën shqipe këtë vepër. Në fjalën e tij drejtuar të pran-

ishmëve, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në Kryesinë e BIK-ut, Ramadan Shkodra, përveç tjerash tha se libri të cilin po e promovojmë, është i një rëndësie të veçantë, ngase është ndër veprat e pakta në gjuhën shqipe që i kushtohet Andaluzisë së qeverisur nga myslimanët. "Ne si botues kemi

nderin që të ofrojmë për lexuesit shqipfolës një vepër të tillë" - tha ndër të tjera drejtori Shkodra. Ai gjithashtu shfrytëzoi rastin që në këtë aktivitet kulturor, para të pranishmëve, t'i prezantoi edhe disa nga botimet e fundit të shtëpisë botuese "Dituria Islame", si dhe historikut të literaturës islame në gjuhën shqipe, me theks të veçantë, literaturës së botuar nga BIK-u. Në këtë aktivitet, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua edhe këshilltari i Këshillit Bashkiak në Waltham Forest London, z. Kasriot Berberi, i cili ndër të tjera tha: "Ndjehem mirë që sonte, në këtë aktivitet na ka bashkuar libri, dija e kultura. Aktivitetet e tilla janë më se të nevojshme për ne"

Të premten, prof. Ramadani dhe drejtori Shkodra, vizituan Qendrën Britaniko-Shqiptare të komunitetit myslimanë, në të cilën u mirëpritën nga imami Mehmed ef. Stublla, i cili i njohu me organizimin dhe funk-



sionimin e komunitetit shqiptar në kuadër të Qendrës. Gjatë qëndrimit në Qendër, zyrtarët nga BIK-u bashkëbiseduan me mërgimtarët tanë, me të cilët së bashku falën edhe namazin e xhumasë. Po të premten, prof. Ejup Ramadani dhe drejtori Ramadan Shkodra, të shoqëruar edhe nga imami Stublla, vizituan Xhaminë Qendrore të Londrës, e cila vepron në kuadër të Qendrës Kulturore të Rixhens Park (Cultural Centre Regents

Park Moque), në të cilën u mirëpritën nga drejtori i kësaj Qendre, dr. Ahmed Dubjan, i cili i njohu mysafirët me aktivitetet e Qendrës, si dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me BIK-un. Ai vuri theksin te formimi i këndit të literaturës shqipe në kuadër të bibliotekës së Qendrës, ngase sipas tij, biblioteka e Qendrës frekuentohet edhe nga një numër i konsiderueshëm i komunitetit shqiptar që jetojnë në Londër.

"Bereqeti" filloi shpërndarjen e pakove të dhuruara nga Qeveria e Kosovës

Më 25 maj, Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" ka filluar shpërndarjen e pakove ushqimore të dhuruara nga Qeveria e Kosovës. Kjo ndihmë vjen në kuadër të masës 3.4. e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht e Ministrisë së Financave. Drejtori i Shoqatës "Bereqeti", Behxhet Ajvazi, e cilësoi këtë ndihmë si një nder dhe përgjegjësi për shoqatën që ai drejton, ngase "Bereqeti" në këtë aktivitet është një lider i shpërndarjes. "Në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, ne si shoqatë kemi marrë besimin e plotë nga Qeveria për të qenë në tërë Kosovën, te çdo familje nevojtare. Për ne është një nder i veçantë, por edhe një përgjegjësi, ngase është hera e parë që kemi një bashkëpunim të tillë me Qeverinë e Kosovës, e kjo e bën këtë projekt edhe më të veçantë. Qeveria jonë na i ka besuar neve si shoqatë 7900 pako, duke na bërë kështu lider të këtij projekti. Ne premtojmë se do t'i qëndrojmë besnikë kushteve dhe



kërkesave që ka parapa Qeveria jonë" – tha ndër të tjera drejtori Ajvazi. Ndërkaq, Xheladin Fazliu, përgjegjës i shoqatës, tha se ky projekt është tejet i rëndësishëm, duke e cilësuar këtë si më të veçantën të realizuar ndonjëherë. "Besimi dhe përgjegjësia e dhënë nga Qeveria është një privilegj për ne. Jemi tejet të kënaqur që po i shërbejmë vendit tonë, Qeverisë sonë. Me përgjegjësinë më të plotë do të mundohemi të jemi te çdo familje nevojtare, aty ku është paraparë edhe

me ndarjen e komunave nga Qeveria. Ne si shoqatë, në të ardhmen premtojmë se do të kalojmë edhe në faza të tjera të zhvillimit të vendit" – tha z. Fazliu. Shoqata "Bereqeti" është përfituese e 7900 pakove, donacion nga Qeveria e Kosovës, e të cilat do të shpërndahen në 14 komuna të Kosovës. Fillimisht këto paku u shpërndanë në Kamenicë, Viti dhe në Lipjan, për të vazhduar ditët në vazhdim edhe me komunat e tjera.

Drejtori Simnica priti në takim z. Dugaxhin Shamollin dhe Nexhmedin Ibishin

Më 31 maj, drejtori për Diasporë në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, së bashku me sekretarin e Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, pritën në takim anëtarin e Kryesisë së Xhamisë “Nurul Islam” në Monchengladbach të Gjermanisë, z. Dugaxhin Shamollin, dhe z. Nexhmedin Ibishi, anëtar i xhamisë “Xhamia e Shqiptarëve” – Londër, të shoqëruar nga sekretari i KBI-së së Drenasit, Eset ef. Bajraktari. Drejtori Simnica në këtë takim shprehu falënderime për veprimtarinë e anëtarëve të këtyre xhamive, por edhe të gjithë mërgatës sonë në diasporë për punën dhe angazhimin e tyre që jeta fetare atje të zhvillohet ashtu siç është më së miri. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut për bashkë-



punim dhe për koordinim sa më të mirë të aktiviteteve edukativo-fetare. Nga ana e tij, z. Shamolli dhe z. Ibishi, falënderuan për zemërsisht Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Drejtorinë e Diasporës për mikpritjen dhe gatishmërinë e tyre që të ketë një

bashkëpunim sa më të mirë për të gjithë. Në fund të këtij takimi, z. Shamolli dorëzoi vitrat dhe zekatin e mbledhur nga mërgimtarët e xhamisë së tyre, për çka drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica ndau një falënderim për kontributin e dhënë.

Drejtori Simnica mori pjesë në iftarin tradicional në xhaminë “Tulipan” në Zvicër

Më 22 prill, të premten, në mbrëmje në ambientet e xhamisë shqiptare “Tulipan” në Reinach, KMSHZ, për nder të muajit të bekuar Ramazan, u përkujdes që të shtrojnë një iftar edhe për institucionet dhe personalitetet nga sfera të ndryshme fetare, shoqërore dhe afariste, si: Ilir Gjoni – ambasador i Republikës së Shqipërisë në Bernë, Sami Ukelli – ambasador i Republikës së Kosovës në Bernë, Qenan Ramadani – ambasador i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bernë, Montassar Ben Mrad, kryetar i FIDS, dr. Halit Duran, kryetar i VAM-it, Jasmin ef. Demic, kryeimam i xhamive boshnjake të Zvicrës, Lazim Destatini, filantrop dhe afarist, Yakup Gürgün, kryetar i DIGO-s, Ekrem Simnica, drejtor për Diasporën pranë Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, si dhe shumë intelektualë, hoxhallarë, kryetarë të xhamive dhe afaristë. Programi filloi me leximin e disa ajeteve nga Kuranit famëlartë nga hafëzi i mirënjohur, Mujdin Limani. Më pas, në emër të KMSHZ-së, të

pranishmit i përshëndeti kryetari i KMSHZ-së, h.fz. Mehas Alija, ku mysafirëve iu adresoi falënderimet e sinqerta për pjesëmarrjen në këtë iftar dhe me theks të veçantë për mbështetjen dhe bashkëpunimin në ngritjen dhe forcimin e të vetmit institucion fetar për shqiptarët e besimit islam që punojnë dhe veprojnë në këtë shtet të Evropës.

Më pas, fjalën e mori ambasadori i Shqipërisë z. Ilir Gjoni, ku me shumë

bindje adresoi fjalë miradije për KMSHZ-në, në veçanti për promovimin e islamit liberal në proporcion me frymën e tolerancës, respektit dhe të bashkëjetesës fetare, që me shekuj myslimanët shqiptarë e kanë kultivuar. Fjalë rasti për të përshëndetur të pranishmit, mori edhe filantropi i madh dhe humanisti i shquar shqiptar, z. Lazim Destani, ku vlerësoi lart punën dhe angazhimin që KMSHZ-së po bën për myslimanët shqiptarë



këtu në Zvicër. Përfaqësuesi i BIK-ut, z. Ekrem Simnica, vlerësoi lart bashkimin e shqiptarëve myslimanë nën KMSHZ, si organ i vetëm. Drejtori i Diasporës ndër të tjera tha: “Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të institucioneve të saj dhe në emrin e Myftiut Tërnavë, më lejoni që t’ju uroj të gjithëve, për muajin e bekuar Ramazan, duke ju dëshiruar agjërim të lehtë dhe vepra të pranuar te Zoti i Madhëruar. Shfrytëzoj nga rasti dhe kam nder të veçantë që, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës të Kosovës dhe në emrin tim personal t’ju uroj për zgjedhjen tuaj, z. Mehas Alija si kryetar të KMSHZ-së, z. Fehim ef. Abazi, nënkryetar si dhe anëtarët që u zgjodhën në Kryesinë e kësaj Bashkësie, duke e lutur Allahun e Madhërisëm që t’ju ndihmojë në punën dhe angazhimet Tuaja të mëdha që keni para vetes. Shfrytëzoj nga rasti gjithashtu dhe kam nder të veçantë që, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës të Kosovës dhe në emrin tim personal t’ju uroj për ndërtimin e kësaj bukuroshe – xhamisë “Tulipan” këtu në Reinach. Bashkësia Islame e Kosovës e në veçanti Drejtoria për Diasporë është



e interesuar që të bashkëpunojë ngushtë me KMSHZ-në. Mbesim me shpresë se bashkëpunimi ynë do të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen. Duke ju uruar edhe një herë, pranoni selamet dhe përshëndetjet tona.” Drejtori për Diasporë në shenjë respekti dhe bashkëpunimi ndau mirënjohje për kryetarin e KMSHZ-së, z. Mehas Alija, nënkryetarit të KMSHZ-së, z. Fehim ef. Abazi, si dhe një mirënjohje e veçantë nga drejtori iu nda xhamisë Tulipan, kryetarit të saj z. Azir Jusufi, xhemitit të saj, duke ia dhuruar imamit të nderuar z. Halil Ademi, në shenjë respekti. Për fund, dy zëra të bukur, Fatime Hasipi dhe Zehra

Tairi, u përkujdesen që këtë organizim, përmes interpretimit të dy ilahive, ta bëjnë edhe më të ngrohtë në të njëjtën kohë edhe më emocional këtë iftar. Drejtori Simnica vizitoi gjithashtu xhaminë "Oaza" në Spreitenbach për syfyr dhe namaz të sabahut u prit nga hoxha i nderuar Xheladin Leka dhe xhemati. Vlen të ceket se imam ndihmës për teravi ishte dr. Bali Sadiku.

Fadil ef. Musli - anëtar i delegacionit mbajti një ligjëratë rreth dobive të dhjetëshit të fundit të ramazanit, dhënies së sadakasë, dhe zekatit etj., për t’u prirë më pas me namazin e teravive në xhaminë "Drita" në Emmenbrucke.

Vizita e drejtorit të Diasporës së BIK-ut në Zvicër

Më 21 prill 2022, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, vizitoi xhematin e xhamisë “Dituria” në Gjenevë, ku u prit nga imami Rijad Aliu, kryetari, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Përfaqësuesi i BIK-ut qëndroi në këtë xhami për namaz dreke dhe më pas mbajti edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësim rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theks të veçantë i kushtoi punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai me këtë rast përcolli urimet dhe përgëzimet e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan, duke lutur Allahun që të na i pranoj ibadetet dhe adhurimet që i kryejmë gjatë këtij muaji. Drejtori



Simnica në ligjëratën e tij falënderoi të gjithë mërgimtarët tanë për kontributin e vazhdueshëm dhënë për vendlindjen në përgjithësi, e në veçanti për institucionin e Bashkësisë

Islame të Kosovës. Ai shfaqti shpresën dhe bindjen e tij se kjo mërgatë do të vazhdojë kontri-butin e saj edhe përgjatë viteve të ardhshme, sa herë që të jetë nevoja.

Delegacioni i BLK-ut vizitoi xhaminë e parë shqiptare në Zvicër

Në vazhden e vizitave të rregullta, më 21 prill 2022, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, vizitoi për iftar xhaminë shqiptare në Cyrih, xhamia e parë shqiptare në Zvicër, ku u prit nga imami Nebih ef. Rexhepi, kryetari, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Përfaqësuesi i BIK-ut, mbajti edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan, para namazit të jacisë. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theks të veçantë i kushtoi punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai me këtë rast përcolli urimet dhe përgëzimet e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan, duke lutur Allahun që të na i pranojë ibadetet dhe adhurimet që i kryejmë gjatë këtij muaji. Drejtori Simnica në ligjëratën e tij falënderoi të gjithë mërgimtarët tanë për



kontributin e vazhdueshëm dhënë për vendlindjen në përgjithësi, e në veçanti për institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai shfaqti shpresën dhe bindjen e tij se kjo mërgatë do të vazhdojë kontributin e saj edhe përgjatë viteve të ardhshme, sa herë që të

jetë nevoja. Ndërsa imami Fadil ef. Musliu mbajti ligjëratë rreth dobive të dhjetëshit të fundit të Ramazanit, dhënies së sadakasë, zekatit etj., për t'iu prirë më pas për namazin e jacisë dhe të teravive në xhaminë e Fribourgut.

Vizita e delegacionit të BIK-ut në Zvicër



Më 22 prill 2022, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, për xhuma u prit në xhaminë "Paqja" në Schwamendingen të Cyrihut, nga imami, Fahredin ef. Bunjaku, kryetari Afrim Berisha, anëtarët e Kryesisë, si dhe nga xhemati i nderuar.

Përfaqësuesi i BIK-ut, para namazit të xhumasë mbajti edhe një ligjëratë

me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan.

Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theks të veçantë i kushtoi punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai shfaqti shpresën dhe bindjen e tij se kjo mërgatë do të vazhdojë kontributin e saj edhe për-

gjatë viteve të ardhshme, sa herë që të jetë nevoja.

Ndërsa imami Fadil ef. Musliu, mbajti ligjëratë rreth dobive të dhjetëshit të fundit të Ramazanit, dhënies së sadakasë, zekatit etj., për t'iu prirë më pas në hytbe dhe për namazin e xhumasë në xhaminë Büläh.

"Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi!"



Me pikëllim të thellë mora lajmin për kalimin në Ahiret të presidentit Bujar Nishani.

Në emrin e Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, shpreh ngushëllimet e mia për familjen, farefisnin, të afërmit dhe miqtë e tij!

Presidenti Nishani do të kujtohet si një personalitet me integritet të lartë, i përkushtuar ndaj popullit e atdheut dhe si një burrështetas e vizionar i dëshmuar.

Jemi mirënjohës për kujdesin, kontributin dhe angazhimin e tij për çështjen e Kosovës!

Zoti ua shtoftë sabrin e gajretin familjarëve të presidentit Nishani, e shpirti i tij u mëshiroftë tek i Gjithëmëshirshmi!

*Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*



Zoti e mëshiroftë Sheikh Khalifa bin Zayed Al Nahyan, presidentin e Emirateve të Bashkuara Arabe. Ne kemi humbur një udhëheqës të shquar, të urtë, dashamirës të hairit.

Në emër të popullit të Kosovës, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim, i shprehim ngushëllimet tona vëllezërve tanë në Emiratet e Bashkuara Arabe për këtë humbje të madhe, dhe lusim Zotin që ta mbulojë me mëshirën e Tij.

*Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*



Më 11 maj 2022, ka ndërruar jetë imami i xhamisë së fshatit Sferkë të komunës së Klinës, Afrim ef. Kastrati.

Biografi e shkurtër

Afrim ef. Kastrati lindi më 28 korrik 1964 në fshatin Sferkë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen e kreu në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë gjatë viteve 1979-1984. Studimet më pas i vazhdoi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë në drejtimin e orientalistikës gjatë viteve 1986-1990.

Që nga vitit 1990 punoi si imam i rregullt në xhaminë e fshatit Sferkë të komunës së Klinës.

Varrimi i rahmetliut u bë më 11 maj 2022, në varrezat e fshatit Sferkë të Klinës.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME E KOSOVËS
MEDRESEJA E MESME "ALAUDDIN" PRISHTINË



KURBANANI 2022



140€

Porosinë tuaj mund ta bëni në:

- ▶ Këshillin e Bashkësisë Islame
- ▶ Përmes bankës & PayPal

NLB Banka

IBAN: XK05 1700200100103672

SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR

PayPal: paypal.me/bikfitra